



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

TRANSKRIPT

I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS,
E MBAJTUR MË 19 JANAR 2023

SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA,
ODRŽANE 19. JANUARA 2023. GODINE

JANAR - JANUAR
2023

Rendi i ditës

1. Miratimi i procesverbalit nga seanca e mëparshme,
2. Deklarimet jashtë rendit të ditës,
3. Pyetjet parlamentare,
4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr.08/L-178 për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 04/L-101 për Fondet Pensionale të Kosovës, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin nr. 04/L-115, me Ligjin nr. 04/L-168 dhe Ligjin nr. 05/L-116,
5. Shqyrtimi i raportit me rekomandime për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit nr. 06/L-046 për Inspektoratin e Arsimit në Republikën e Kosovës,
6. Shqyrtimi i raportit vjetor të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për vitin 2021,
7. Shqyrtimi i raportit përfundimtar të Komisionit Hetimor Parlamentar lidhur me procesin e vendimmarrjes në sektorin e energjisë për periudhën 2006-2022, në nivelin legjislativ, ekzekutiv, rregullator dhe në ndërmarrje publike.

Dnevni red

1. Usvajanje zapisnika sa prethodnih sednica,
2. Izjave van dnevnog reda,
3. Poslanička pitanja,
4. Prvo razmatranje Nacrt zakona br.08/L-178 o dopunama i izmenama Zakona br. 04 / L-101 o penzijskim fondovima Kosova, dopunjen i izmenjen Zakonom br. 04 /L-115, sa Zakonom 04 /L-168 i Zakonom br. 05 /L-116,
5. Razmatranje Izveštaja sa preporukama za nadzor nad sprovođenjem Zakona br. 06/L-046 o Inspektoratu obrazovanja u Republici Kosovo,
6. Razmatranje godišnjeg izveštaja Centralne izborne komisije za 2021. godinu,
7. Razmatranje završnog Izveštaja Parlamentarne istražne komisije o procesu donošenja odluka u energetsom sektoru za period 2006-2022, na zakonodavnom, izvršnom, regulatornom i nivou javnih preduzeća.

Mbledhjen e drejtoi nënkryetarja e Kuvendit, znj. Saranda Bogujevci.

KRYESUESJA: Të nderuar deputetë,

E nderuar zëvendëskryeministre,

I nderuar Kabinet qeveritar,

Po i hap punimet e seancës plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës sipas rendit të përgatitur nga Kryesia e Kuvendit në mbledhjen e mbajtur më 16 janar 2023.

E kemi një propozim për plotësim të rendit të ditës për këtë seancë. Por, para se të vazhdoj me këtë pikë, me Rregulloren e Re të Kuvendit më duhet t' ju njoftoj për emërimin e delegacionit të Kuvendit të Republikës së Kosovës në Asamblenë Parlamentare të Këshillit të Evropës, tash me Rregullore të re e kemi të obligueshme që të njoftojmë seancën.

Sipas nenit 16, paragrafi 5 të Rregullores së Kuvendit, kryetari i Kuvendit të Kosovës, së bashku me grupet parlamentare ka emëruar delegacionin në Asamblenë Parlamentare të Këshillit të Evropës me këtë përbërje:

Saranda Bogujevci, anëtare dhe kryesuese e delegacionit nga Grupi Parlamentar i Lëvizjes Vetëvendosje.

Arben Gashi, anëtar nga Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës,

Enis Kervan, anëtar nga Grupi Parlamentar Multietnik,

Ariana Musliu-Shoshi, zëvendësanëtare nga Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës,

Besnik Tahiri, zëvendësanëtar nga Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës,

Është edhe një vend tjetër për zëvendësanëtar që u takon pjesës së komuniteteve, ku i kemi njoftuar përfaqësuesit, deputetët nga Lista serbe, po që ende nuk kemi marrë ndonjë emër, kështu që presim nëse do të lajmërohen me propozim.

Kjo vetëm sa për informim.

Në pajim me nenin 53, paragrafi 1.2 të Rregullores së Kuvendit, kemi një propozim nga gjashtë (6) deputetë për plotësimin e rendit të ditës të kësaj seance plenare.

Propozimi është:

- Shqyrtimi i Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës për masat emergjente me furnizimin e energjisë me numër 04/118, të datës 11. 1. 2023

Ftoj shëfën e Grupit Parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje, Mimoza Kusari-Lila, që ta paraqesë dhe ta arsyetojë propozimin.

MIMOZA KUSARI-LILA: Faleminderit, e nderuar kryesuese Bogujevci!

Të nderuar kolegë deputetë,

Ashtu siç u cek, Qeveria e Republikës së Kosovës më 11 janar ka miratuar Vendimin për masat emergjente në furnizimin me energji, përderisa ky vendim i është sjellë Kuvendit të Republikës së Kosovës më 12 janar të këtij viti.

Siç parashihet me Ligjin për energji, neni 25, afati i përcjelljes së Vendimit të Qeverisë për Kuvend është brenda 3 ditëve të miratimit, gjë që të cilën Qeveria e ka bërë dhe pastaj afati i miratimit të njëjtit vendim nga Kuvendi i Republikës së Kosovës pas pranimit është 7 ditë kalendarike.

Duke marrë parasysh që ky dokument është sjellë dhe është protokolluar në Kuvendin e Republikës më 12 janar, sot është dita kur bëhen shtatë ditë kalendarike që kërkohet miratimi i vazhdimit të këtyre masave.

Andaj, për shkak të rrethanave, të cilat po vazhdojnë të jenë aktuale në furnizimin me energji elektrike për shkak të krizës dhe mundësisë së përkeqësimit të situatës në javët dhe muajt në vijim, ju ftoj që të miratoni plotësimin e rendit të ditës dhe si pikë të katërt të diskutojmë për Vendimin e Qeverisë për vazhdimin e masave emergjente në furnizimin me energji.

Faleminderit! Ju ftoj që ta miratoni këtë propozim.

KRYESUESJA: Nga Lidhja Demokratike e Kosovës fjalën e ka kërkuar deputeti Arben Gashi.

ARBEN GASHI: Faleminderit, e nderuar kryesuese!

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike e kundërshton propozimin e Grupit Parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje, sepse ky propozim është në kundërshtim me Ligjin për masat emergjente, është propozimi i shtatë me radhë që bëhet, janë tejkaluar 160 ditët e lejuara nga ligji dhe, po ashtu Qeveria e Republikës së Kosovës nuk e ka thënë asnjë përgjigje për pyetjet që janë shtruar tash e një vit me radhë lidhur me masat dhe veprimet që i ka ndërmarrë.

Pra, Qeveria e Republikës së Kosovës nuk është përgjigjur pse Termocentrali B2 prodhon 50 megavatë në orë energji elektrike se sa është dashur të prodhojë pas renovimit. Pra, renovimi dhe shpenzimi i miliona eurove e ka ulur prodhimin në B2 dhe po bëhen më shumë se shtatë muaj që Termocentrali Kosova A është jashtë funksionit, A5, jashtë funksionit më shumë se shtatë muaj dhe këtu vijnë na thonë të vazhdojmë masa emergjente. Çka është duke bërë kjo Qeveri? Dy stabilimente të cilat ishte dashur të prodhojnë energji elektrike dhe ta stabilizojnë kërkesën me ofertën, në këto rrethana për pa u përkeqësuar në mënyrë ekstreme kushtet e motit, nuk janë marrë masat e duhura, bile aty ku janë marrë masat rezultati është negativ. Prej 250 megavatë orë energji elektrike, ka rënë në 200 megavatë orë energji elektrike prodhimi dhe Kosova A5 është jashtë funksionit për më shumë se shtatë muaj. Çfarë masa emergjente duhet marrë? Çka do të

bëjë kjo Qeveri? Cilat janë pasojat e këtyre masave? Veç të shpenzojë qindra milionë euro nga buxheti i Kosovës, çka kanë bërë këta është: aprovo masa emergjente e shpenzo buxhet në mënyrë të paplanifikuar, asgjë tjetër. Veprime që është dashur të merren në Termocentralin Kosova A5 dhe B2 janë me rezultat negativ. Pra, B2 50 megavatë në orë më pak prodhon pas renovimit, pas shpenzimit të miliona eurove dhe A5 më shumë se shtatë muaj jashtë funksionit. Për ne kjo nuk ka kuptim, kjo është çmenduri e shpenzimit të qindra milionë eurove nga buxheti i Kosovës me rezultat negativ dhe për ne është e papranueshme dhe e papërkrahshme.

KRYESUESJA: Në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës, fjalën e ka Ferat Shala.

FERAT SHALA: Faleminderit, kryesuese!

Të nderuar kolegë deputetë,

Kabinet qeveritar,

Saktësisht do të flasim për problemet e energjisë, por jo për kërkesën e Qeverisë që sot na sjell. Po para se të elaborojmë kërkesën e Qeverisë, të shtatën me radhë, është obligim ligjor, është obligim njerëzor, është obligim kushtetues që ministrja të na tregojë pse e ka shfuqizuar rregulloren e investitorëve strategjikë, në të cilën rregullore i vetmi akt juridik ka qenë në fuqi pas skadimit të ligjit që kanë qenë kërkesa, gjashtë nga ata në sektorin e energjisë.

Pra, më 23.11., në mbledhjen e rregullt të Qeverisë së Kosovës me ftesë të kryeministrit, saktësisht në pikën e rendit të ditës 2.23 është në rend dite shfuqizimi i Rregullores për investitorët strategjikë dhe ju më thoni çka ka lidhje kjo me energjinë. Saktësisht me këtë rregullore është dashur të mbyllet procesi i kërkesave të investitorëve strategjikë në sektorin e energjisë, kërkesa këto jashtëzakonisht serioze dhe të gjitha në pjesën e sferës së investimeve strategjike në energjinë e pastër, të cilën ju si mazhorancë dhe si Qeveri edhe e keni proklamuar dhe e keni kërkuar. Pra, shtatë investitorë strategjikë, vendorë dhe ndërkombëtarë, kanë aplikuar më shumë se dy vjet presin përgjigje nga ju pse s'kemi mundësi të prodhojmë ne kapacitete energjetike me erë dhe me diell, dhe dëgjoni. Të vetmin akt juridik, pa i shqyrtuar dhe pa u dhënë përgjigje investitorëve, e keni shfuqizuar me unanimitet të plotë në mbledhjen e rregullt të Qeverisë dhe nuk u keni dhënë përgjigje investitorëve.

Ndodh tjetra anomali e madhe. Po të njëjtën ditë, pasdite, në orën 13:30, me ftesë të ministres thirrret Këshilli ndërministror, i obliguar në bazë të asaj rregullore, tubohet Këshilli ndërministror, gjashtë ministra dhe tre kryetarë komunash, mbajnë mbledhje pa akt normativ ligjor, mbajnë mbledhje me rend dite të ftuar nga ministrja dhe i kanë pikërisht në rend dite pikat e trajtesës së investitorëve strategjikë, i trajtojnë, i hedhin poshtë, i refuzojnë pa bazë ligjore, pa normë ligjore, pa ligj, pa rregullore, të njëjtit ministra paradite votojnë shfuqizimin e rregullores, pasdite të njëjtit ministra votojnë për kthimin negativ të investitorëve strategjikë mbështeten në rregulloren që e kanë shfuqizuar para dite.

Ju lutem...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESJA: I nderuar, të sqarohemi. Jemi duke diskutuar për rendin e ditës. Në momentin që hynë kjo pikë në rend të ditës, vetëm një sekondë, të lutem, pak respekt, të kisha lutur. Në momentin që futet në rend të ditës, e ke të drejtën e diskutimit.

(Polemikë)

Kur të mësoheni, i nderuar, të respektoni dikë tjetër, atëherë t'i jap edhe 30 sekonda për të vazhduar fjalimin. Shumë mirë isha duke ta sqaruar qysh shkon procedura me Rregullore të Kuvendit, nuk të kuptoj në sjelljen çfarë e ke.

(Ndërprerje nga regjia)

Neni 53, do t'ia jap fjalën dhe e përfundojmë, vetëm jo me këtë sjellje.

Neni 53, pika 2 ndër të tjera në paragraf thotë: “Diskutimi mund të zgjasë deri në 3 minuta për secilin diskutues”, i nderuar, 30 sekonda për të përfunduar për rend të ditës, i nderuar, jemi duke folur për rend të ditës. Në momentin që e fusim në rend të ditës këtë pikë, e keni secili të drejtën.

FERAT SHALA: Në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike nuk e mbështetim këtë nismë të korruptuar, të zhytur thellë në korrupsion dhe në mafinë energjetike të vendit, nuk ka mbështetje, jua elaboroj tash.

KRYESUESJA: Në emër të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës e ka fjalën deputeti Pal Lekaj.

PAL LEKAJ: Faleminderit, nënkryetare!

Të nderuar ministra,

Të nderuar deputetë,

Qytetarë të Republikës së Kosovës,

Është propozimi i shtatë i vendimit për shpalljen e masave emergjente në energji.

Thua që sot ka ndodhur kriza energjetike, thua që sot në mënyrë të ngutshme duhet të miratohet ky vendim, thua që kriza energjetike nuk ka ndodhur para një viti në vend që të procedohet plotësim-ndryshimi i ligjit, prapë na kërkohet neve që të marrim vendime të paanalizuara dhe që i kushtojnë buxhetit të Kosovës shumë.

Pse kjo Qeveri e fjetur çdo herë merr vendime ad hoc, të ngutshme, për të krijuar mjegulla që me të vërtetë krijojnë hutë të madhe të qytetarëve. A thua s'keni pasur kohë që të procedohet ligji, a thua s'keni pasur kohë që të vini me analizë dhe me ato plane që i kemi kërkuar edhe në Komisionin për Ekonomi, edhe nga Parlamenti dhe sot prapë vini me vendimin e shtatë, pse kështu? Është dashur që sot të jetë në rend dite Ligji për plotësim-ndryshim dhe të mos vihet me kësi vendimesh që nuk shkojnë në favor të qytetarëve dhe e dëmtojnë buxhetin e Kosovës.

Ajo që mund të them, Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, grupi parlamentar nuk do ta mbështetë vendimin që e keni pruar sot dhe as mocionin procedural. Faleminderit!

KRYESUESJA: Në rregull, atëherë për plotësimin e rendit të ditës Kuvendi vendos me 2/3 e deputetëve të pranishëm në seancën plenare, pra që marrin pjesë në votim.

Vetëm ta shohim si është situata me kuorum.

Në sallë janë të pranishëm 86 deputetë, duket se ka, edhe disa deputetë të tjerë u kthyen në sallë. 89 deputetë janë të pranishëm.

Të nderuar deputetë,

Ju lus që me ngritje dore të deklaroheni për plotësimin e rendit të ditës të seancës plenare.

Kush është për?

Kush është kundër?

Kush abstenon?

77 deputetë kanë marrë pjesë në votim, për kanë qënë 51, kundër 36, që nuk mund të hyjë domethënë në rend të ditës.

Vazhdojmë me pikat e radhës.

Të nderuar deputetë,

Para se të vazhdojmë me pikat e rendit të ditës, nëse mundeni pak qetësi ju lute! Dua të shfrytëzoj rastin t'i përsënder dhe t'i përsënderim, në fakt, në emrin e të gjithë neve të gazetarëve ukrainas, që i kemi sot të pranishëm në Kuvendin e Republikës së Kosovës, të cilët janë në Kosovë.

(Duartrokitje nga salla)

Vetëm për t'i ndarë disa të dhëna. Gazetarët ukrainas i kemi në Kosovë në kuadër të programit Gazetarët rezidentë, të organizuar nga Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës, Qendra Evropiane për Liri, Shtyp dhe Media dhe natyrisht, të mbështetur nga Qeveria e Republikës së Kosovës.

Mysafirët i kemi të shoqëruar nga përfaqësuesja e AGK-së, Zyra Ligjore e ECPMF-së, Flutura Kusari. Dhe, sot janë këtu për të përcjellë punimet e Kuvendit të Republikës së Kosovës, domethënë të kësaj seance plenare.

Natyrisht, që si Kuvend, por edhe si shtet, që në fillim kemi qenë krah jush dhe afër jush për t' ju përkrahur në një luftë të padrejtë, nëpër të cilën po kaloni. Kosova do të jetë gjithherë pranë Ukrainës. Shpresojmë që ky vit të jetë vit ku do të mbërrijë të përfundojë kjo luftë e ashpër dhe shumë e padrejtë ndaj popullit tuaj.

Edhe një herë, mirë se erdhët në Kuvendin e Republikës së Kosovës!

Vazhdojmë me pikat e rendit të ditës:

1. Miratimi i procesverbalit nga seancat e mëparshme

Po flasim për seancën plenare të mbajtur më 22 dhjetor. Nëse nuk ka kundër, atëherë konstatoj që Kuvendi miraton procesverbalin e seancës të mbajtur më 22 dhjetor.

Vazhdojmë me pikën e radhës:

2. Deklarime jashtë rendit të ditës

Siç e dini, koha e deklaramit jashtë rendit të ditës është e kufizuar deri në 40 minuta, në emër të grupit 5 minuta dhe diskutues individualë, domethënë deputetët janë nga 3 minuta. Deputeti që paraqitet duhet të deklarojë nëse do të flasë në emër të grupit, apo si deputet.

Vazhdojmë! Nga Lëvizja Vetëvendosje fjalën e ka deputeti Artan Abrashi.

ARTAN ABRASHI: E nderuar kryesuese e Kuvendit,

Të nderuar ministra,

Të nderuar deputetë,

Të dashur qytetarë,

Më datë 15 janar të këtij viti Kosova përkujtoi sërish krimet monstruoze të 15 janarit 1999 në Reçak, të cilat njëzetekatër vjet më parë forcat serbe vranë 45 shqiptarë të fshatit. Ata ndanë meshkujt nga familjet e tyre dhe pastaj i ekzekutuan në malin në afërsi të fshatit. Këto krime monstruoze shënuan kthesën historike, jo vetëm nga mizoria e krimeve serbe, që morën trajtën

më çnjerezore, por ishte edhe një pikë kthese, në të cilën bashkësia ndërkombëtare veproi përfundimisht për ta mbrojtur një popull që po vuante nga mizoria e një regjimi gjenocidal, por edhe për të dëshmuar që bota demokratike nuk mund të dorëzohet para një regjimi hegjemonist, prandaj edhe populli i Kosovës duhet të ndihmohet dhe të mbrohet.

Ky moment kthese lidhet edhe me ambasadorin amerikan, Wiliam Walker, shef i atëhershëm i Misionit Verifikues të Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim Evropian, që t'i kumtojë botës krimet kundër njerëzimit që ishin bërë në Reçak. Duke mbrojtur një popull të shtypur, që rrezikonte të shfarosej nga një regjim gjenocidal, zëri i ambasadorit Walker u bë zëri i viktimave që kërkonin drejtësi.

Këto krime i dëshmuar botës për tragjedinë që po e përjetonin shqiptarët dhe e bënë të pashmangshme ndërhyrjen e botës demokratike për ta ndalur këtë regjim gjenocidal. Këto krime kundër njerëzimit nuk mund të fshihen më nga ky regjim gjenocidal, por të masakruarit do të vriten për së dyti nga propaganda dhe gënjeshtria e vazhdueshme e makinerisë serbe, të cilën e udhëhiqte asokohe dhe vazhdon të udhëheq edhe tani presidenti aktual i Serbisë.

Masakra e Reçakut i dëshmoi botës mizorinë e regjimit të Serbisë dhe të drejtën e shqiptarëve për të jetuar të lirë.

Të nderuar deputetë,

Sot kur i rikujtojmë me dhembje të dashurit tanë, të cilëve regjimi gjenocidal ua mori jetën, drejtësia për ta dhe siguria për brezat e ardhshëm bëhet synimi ynë më i rëndësishmi.

Të nderuar deputetë,

Në këtë muaj të janarit, po ashtu rikujtuam vrasjen e vëllezërve Jusuf e Bardhosh Gërvalla dhe bashkëveprimtarit të tyre Kadri Zeka, të cilët 41 vjet më parë shërbimi sekret i Jugosllavisë i vrau në Gjermani. Arsyeja e këtij atentati kriminel të autoriteteve të Serbisë ishte aktiviteti i tyre për më shumë liri, për liri të plotë për shqiptarët, për çlirimin e Kosovës dhe për Republikën e Kosovë.

Të tre këta bashkëveprimtarë treguan një formim të lartë intelektual të një aktivisti të përbetuar për shtrirjen e aktivitetit të tyre për lirinë e popullit shqiptar dhe për çlirimin e Kosovës. Në një kohë sfiduese dhe në rrethana tejet të rrezikshme ata arritën të shtrijnë aktivitetin e tyre politik dhe artikuluan qëndrimet politike, që më pastaj do të vazhdojnë nëpër organizatat politike e ilegale të kohës.

Trashëgimia e tyre është shumë e pasur. Shumë këngë e vepra letrare do të vazhdohen të lexohen e të studiohen nga brezat e ardhshëm. Këto vepra janë një faqe e historisë së një kohe, kur Serbia shtypte dhe diskriminonte shqiptarët mbi baza etnike, fetare e gjuhësore. Burgoste, përndiqte e

vriste çdo qytetar që kishte guxim politik për të kundërshtuar shtypjen dhe për të ngritur zërin kundër gjendjes së shqiptarëve në ish-Jugosllavi.

Lavdi Kadri Zekës, Jusuf e Bardhosh Gërvallës, mes dëshmorëve që vepruan deri në vdekje për lirinë e Kosovës!

Lavdi gjithë të rënëve për luftën për liri dhe çlirim të Republikës së Kosovës!

Faleminderit!

KRYESUESJA: Në emër të Partisë Demokratike të Kosovës, kryetari Memli Krasniqi e ka fjalën.

MEMLI KRASNIQI: Të nderuar kolegë deputetë,

Kabinet qeveritar,

Të dashur qytetarë,

Sot në seancën e parë të rregullt të sesionit pranveror, tashmë dy vjet nga fillimi i Qeverisë Kurti 2, do të duhej të flisnim për programe e për projekte konkrete që do t'ua lehtësonin jetën qytetarëve tanë, të flisnim për përmirësim të cilësisë në arsim, shëndetësi, për rritje ekonomike, për investime infrastrukturore strategjike, për njohje të reja të shtetit tonë e për realizim të premtimeve të panumërta të kryeministrit Kurti. Ose, të paktën kjo të ishte një seancë normale parlamentare, ku të gjithë do të diskutonim për të ardhmen.

Po, fatkeqësisht këtë nuk mund ta bëjmë dhe kjo për dy arsye. E para, jo vetëm që nuk ka progres në asnjë sektor, por ka regres dhe degradim të secilit prej tyre, që nga shëndetësia, te diplomacia, njohjet e çdo gjë tjetër.

Dhe, e dyta, ka disa muaj që kjo Qeveri e kryeministri në veçanti, që nuk po ka guxim që ta trajtojë një virus helmues për shtetin. Më 21 prill të vitit të kaluar mediat sllovene raportuan për skandalin e madh financiar, në të cilin ishte përfshirë ambasadori i Kosovës në Kroaci, Martin Berishaj, që fiks 273 ditë. Dy gjëra diametralisht të kundërta e kanë karakterizuar këtë skandal.

E para, për nëntë muaj raportimet për aferën Martin Berishaj kanë ardhur duke u shtuar, faktet duke u zbuluar, akuzat duke u ngritur e dyshimet duke gjetur rrugë deri tek kryeministri Albin Kurti e Lëvizja Vetëvendosje.

E dyta, reagimi institucional nga kryeministri, presidentja e ministrja e Punëve të Jashtme në shpërputhje me zhvillimet e seriozitetin e këtij rasti, kanë ardhur duke u zvogëluar, duke tentuar që përmes heshtjes, mostransparencës dhe papërgjegjësisë, ta heshtin, fshehin, apo ta tejkalojnë këtë situatë. Por, po gabojnë aq shumë, sa vetëm po e konfirmojnë se edhe vetë janë të përfshirë.

Ky skandal i madh korrupsioni, jo vetëm që ka dëmtuar reputacionin e diplomacisë e të shtetit tonë, po kjo shkon dhe më tej. Si mundmi t'ua shpjegojmë qytetarëve e fëmijëve tanë, të cilët duam t'i rrisim si qytetarë të mirë e të ndershëm, se një ambasador që duhet ta përfaqësojë denjësisht vendin tonë në botë, tërhoqi mbi një milion e pesëqind mijë euro kesh, të marra prej një kompanie serbe që tregton energji. Si i shkon për shtati ky skandal imazhit të një shteti të ri që në tentimin e tij për të përqaftuar vlerat evropiane, në skandal si ky, jo vetëm që shpëton pa pasoja, por edhe mbulohet nga kryeministri e Qeveria e tij.

Si ua shpjegon kryeministri këtë të gjithë qytetarëve që e votuan atë dhe zotimin e tij për ta luftuar korrupsionin? Derisa shumë fakte janë zbardhur dhe po zbardhen çdo ditë, më shumë pyetje po shtohen, të cilat fatkeqësisht po vazhdojnë të mbeten pa përgjigje. Prandaj, kryeministri duhet të vijë këtu në shtëpinë e popullit, para qindra e mijëra njerëzve që na shohin, e t'u përgjigjet disa pyetjeve. Në mesin e tyre janë edhe këto pyetje:

1. Si mundet dikush ta marrë nënshtetësinë në një ditë dhe qysh të nesërmen të emërohet ambasador, një nga postet më të nderuara që mund ta japë një shtet?
2. Si e mori dritën e gjelbër Martin Berishaj nga organet e Inteligjencës së Kosovës?
3. Si është e mundur që pas gjithçkaje që dimë tash, ministrja e Punëve të Jashtme deklaroi pikërisht këtë javë se ajo i beson Martin Berishës ende, e jo fakteve të panumërta?
4. Si është e mundur, që ambasadori Martin Berishaj është ende në detyrë dhe nuk është shkarkuar e as nuk është thirrur menjëherë në Kosovë për hetime të mëtejme?
5. Po zërat në media ndërkombëtare, që dy milionë euro të gatshme janë përdorur për financimin e fushatës zgjedhore të Vetëvendosjes? Pse nuk ka përgjigje për këta zëra, qoftë edhe me ato videot e juaja “Çka ka, çka s'ka.”?
6. Si mundet kryeministri me një lidhje shumë të ngushtë me Martin Berishajn, që është e vërtetuar me dhjetëra foto personale, si kjo që reflekton veç dashuri në mes tyre, të heshtë për këtë skandal? A mundet, të paktën, të na thotë pse? Çka po e ndal? A është duke e ndalur Martini vetë?

Që prapa ambasadorit Berishaj fshihet lidhja e thellë e këtij pushteti me mafinë energjetike të rajonit, tashmë edhe ju shumë deputetë të mazhorancës e dini, e keni kuptuar, prandaj ju takon të flisni, të shpjegoheni.

Qytetarët e Kosovës meritojnë përgjigje për këto pyetje. ata meritojnë të dinë të vërtetën e plotë për këtë skandal, për të cilin kemi shumë arsye të besojmë se është veç maja e një icebergu

gjigant. Tashmë është vonë dhe shkarkimi i ambasadorit Berishaj më nuk mjafton. Duhet të bëhen hetime serioze dhe t'u jepet përgjigje këtyre pyetjeve juridikisht, politikisht e moralisht. Martin Berishaj duhet të sillet para drejtësisë dhe kushdo qoftë, që është në këtë piramidë.

KRYESUESJA: Nga Lidhja Demokratike e Kosovës fjalën e ka kryetari Lumir Abdixhiku.

LUMIR ABDIXHIKU: Faleminderit, e nderuar kryesuese!

Të nderuar anëtarë të Kabinetit qeveritar,

Deputetë të Kuvendit të Kosovës,

Zonja e zotërinj,

Po e nisim sesionin e ri parlamentar me më shumë paqartësi e fatkeqësisht, edhe më shumë skandale, se sa që e mbyllëm atë paraprak.

Po e nisim sesionin e ri me një veri të normalizuar në jonormalitet. Dy muaj tensione, politika të pakoordinuara me aleatë, sulme të pareshtura ndaj Policisë, për t'u kthyer në një gjendje normale, por që megjithatë s'trajtohet si e tillë. Dhe, le ta themi qartë, gjendja në veri nuk është sot normale.

Në emër të sovranitetit Kosova, Republika jonë nuk ka pasur kurrë më pak sovranitet. Në emër të ligjshmërisë, Kosova nuk ka pasur kurrë më pak ligjshmëri se sa që ka sot. Ka tre muaj që në veri nuk kemi polici të rregullt, ka tre muaj që në veri nuk kemi prokurorë, gjyqtarë e s'kemi as pushtet komunash dhe, për më tepër, s'kemi as zgjedhje të lira e demokratike për të zgjedhur këtë pushtet lokal. A është ky sovraniteti i një shteti brenda territorit të vet?

Përveçse liruan një të akuzuar për terrorizëm në arrest shtëpiak, përveçse dështuan ta sjellin të njëjtin para drejtësisë, përveçse arritën ta normalizojnë ndërkombëtarisht cilësimin e barrikadave si mjete paqësore, përveçse amnistuan secilin barrikadues, përveçse dështuan të mbajnë zgjedhje të lira demokratike në territorin e Kosovës, për herë të parë ky pushtet, me gjithë paaftësinë ka arritur mjeshtërisht ta rikthejë çështjen e veriut në tavolinë, në kohën kur pritej një marrëveshje finale.

Gjendja e sotme në veri është dorëzim i interesave shtetare të Kosovës para dialogut dhe para vetë Serbisë. Kemi rënë në grackë të tyre dhe fatkeqësisht për këtë Qeveria jonë, përgjegjësit e kësaj gracke, as që janë në dijeni. Dhe, kjo rënie në grackë na forcohet dhe me deklarime të papërgjegjshme të vetë pushtetarëve, të atyre që tashmë thonë dhe publikisht, se njohja e Kosovës nuk parashihet me marrëveshje. Ky është dorëzim para rrugëtimit tonë shtetar, ky është devijim nga çdo përpjekje e jona kolektive për marrëveshje finale, që na hap rrugëtimin integrues përpara.

Kosova nuk duhet të ketë marrëveshje bazë dhe Kosova nuk duhet të ketë marrëveshje pa njohje brenda saj! Ky është momentum ynë. I duhet njohja Kosovës, i duhet marrëveshja përfundimtare me Serbinë.

Dhe, në mesin e shumë ngjarjeve të tjera, përveç veriut dhe dialogut dhe rrugës së theqafjes, që kjo Qeveri na shpie gjithë, s'kam se s'i të mos përmend dhe dy skandale të mëdha të ndodhura këto ditë. I pari ka të bëjë me një ambasador të Kosovës në Kroaci, Martin Berishaj, dhe gjithë amnistinë blanko të dhënë ndaj tij nga pushtetarët tanë.

Ky ambasador duket që është i lidhur, jo vetëm politikisht, po edhe financiarisht me mbrojtësit e tij. Sipas raportimeve tashmë të bëra publike janë tërhequr nga ai në mes të Prishtinës 1.4 milionë euro para të gatshme, "cash". Këto para janë transferuar nga Kompania Energjetike G&I me seli në Beograd. Këto mjete, ky biznes, janë mbajtur fshehtë. Prandaj, ambasadori ka dy kallëzime penale sot: një për shpëlarje parash e shmangie tatimesh dhe një tjetër për fshehje të pasurisë. Por, ai vazhdon të marrë mbrojtjen e rezervë të pushtetarëve, përkundër fakteve të qarta të bëra publike.

Dhe, ai do të ketë dhe një kallëzim penal të ri për deklaram të rrejshëm brenda Komisionit Hetimor Parlamentar, të cilin fatkeqësisht, pushteti, partia shumicë, e ka bojkotuar në takimin e fundit.

Skandali i dytë ndërsa na lidhet me rehabilitimin e një kriminelit të luftës, Oliver Ivanoviq, bartësit të formacionit famëkeq "Rojat e Urës", i cili nga ky pushtet na portretizohet, besoni ose jo, si njeri e emër që ka kontribuar në një Kosovës shumëtnike. Oliver Ivanoviq, pra njeriu që pushteti e kryeministri Kurti e cilëson si kontribuues të një Kosove shumëtnike, ka qenë i dënuar me nëntë vjet burgim në shkallë të parë për vrasjen e 31 civilëve shqiptarë. 31 civilë shqiptarë nga njeriu multietnik i Albin Kurtit.

Dhe, kur i dëgjoj dhe deputetët e komentatorët e pushtetit, që e cilësojnë këtë gjest si taktikë, kaq lehtë gjaku i civilëve shqiptarë na shndërrohet si një taktikë politike! Është turp! Është monstrum politik, që s'guxojmë ta lejojmë të ndodhë në Kosovë.

Dhe, teksa shikojmë këto dy skandale... Nëse mundem, kryesuese? 30 sekonda, të lutem?

KRYESUESJA: Regjia, ia mundësoni ta përfundojë fjalën.

LUMIR ABDIXHIKU: Ju faleminderit shumë!

Teksa shikojmë këto dy skandale që na shpërfaqen, sehshazi nga ky pushtet e kjo Qeveri, pyetja ime e vetme është për qytetarët e vendit: a është ky ndryshimi për të cilin kemi pasur nevojë të

gjithë? Që të amnistohen të korruptuarit, njerëzit e korruptuar pra që kanë lidhje me pushtetin e të rehabilitohen kriminelët e luftës për më shumë pushtet?

Sot në këtë Kuvend kam dy kërkesa, shkarkim për të parin dhe mbajtje përgjegjës për secilin të ndërlidhur me të, kërkimfalje për lartësimin e një kriminelit të luftës nga Kryeministri i Kosovës. Kosova meriton më mirë, Kosova mundet më shumë. Ju faleminderit!

KRYESUESJA: Në emër të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, fjalën e ka Time Kadrijaj.

TIME KADRIJAJ: Nënkryetare e Kuvendit, faleminderit!

Të nderuar deputetë,

Tani është bërë normale të dëgjojmë për skandalet e njëpasnjëshme të Qeverisë Kurti. Lajmet për aferat korruptive, amnistinë e kriminelëve, ngritja e aktakuzave për ministra e zv.ministra, më nuk janë befasuese për këtë Qeveri.

Këta njerëz që dikur e quanin Qeveri e shpresës, arritën që për një kohë rekord shpresën e qytetarëve ndaj tyre ta shndërrojnë në zhgënjim, madje duke shpërfaqur haptazi edhe qasjen mashtruese në pothuajse të gjitha temat me rëndësi.

Sot kemi një Kryeministër i cili Kosovën e ka dëmtuar me veprimet e tij të pamatura, duke shkaktuar dëme të mëdha. Në qasjen e tij, me apo pa qëllim, ka arritur që Kosovën ta paraqesë si faktor destabilizues te faktori ndërkombëtar e Serbinë si palë konstruktive. Në sytë e opinionit ndërkombëtar, sot Kosova paraqitet si vend jostabil dhe me mundësi të ndezjes së një konflikti e në të njëjtën kohë e luan turistin me paratë e taksapaguesve, duke u bërë thirrje bizneseve të huaj për investime në vend. Po si do të vijnë investitorët e huaj të investojnë kur vetë Kryeministri dhe Qeveria vendin dhe Kosovën e paraqesin dhe e kanë bërë një vend destabilizues.

Do të ishte mirë Kryeministri të na tregojë cili është rezultati i deritanishëm gjatë këtyre ekskursioneve të tij nëpër botë dhe a ka rritje të investimeve të huaja direkte? Ky fillimvit doli të jetë mjaft interesant. Vetëm brenda një jave dy njerëz që Kryeministri Kurti u besoi pozita të rëndësishme, u zunë me rryshfet. Po për këto raste, Qeveria ende nuk ka marrë asnjë masë. Nuk e ka shkarkuar asnjërin. Sa për dështimet e skandalet e ministres së jashtme, nuk ia vlen as t'i përmendim, sepse nuk na mjafton koha. Por nuk mund të heshtim për aferën korruptive të ambasadorit të Kosovës në Kroaci, i cili po del të jetë figurë e rëndësishme dhe e paprekshme në këtë Qeveri. Zoti ambasadori brenda natës e ka marrë shtetësinë dhe nuk është verifikuar as nga AKI-ja. Pse po hesht Qeveria, pse po hesht Presidentja?

Heshtja e Kryeministrit dhe mosguximi për të shkarkuar ambasadorin, lë të nënkuptojë se këtu mund të ketë diçka më shumë sesa veç një raport kolegial apo zyrtar. Është e kuptueshme që Kryeministri nuk e ka lehtë ta shkarkojë mikun e ngushtë të tij me të cilin shihet në fotografi

duke shijuar verëra të shtrenjta, por të paktën nga ai pritjet të marrë veprime të natyrës morale, sepse është thirrur vetë në qeverisje me duar të pastra.

Kryeministri Kurti nuk po del i aftë vetëm me amnistimin dhe mbrojtjen e njerëzve të tij të përfshirë në afëra korruptive. Ai me deklaratat e tij të para disa ditëve, një njeri të dënues për krime lufte, e portretizoi si një figurë i cili dha kontribut të çmuar në shërbim të bashkëjetesës dhe vendit. ciësimi i Ivanoviqit si person që punoi për një Kosovë shumetnike është pafytyrësi dhe krim ndaj historisë dhe familjeve të viktimave.

Nëse pak do të kishti dinjitet, ky Kryeministër do të duhej që të paktën ta tërheqë atë deklaratë dhe t'i kërkoj falje familjeve të viktimave që kanë pësuar. Ndërsa këto ditë kemi pasur një numër të madh të veteranëve të luftës të cilët kanë vdekur, kemi pasur të vdekur edhe eprorë të lartë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe të cilët kanë kontribuar edhe gjatë luftës edhe pas luftës. Është rasti me profesorin e nderuar Sabaudin Cena dhe ne nuk kemi pasur asnjë reagim të Kryeministrit, asnjë reagim të Presidentes, asnjë reagim të kësaj Qeverie. E kemi pasur dhe ka vdekur një epror i lartë i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, një invalid i luftës, një i burgosur politik dhe asnjë reagim nga z. Kurti dhe asnjër raeagim nga Presidentja. Ky është eprori i lartë i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, epror në FSK, Cel Aliçkaj.

Ju lutem deputetë,

Në këtë rast, meqenëse s'ka reaguuar as Qeveria, unë ju ftoj që për këto figura të rëndësishme të kombit shqiptar ta mbajmë një minutë heshtje.

Lavdi dhe i përjetshëm qoftë kujtimi për ta!

KRYESUESJA: Nga Lëvizja Vetëvendosje, fjalën e ka Armend Muja.

ARMEND MUJA: Të nderuar deputetë!

I nderuar Kabinet qeveritar,

Qytetarë të Kosovës,

Para se të filloj, duhet të zgjerohem pak sa i përket z. Martin Berishaj dhe kompanisë së ashtuquajtur serbe GEN. Ajo çfarë ne e dimë, është që kompania e ashtuquajtur serbe GEN ka filluar të punojë në Kosovë në vitin 2008, kurse kontratat e fundit i kemi nënshkruar me datë në v. 2020 dhe këto kontrata i ka nënshkruar Nijazi Thaçi. E ka sjellë PDK-ja GEN-in këtu.

E dyta, ne e bëmë një komision hetimor për energji. Për mua ishte e befasishme paraqitja e z. Berishaj para komisionit hetimor. Gjithë ato përshëndetje, lavdata ndaj njëri-tjetrit pa pyetje. Kjo ishte e turpshme. Cilat ishin gjetjet e komisionit hetimor? Asgjë. Por meqenëse u dashka edhe një komision hetimor për ambasadorët, unë propozoj që të kemi një komision hetimor për katër milionë franga të padeklaruara nga ish-ambasadori Akan Ismaili në kuadër të skandalit... Swiss.

Ai ka qenë ambasador dhe nuk i ka deklaruar ato. Ta shohim a ka diçka aty. Ajo është relevante se ka qenë po ashtu edhe operator i Bektel-Enkës, të cilët kanë bashkëpunuar me Zvonko Veselinoviq. Edhe për mua po më intereson, a ka pasur ndonjë skandal aty. Hajde ta lancojmë një komision hetimor dhe t'i hetojmë të gjithë ambasadorët.

Tjetra, komision hetimor nga Kuvendi. U tha shumë këto ditë lidhur me eliminimet fizike të kundërshtarëve politikë të Vuçiqit, por u harrua këtu të përmendej e të sqarohej se në vitin 2013 këtu në këtë sallë me gjithë kundërshtimet është miratuar Ligji për amnistimin e strukturave ilegale të Serbisë në Kosovë e pas kësaj i ashtuquajturit integrim i tyre në strukturat e sigurisë dhe drejtësisë. Çfarëdo që ne e akuzojmë Oliver Ivanoviqin që ka bërë pas luftës e kemi amnistuar në këtë Kuvend në vitin 2013. Po në këtë vit famëkeq, pra 2013, u themelua Lista Serbe, prodhim i negociatave dhe skemës politike e kriminale të Vuçiqit. Prej asaj kohe e deri më sot, në katër komunat në veri të vendit, dhjetëra ngjarje e incidente me cenim të integritetit fizik, të pronës, shantazhe e kërcënime u ka ndodhur çdokujt që nuk ka qenë me Listën Serbe apo nuk i është nënshtruar Listës Serbe. Madje vetë Lista Serbe ka filluar karrierë.

KRYESUESJA: Regjia, ia mundësoni ta përfundojë fjalën.

ARMEND MUJA: Lista Serbe ka filluar karrierën politike në Kosovë me eliminimin e kundërshtarëve politikë. Më 16 janar 2014, u ekzekutua ish-kandidati nga radhët e SLS-së për Komunën e Mitrovicës së Veriut, Dimitrije Janiçeviq. Më 10 janar ia kishin djegur veturën dhe e kishin sulmuar me armë. Emrat e përfolur kanë qenë Zvonko Veselinoviq, Milan Radojqi, Andrej Bojqi, djali i ish-komandantit të Policisë në Mitrovicën e Veriut dhe Bratislav Dikiq, ish-shëfi i xhandarmërisë serbe. Asnjë hetim, asnjë konkluzion. Bratislav Dikiq ka qenë i dënuar për puçin në Mal të Zi.

Radha e njëjtë e kërcënimit u përsërit edhe ndaj çdo kandidati që e ka rivalizuar Listën Serbe. Ish-kandidati për kryetar të Komunës së Leposaviqi, Dragan Jabllanoviq është sulmuar me armë.

KRYESUESJA: Nga Partia Demokratike e Kosovës, fjalën e ka Blerta Deliu-Kodra.

BLERTA DELIU-KODRA: Të nderuar kolegë deputetë,

E nderuar znj. Bogujevci,

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Në fakt, edhe pse kanë kaluar dekada nga lufta e plagët e kujtimet tona janë ende të hapura për krimet e tmerrshme të cilat kanë ndodhur më 14 e 16 prill të vitit. 1999 e 3-4 shkurt të vitit 2000, ku u vranë dyzet shqiptarë civilë të pafajshëm e u dëbuan dhjetëra mijëra të tjerë nga shtëpitë e tyre, njëri prej kriminelëve përgjegjës që ishte edhe udhëheqës i këtyre operacioneve ishte Oliver Ivanoviq, shef i paramilitarëve të Rojeve të urës, i shpallur fajtor nga gjykatësit e EULEX-it dhe i dënuar me dhjetë vjet burgim për vrasje, spastrim etnik të shqiptarëve nga veriu i Kosovës.

Kush do ta imagjinonte një ditë si kjo që një kriminel lufte do të glorifikohet e do të nderohet nga Kryeministri i Kosovës me një lehtësi të padurueshme. Shteti i Kosovës i thuri lavde një kriminel duke e cilësuar të hapur, të singertë, të mbrehtë e të respektueshëm e si njeri që punoi për të ardhmen e qëndrueshme edhe për një Kosovë shumetnike.

Rrethanat e vrasjes së Ivanoviqi natyrisht se duhet të sqarohen nga institucionet e drejtësisë, por as sot askush nuk mund ta bëjë atë hero, nuk mund ta amnistojë, as t'i ndryshojë biografisë e tij. Për më tepër, kjo që ka bërë Kurti është fyerje e rëndë për viktimat, është fyerje e rëndë për familjet e tyre, është fyerje e rëndë për institucionet që mundësuan përballjen e tij me drejtësinë. Është dekurajim për secilin që angazhohet për drejtësi për viktimat, për dënim dhe përgjegjësit e krimeve. Fyerje edhe për secilin nga ne në këtë sallë që përfaqësojmë qytetarët e Kosovës. Është poshtërim e ofendim për të vërtetën tonë historike, për organizatat e dala nga lufta, zërin e të cilave po përpiqeni ta ndalni edhe në përvjetor masakrash, siç ishte rasti i fundit në akademinë perkujtimore të 24-vjetorit të masakrës së Reçakut, ku ish-luftëtarë të UÇK-së, Adem Ramadani iu mohua e drejta e fjalës. Kryeministri Kurti thuri elozhe për Ivanoviqin, ndërkohë që nuk e pa të arsyeshme të thotë asnjë fjalë të vetme për punën dhe angazhimin në të mirë të Kosovës të dy ushtarëve të UÇK-së që i humbën këto ditë janari, Sabaudin Cena e Cen Aliçkaj. Pra mirënjohje për kriminelët, z. Muja, e mohim për çlirimtarët.

Kishte edhe të tillë të cilët thanë që nuk është dita sot të flasim për krimet e Oliver Ivanoviqit. Kishte të tillë që vijnë nga qyteti i Mitrovicës, e kanë parë për së afërmi krimin makabër që e ka bërë Oliver Ivanoviqi që udhëhiqte rojet e urës. Ky amnistim natyrisht që është i pafalshëm.

Kryeministri Kurti ka bërë një gabim të madh e të pafalshëm. Unë besoj se për një gjë të tillë nuk pajtohet as Kryetari i Kuvendit. Sa për Presidenten, ne e kemi parë qartë se çfarë ajo mendon. Prandaj, sot kërkujmë që Kryeministri të kërkojë falje publike dhe të distancoheni kolegë nga deklaratat.

KRYESUESJA: Nga Lidhja Demokratike e Kosovës, fjalën e ka Driton Selmanaj.

DRITON SELMANAJ: Faleminderit, kryesuese!

Shumë të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuar njerëz që po na shikoni,

Tashmë ka kaluar në zakon publik që skandalet, aferat dhe veprimet e dëmshme për vendin të jenë aq të shpeshta sa që ta zënë njëra-tjetrën dhe të mos kemi kohën e mjaftueshme as si deputetë, as si shoqëri të japim vlerësimin dhe momentin e duhur për çështjen e caktuar.

Nuk mund dhe nuk duhet asnjëherë të lejohet dhe nga askush që me lehtësi dhe shpejtësi të hiqet nga vëmendja skandali tejet fyes që Kryeministri Kurti i bëri Kosovës kur e glorifikoi figurën e

Oliver Ivanoviqit, figurën e një personi të cilin Gjykata Themelore e Mitrovicës e përbërë nga gjyqtarë ndërkombëtarë të EULEX-it e kishin shpallur fajtor për krime lufte kundër civilëve shqiptarë gjatë periudhës 1999-2000 ku edhe e kishte dënuar me nëntë vjet heqje lirie.

Kush i dha të drejtën këtij kryeministri ta amnistojë dhe rehabilitojë figurën e atyre që vranë, masakruan dhe dëbuan nga shtëpitë e tyre mijëra shqiptarë? Kush i dha të drejtën këtij Kryeministri që një vrasësi të shqiptarëve t'i japë epitete, e citoj: një person i singertë, një person i hapur, i përkushtuar, një person i mprehtë dhe i respektueshëm, një person që punoi për të ardhmen e qëndrueshme dhe punoi për Kosovën shumetnike. A nuk është ky person që Kurti dhe Lëvizja Vetëvendosje para pak vitesh thoshin se ai është kriminel lufte? Se ai është përgjegjës për vrasjen e dhjetëra shqiptarëve në veri të Mitrovicës, se ai është përgjegjës për dëbimin e dhunshëm të mbi njëmbëdhjetë mijë njerëzve shqiptarë që kanë jetuar në veriun e Mitrovicës. Çka ndryshoi tash? Pse ndryshoi tash? Çka po ndodh me personalitetin e këtij Kryeministri? Çka po ndodh me heshtjen e bartësve të tjerë të institucioneve të larta shtetërore? Çka është ky solidarizim e qasje ndaj veprimeve antishqiptare? A do të thotë kjo që të gjitha institucionet mendojnë kështu? A kaq keq jemi katandisur si vend, si shtet?

Të nderuar kolegë deputetë,

Ky veprim dhe kjo qasje e Kryeministrit Kurti nuk është një veprim i një njeriu privat dhe të izoluar. Fatkeqësisht, është një veprim i Kryeministrit të Republikës së Kosovës, i kësaj Kosove, i kësaj republike që dha gjithçka për lirinë e saj. Prandaj, një veprim i tillë është veprim kundër historisë sonë. Është veprim kundër përpjekjeve tona për liri. Është kundër dëshmorëve e martirëve tanë, është kundër familjeve të të pagjeturve, është kundër idealeve tona. Me fjalë të tjera, është kundër nesh si shqiptarë dhe si qenie politike.

Rehabilitimi dhe glorifikimi i figurës së një kriminelit të dënuar, është akti më antikombëtar, më i turpshëm dhe më i shëmtuar që i ka ndodhur popullit shqiptar të Kosovës. Andaj, tani më e pakta që do të duhej të ndodhte është që Kryeministri Kurti urgjentisht ta tërheqë këtij video turpi dhe t'i kërkoj falje publike gjithë kombit shqiptar për këtë fyerje dhe turpërim që na bëri.

Kërkoj po ashtu një distancim publik të Kryetarit të Kuvendit, Glauk Konjufca dhe Presidentes Vjosa Osmani. Në të kundërtën, turpi do t'ju ndjek kudo që të jeni nesër. Faleminderit!

KRYESUESJA: Tani në radhë është shefja e Grupit Parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje, Mimoza Kusari-Lila.

MIMOZA KUSARI-LILA: Faleminderit, kryesuese!

Të nderuar kolegë deputetë,

Të dashur qytetarë,

Të nderuar prezentë,

Është për çudi se si gjithë ky reagim dhe mllef dhe ky mobilizim kundër Kryeministrit të vendit, kundër Qeverisë së Republikës në përpjekjet për të ndalë, në përpjekjet për të rikthyer dhe rikuperuar gjithë dëmin që i është bërë Kosovës në procesin e negociatave. Më lejoni vetëm t'ju riformuloj disa prej konkluzioneve që u thanë nga kjo foltore. Nga kjo foltore u tha se për herë të parë janë ndalur zgjedhjet në Kosovë të mbahen në komunat serbe, apo janë shtyrë. Më lejoni t'ju rifreskoj se për herë të parë është ndalur referendumi i parë në Kosovë, se për herë të parë janë ndalur zgjedhjet serbe, të Republikës së Serbisë të mbahen në Kosovë, dhe se për herë të parë është pamundësuar që Lista serbe të ketë një fitore të pakontestueshme edhe në katër komunat në veri të vendit.

Për herë të parë ka pluralizëm politik mes komunitetit serb. Për herë të parë ka të tjerë që dalin kundër propagandës së Vuçiqit dhe forcës së Listës serbe ndaj serbëve të Republikës së Kosovës. Gjithashtu, ne bashkë si Qeveri dhe si Kuvend do të duhej të bënim përpjekje shumë më të mëdha, të japim një krah më të fortë në mënyrën se si e përfaqësojmë vendin në atë çka nga të gjithë po kërkohet një marrëveshje finale me Serbinë.

Po a po mendoni që ky Vuçiq me të cilën deklarohej ose thuhej më herët se nuk jemi njerëz problematikë, se kemi ardhur me marrëveshje, se në marrëveshje e në fotografi dilnim edhe me Vladimir Putinin, ka pasur mundësi të silllet një marrëveshje me njohje të Kosovës?! Ka pasur mundësit të silllet një marrëveshje e cila nënkupton copëtimin e Kosovë edhe dezintegrimin e veriut?

Po thoni se veriu nuk është normal. Po, se veriu nuk ka pasur normalitet kurrë kur udhëhiqet edhe kur bos i veriut është Milan Radojçiqi e Zvonko Veselenoviq. Kur Zvonko Veselenoviqi e Milan Radijçiqi janë pritur në zyre të Qeverisë, e në anën tjetër kanë persekutuar jo vetëm njerëzit e vet, por edhe krejt çka është e mundur në keqpërdorim e në krim e kriminalitet.

Kur kjo u pamundësuar atyre, gjithë ky reagim. Ku është reagimi për të thënë që ne nuk pranojmë të ulemi e të bisedojmë me kriminelë. Me këta këtu të cilët janë në listë të zezë të Thesarit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Nëse normalitet është të pranohet si përfaqësues legjitim të serbëve, po more, po nuk është normalitet. Ajo është anormaliteti më i gjati që ka zgjatuar prej përfundimit të luftës.

Sa i përket rastit të ambasadorit Berishaj, veç më lejoni t'ju rikujtoj; pozita nuk e ka parandaluar punën e komisionit, pozita e ka mundësuar. Pa pozitën nuk keni mundur asnjë mbledhje të vetme ta mbani se s'keni pasur kuorum...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESJA: Regjia, ia mundësoni ta përfundojë fjalën.

MIMOZA KUSARI-LILA: Ata të cilët kanë bërë konferenca për media duke thënë se ne po duam të parandalojmë. Ju inkurajoj publik, opinion, të gjithë që duan ta analizojnë, merreni e lexojeni transkriptin e intervistimit të ambasadorit Berishaj në komision hetimor. Dy përfaqësues vetëm i kemi pasur që t'ua mundësojmë kuorum juve që ta merrni në intervistë ambasadorin.

Dy përfaqësues të Grupit Parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje kanë qenë aty që ju të bëni pyetje. Ju keni bërë pyetje. Edhe çka dalë prej pyetjeve, zero. E tash çka, na akuzoni neve! Silleni raportin në Kuvend. Raporti vjen pa rekomandim të komisionit, por vjen në Kuvend.

As edhe një përpjekje më të vogël s'kemi bërë që as të ndalojmë atë raport, as ta ndalojmë intervistimin e ambasadorit Berishaj. Krejt i keni pasur përpara. Po krejt me të gjitha mundësitë ju nuk mund ta nxirrni argumentin tuaj, se argumenti juaj i vetëm është kundër Qeverisë Kurti, e jo për të vërtetën dhe për drejtësinë. Faleminderit!

KRYESUESJA: Dhe për fund është deputeti Hisen Berisha nga Partia Demokratike e Kosovës.

HISEN BERISHA: E nderuar kryesuese,

Qeveritarë,

Deputetë,

Shqetësimi që dua ta ngre sot ka të bëjë me rekrutimin në përgjithësi dhe me fokus në Forcë, ku ka një rënie drastike dhe shqetësuese të interesimit dhe motivimit për të aplikuar në Forcë.

Po t'i referohemi sajtit që ministrisë dhe shohim kur i kemi ngritur kapacitetet...Shuj Armend, se je duke më penguar! Kapaciteteve për mbështetjen ushtarake autoriteteve civile, ka qenë një interesim enorm, dhe po flas për vitin e fundit ku demobilizuar, e kemi pasur raportin 1 i zgjedhur me 10 aplikantë. Pra, për 300 vende të lira ka qenë mbi 6 mijë aplikantë, kurse për 12 kadetë na nevojiteshin edhe deri në dy muaj për testime eliminuese.

Ku qëndron arsyeja e kësaj rënie shqetësuese kur sot për 612 ende se kemi raportin 1 me 1 aplikantë të pranuar, e të mos flasim për komponentin rezervë që as që nuk duhet të përmenden. Pse ka ndodhur ky demotivim? Cilat janë shkaqet? Unë mendoj se e para janë kushtet e shërbimit dhe duhet të fokusohemi edhe në sensibilizimin jo të duhur dhe motivimin e pamjaftueshëm për të aplikuar në Forcë. Pagat e ulëta janë një ndër to e që janë më të ulëtat në rajon, e që do të duhej që tani me këtë Ligj të ri të pagave të rriten për 50%, ndërkohë që është dashur të zbatohet Rregullorja 022020. Pastaj rrezikshmëria e lartë që paguhet pjesërisht për deminerët që janë në operacione e që do të duhej të përbëjë 30% të pagës bazë për t'i mbajtur në Forcë.

Sigurimet shëndetësore duhet të aplikohen për të gjithë ata që shërbejnë në Forcë dhe në uniformë. Pastaj çështja e stimulimit mbi pagë e eksperteve të fushave siç janë: IT, Cyber defense apo edhe të mjekësisë, që s'e ka asnjë mjek Forca.

Pastaj janë pagat jubilarë, mbulimi i çështjeve të transportit në qind për qind, e ndërkohë derisa të bëhet kjo është dashur t'u kompensohen biletat apo karburantet e përdorimit. Dhe një temë që e keni hapur tani dhe është shqetësuese, është prishja e vendimit që e kemi marrë në Kuvend me ndryshimet në Ligjin për Ministrinë për Mbrojtjes për ekuivalencën e pagës së stafit civil që shërben në Ministrinë e Mbrojtjes dhe në Forcë, duke eliminuar pikat 4 dhe 5 të nenit 14 me Ligjin për pagat në sektorin publik.

Një çështje tjetër shqetësuese në këtë proces, është edhe loja me standardet apo kriteret e rekrutimit dhe shërbimit në Forcë. Pra, është lëvizur me moshën. Moshë 18-22 standard i studiuar edhe në aspektin anatomik edhe fiziologjik edhe psikik, tani është ndryshuar në 18-25, në fakt i bie 26, dhe ajo moshë ka qenë e përzgjedhur, sepse është moshë që e përballon stërvitjen dhe edukimin në sforcim fizik dhe psikik...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESJA: I nderuar më vjen keq, kam vendosur që edhe pse është jashtë Rregullores që të krijoj balancë, t'ia jap fjalën për fund edhe përfaqësuesit të LDK-së, dhe po e përfundojmë deklarin. Ju lutem, sinqerisht është duke u tepruar! Të mos më shti të jem strik me kohë dhe asnjë sekondë asnjëri të mos e keni shtesë. Sinqerisht.

Nuk është duke u treguar limit në këtë. Unë jam shumë duke u përpjekur që të tregohem e mirëkuptueshme me të gjithë, po flas për të gjitha grupet parlamentare, por duhet edhe ju ta dini se kur është kufiri. Ju lutem! Aremnd Zemaj e ka fjalën. Ju lutem, tash e tutje rrini brenda kohës! Po e di, po tani diskriminim po i bëhet edhe Armendit, që ka të drejtë. Zhurmën unë nuk po e bëj, i nderuar në fund, po vjen prej deputetëve.

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit, kryesuese e Kuvendit!

Kolegë deputetë,

Më 21 janar 2016 Lëvizja Vetëvendosje në komunikatën e saj, po e lexoj një paragraf dhe po e citoj çka thotë: "Oliver Inavoviq dhe bashkëpunëtorët e tij gjatë dhe pas përfundimit zyrtar të luftës në Kosovë janë angazhuar për realizimin e plani hegjemon të shtetit të Serbisë, kolonizimin e Kosovës dhe spastrimin etnik të saj", e mbyll citatin.

Kush jeni ju? Kush jeni ju sot në vitin 2023? Cilët jeni? Albin Kurti, çka ju desh në vitin 2023 që një dënuar për këtë krim ta bëjë serb dhe qytetar të mirë? Tregojeni hallin të cilin e keni. Nëse mendoni se Vuçiqi dhe Serbia luftohet me Ivanoviqin e vdekur, atëherë e keni gabim. Po cili është dallimi mes atyre që kanë vrarë në Reçak, Izbicë, Mejë, Lybeniq, Krushë, Prekaz, e shumë e shumë vende të tjera, e i këtyre që kanë vrarë në Mitrovicë, sidomos në natën mes datës 3 dhe 4 shkurt, ku protagonistin kryesor është Oliver Ivanoviq, i identifikuar, i gjykuar nga gjykatat vendore dhe ndërkombëtare.

Çka ka ndodhur me juve? Kush jeni ju nga fillimi dhe deri më sot? Ju tregoni qytetarëve të Republikës së Kosovës që e mbroni një njëri i cili ka vrarë 10 shqiptarë. Shkoni dhe tregojuni familjes kush e vrau dhe pse e mbroni vrasësin e Shqipe Vocës, Bashkim Rrukecit, Nderim Ajetit, Niman Sejdiut, Muharrem Sokolit, Selime Berishës, Nexhmije Gjakës, Nezir Vocës, Sebahate Abrashit dhe Remzijas, të cilët edhe kishin moshë nga 3 deri në 63 vjeç. Ky është turpi më i madh që mund ta bëni si përfaqësues politik dhe mbrojtës së të këtij fjalori të kryeministrit të Kosovës, fatkeqësisht sot. Dhe, kësaj ideologjie famëkeqe, të ndyrë, e cila duket që përsëritet nga historia e atyre të cilët janë angazhuar për liri, pavarësi të këtij vendi e deri më sot në metoda dhe në rrethana të ndryshme.

Kjo urrejtje ky ndryshim, kjo urrejtje patologjike ndaj atyre që mendojnë ndryshe dhe ndaj atyre të cilët kanë pasur edhe vlerësime edhe gjykime ndryshe, me të vërtetë është skandaloze atë që e shohim dhe po e provojmë në Kuvendin e Kosovës, në institucionet tona, mbi të gjitha qytetarët. Por, mbi të gjitha ju mallkojnë ata të cilët u kanë besuar që ju e keni sinqerisht në gjuhën që e keni...

(Ndërprerje nga regjia)

(Drejtimin e mbledhjes e merr kryetari i Kuvendit, z. Glauk Konjufca.)

KRYETARI: Ka përfunduar kjo pjesë e deklarimeve. Tash kalojmë te pyetjet parlamentare.

3. Pyetjet parlamentare

Valentina Bunjaku-Rexhepi pyetjen ia drejton ministrit Çeku. Nuk ka qenka këtu ministri me sa po e shoh. Deputete e nderuar, a dëshironi ta bëni pyetjen?

VALENTINA BUNJAKU-REXHEPI: Faleminderit, kryetar! Kërkoj nga ministri, meqë kjo pyetje është duke u bartur në shumë seanca, përgjigjen nëse ka mundësi të ma dorëzojë me shkrim. Pyetje ime ka qenë për stadiumin e qytetit të Gjilanit kur do të përfundojë dhe palestrën në Zhegër. Kështu që, kërkoj nga ministri që të më përgjigjet me shkrim.

KRYETARI: Deputetja Floretë Zejnullahu pyetjen e ka pasur për tjetrën seancë a po? Për ministrin Sveçla. Po ashtu për të njëjtin ministër, Mërgimi. Nuk qenka këtu me sa po e shoh. Kurse deputetja Ganimete Musliu po ashtu nuk është këtu. Deputetja Albana Bytyqi pyetjen e ka për kryeministrin, por kryeministri është Zvicër me sa e dimë, po ashtu deputetja nuk qenka këtu. Dhe, Blerta Deliu-Kodra pyetje për kryeministrin Kurti. Nuk është këtu kryeministri. Zonja Deliu-Kodra, urdhëroni!

BLERTA DELIU-KODRA: Zoti Konjufca kisha një pyetje edhe për ty në fakt, por nuk ishit në sallë, sepse parashtrova një pyetje për të parë qëndrimin tuaj lidhur me deklarinimet dhe himnizimin që kryeministri i bëri figurës së Oliver Inavoviqit.

Me shumë dëshirë kisha dashur t'ju dëgjoj se a mbështesni ju një deklaratë të tillë skandaloze që i ka fyer viktimat? Pyetja ime ishte kjo në deklarinimet jashtë rendit të ditës, por po e marrë të drejtën që të kërkoj një përgjigje nga ju, sepse unë jam e bindur dhe besoj thellë që ju nuk e ndani të njëjtin qëndrim.

KRYETARI: Pyetjet i bëhen vetëm Qeverisë, por mendimi dhe i kryeministrit për zotin Ivanoviq është i njëjti mendoj unë, ai që ka qenë gjithmonë. Asgjë nuk mund ta ndryshojë biografinë politike që e ka pasur zoti Ivanoviq. Përgjegjësia e tij në të gjitha ato dëme që i janë shkaktuar popullit tonë është evidente dhe për këtë edhe është dënuar ai.

Ne kemi thënë hapur, e kemi quajtur me emrin që i përket një njeriu, i cili bën veprime të tilla dhe ai është dënuar me kualifikuar me kategorinë e kriminelit, kështu që ky është edhe mendimi ynë. Po, po kriminel pa kurrfarë dyshimi.

Asgjë nuk mund t'i heq kësaj që e ka vendosur edhe gjyqësia e Kosovës me sa e di unë. Ne e kemi thënë shumë më përpara se sa ta vendoste gjyqësia këtë çështje. S'po e kuptoj pse e humbim kohën me këtë. Urdhëro, zoti Gashi!

ARBEN GASHI: Faleminderit, kryetar! Unë pajtohem me deklarinimin tuaj, por problemi është se në videon të cilën e ka publikuar kryeministri i vendit, thotë, po e citoj: "Oliver Ivanoviq luftoi për qytetin e tij". Dhe, lufta e Oliver Ivanoviqit për qytetin e tij është masakër ndaj shqiptarëve. A po e kupton?! "Oliver Ivanoviq-thotë kryeministri në videon e tij-luftoi për qytetin e tij", dhe tash e po e mbyll citatin, pasojat e luftës së Oliver Ivanoviq për qytetin të ashtuquajtur të tij, është masakër ndaj 32 shqiptarëve, ai përfshirë direkt, i dënuar me vendim gjykate 9 vjet. Ky është problemi që e kemi. Kryeministri nuk guxon të bëjë asi deklarate.

KRYETARI: Ai ka qenë udhëheqë i Rojave të urës dhe Rojat e urës kanë qenë një strukturë kriminale pa kurrfarë dyshimi.

ARBEN GASHI: Me konkluzionet e tua pajtohem plotësisht. Shqetësimin e kemi te deklarata e kryeministrit, nga Zyra e Kryeministrit të Republikës së Kosovës.

KRYETARI: Kryeministri vetëm, ky është mendimi im, ka dashur të thotë që ai njeri është vrarë prej Aleksandër Vuçiqit, dhe kjo duhet të hetohet, po ashtu prej anës së drejtësisë sonë, bile edhe prej drejtësisë ndërkombëtare. Ky është, ma merr mendja, mesazhi që ka dashur ta përçojë dhe këtë e ka përçuar.

ARBEN GASHI: Mesazhi i drejtpërdrejt i kryeministrit është e kundërta e kësaj që po e thoni ju, “luftoi për qytetin e tije”, pasojat, 32 civilë shqiptarë të vrarë. Faleminderit!

KRYETARI: Unë mendoj që sa i përket përgjegjësisë që e ka pasur zoti Ivanoviq, zoti kryeministër nuk ka ndryshuar kurrfarë mendimi dhe kurrfarë qëndrimi. Asnjë prej krimeve që ai i ka bërë nuk i hiqet prej biografisë së tij.

4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 08/L-178 për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 04/L-101 për fondet pensionale të Kosovës, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin nr. 04/L-115, me Ligjin nr. 04/L-168 dhe Ligjin nr. 05/L-116

Të nderuar deputetë,

Komisioni Funkcional për Buxhet Kuvendit ia ka rekomanduar që këtë ligj të mos e votojë, të mos e miratojë në parim. Zoti Haxhiu, a jeni këtu? Ju jeni propozues i kësaj nisme legislative, kështu që u takon juve që ta mbronni dhe ta paraqisni para Kuvendit atë. Pra, juve ju kanë autorizuar që ta paraqisni para Kuvendit.

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, kryetar!

Sot, prezantimi e kësaj nisme legislative e bëj me autorizimin e Grupit të qytetarëve pro 30% të Trustit, të cilët brenda 8 ditëve mblodhën 21 mijë e 398 nënshkrime, kopje e të cilëve janë këtu.

Qytetarët të zhgënjyer me votën e Kuvendit kundër Trustit, u vetorganizuan për ta rikthyer kërkesën për Trustin sërish në Kuvend, dhe tani kjo iniciativë e qytetarëve, kjo kërkesë e tyre është në Kuvend. Është në dorën tuaj të nderuar kolegë deputetë të dëshmoni a jeni vërtet përfaqësues të qytetarëve apo përfaqësoni vetëm bindje politike, por jo realitetin me të cilin popërballen qytetarët.

Ju sot dhe çdonjëri prej nesh, para se ta ngre dorën pro apo kundër këtij projektligji, duhet të kthehet prapa dhe të shohë pse qytetarët po kërkojnë mbështetjen e deputetëve të zgjedhurve të tyre për Trustin.

Jua rikujtoj se buka ishte 30 centë, sot është shtrenjtuar në 60 centë, 100 për qind më shtrenjtë. Vezët ishin 2,4 - 2,5 euro, sot vezët janë 5,15 centë, vaji që dikur ishte rreth 1 euro, shkoi e u shtrenjtuar deri në 3,4 euro, sot janë në treg 2,2 - 2,4 euro, 110 - 120% më shtrenjtë. Pra, është shtrenjtim enorm i çmimeve të produkteve elementare të konsumit ditor, me çka shporta e qytetarit është shtrenjtuar shumë e jeta e qytetarëve është vështirësuar edhe më shumë.

Pa krahasuar këtu shtrenjtimin e energjisë, drutë e peletin, këto rritje të çmimeve e kanë rënduar shumë jetën e qytetarëve dhe çdo familje në Republikën e Kosovës dhe ata u detyruan të hyjnë në borxhe për shkak se të zgjedhurit e tyre herën e parë e refuzuan iniciativën për Trustin. Nga

4,2 miliardë euro kredi në Republikën e Kosovës, vetëm në vitin 2022 gjithsej 1,5 miliardë euro janë kredi të reja, pra qytetarët u detyruan të futen në borxhe për të marrë kredi për të blerë dru dhe për të përballuar koston e jetesës. Derisa bankat e Kosovës shënuan rekord në përfitimet e tyre, në vitin 2022 profiti i bankave të Kosovës ishte 190 milionë euro, ndërsa humbjet e Trustit ishin 120 milionë euro dhe, për më keq, Trusti këto investime në tregje ndërkombëtare i kishte me kamata të ulëta, ndarja në emër të sigurisë së investimeve po rezultoi që ishin në humbje këto investime dhe Trusti tërhoqi edhe 500 milionë euro të tjera nga investimet në tregje ndërkombëtare dhe po i mban në llogari, e vlera e të cilave po humb çdo ditë për shkak të inflacionit.

Prandaj, kërkesa e qytetarëve është që të mbështetet iniciativa e tyre për Projektligjin për Trustin që t'u mundësohet tërheqja e këtyre mjeteve dhe që ata të përballojnë këtë krizë ekonomike, e cila vjen si pasoj e rritjes së madhe të çmimeve dhe vjen si pasoj e inflacionit të madh.

Prandaj, të nderuar kolegë deputetë,

Nëse në këtë foltore në të kaluarën për çështje të caktuara kryeministri Kurti, si opozitar atëherë, deklaronte se populli duhet të pyetet për çdo çështje, populli ka folur, ka nënshkruar dhe e ka sjellë projektligjin në Kuvend, tani është në dorën tuaj të dëgjoni kërkesën e popullit apo të dëgjoni këshillime politike e qëndrime politike të qeverisë.

Unë ju ftoj që vërtet ta dëshmoni veten si përfaqësueses të qytetarëve, për shkak se ata më kanë autorizuar sot që të përfaqësoj kërkesën e tyre dhe kërkoj unitet të plotë, nuk do merrem me çështje aspak politike, kërkoj votën tuaj në emër të atyre qytetarëve që ju ta dëshmoni se jeni përfaqësues të qytetarëve, e jo përfaqësues të shefes apo të shefit. Me votën tuaj do të përcaktoheni a do t' i dëgjoni këta qytetarë, a Mimoza Kusarin e Albin Kurtin. Do të vendosni për qytetarin, kërkesën e tyre, apo për presionin politik e qëndrimeve politike të shefes edhe të shefit. Bëjuni deputetë të popullit, dëshmoni se jeni të popullit, sepse në zgjedhjet e ardhshme ju votojnë qytetarët e s'ju votojnë shefat. Faleminderit!

KRYETARI: Ky është prezantimi i këtij projektligji nga ana e deputetit Haxhiu, i cili është autorizuar që ta paraqesë atë.

Tash ia japim fjalën kryetarit të Komisionit për Buxhet, deputetit Armend Muja. Zoti Muja na e prezanton raportin e komisionit dhe vendimet që janë marrë aty.

ARMEND MUJA: I nderuar kryetar i Kuvendit,

Të nderuar deputetë,

Kabinet qeveritar,

Qytetarë të vendit,

Komisioni për Buxhet, Punë dhe Transfere e ka shqyrtuar Projektligjin numër 08/L-143 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për fondet pensionale të Kosovës dhe të njëjtin nuk e ka rekomanduar për këto arsye.

Propozimi nënkupton tërheqjen e kursimeve pensionale, kursimi për pëlqenin në bazë të legjislacionit nuk është opsional, po është detyrim ligjor për secilin punëtor të Kosovës.

Fondi Pensional i Kosovës përgjithësisht është i organizuar në dy shtylla, në shtyllën zero, ku shteti ndihmon ata pensionistë që jetojnë në varfëri dhe shtylla një që është kursim i detyrueshëm për secilin punëtor të Kosovës. Ky është propozimi i dytë me radhë brenda një periudhe shumë të shkurtër dhe kjo vjen pas lejimit të tërheqjes së 10% në vitin 2020.

Në kohën kur po diskutoj tërheqja e parë prej 10% të kursimeve në vitin 2020, ishte justifikuar për këto arsye.

Fillimisht është se kjo bëhet vetëm një here, se tërheqja është menduar si formë e rikthimit të kërkesës agregate dhe se 100 mijë vende të punës ishin afektuar nga pandemia.

Tash në vitin 2022 kemi dy propozime radhazi. Fillimisht në propozim, është detyrim i Rregullores së Kuvendit që propozime të tilla duhet ta kenë një deklaratë të ndikimit buxhetor.

Deputetë të nderuar,

Ne kur e kemi marrë këtë propozim, nuk ka asnjë specifikë, asnjë deklaratë se çka nënkupton ky ligj.

E dyta, ekziston një justifikim dy faqe. Në ato dy faqe thuhet që ky projektligj synon që të luftohet inflacioni dhe rritja e çmimeve ndoshta mos e ditur që është e njëjta gjë, inflacioni dhe rritja e çmimeve janë e njëjta gjë.

Për shkak të gabimeve drejtshkrimore në këtë justifikim është e vështirë dhe të kuptohet thelbi i argumentit, megjithatë ripropozimi nuk ndihmon asgjë.

Ky Kuvend e ka dhënë verdiktin gjatë vitit 2022 dhe nuk ka justifikime shtesë përpos asaj që e kemi trajtuar vitin e kaluar.

Të nderuar deputetë

Në mungesë të detajeve sa i përket ndikimit buxhetor, unë kam ftuar Bankën Qendrore të Kosovës, Bordin e Trustit Pensional që të na ofrojnë detaje se çka nënkupton ky ligj.

BQK-ja ka argumentuar që ky propozim ligj nuk ndihmon në luftim të inflacionit, përkundrazi, guvernatori Mehmeti thotë që e përkeqëson inflacionin në vend.

E dyta, Fondi Monetar Ndërkombëtar dhe Banka Botërore, përfshirë edhe Bashkimin Evropian në raportin vjetor janë kundër, me argumentimin që e pengojnë ose e cungojnë seriozisht zhvillimin e tregjeve kapitali dhe mundësinë e Qeverisë për të financuar investime kapitale në vazhdim.

Në të dy rastet kur bëhen propozime të tilla, zakonisht ato paraprihen me një fushatë, e cila tenton të krijojë një gjendje të rënduar ekonomike, po e cila nuk mbështet në të dhëna.

Natyrisht Kosova i ka sfidat e veta ekonomike, ne ende kemi popullatë mjerisht që nuk punon dhe jeton në varfëri. Megjithatë, dy vjetët e fundit kanë qenë vitet më të mira të ekonomisë së Kosovës, konsumi i ekonomive familjare...

Të nderuar deputetë,

Konsumi i ekonomive familjare gjatë vitit 2022 është rritur për 11% në terma real, jo në terma nominal, krahasuar me vitin 2021, kurse në vitin 2021 ishte rritur për 20% krahasuar me vitin paraprak. Pra, nuk kemi një krizë të konsumit, siç propozohet.

E dyta, ekonomitë familjare në bazë të regjistrave të Bankës Qendrore kanë depozita 3.4 miliardë euro, këto depozita janë më të larta në histori, nuk kemi indikacione të menjëhershëm që kemi krizë likuiditeti. Ka ekonomi familjare që jetojnë në varfëri, po megjithatë të dhënat na japin një pamje tjetër.

Ekonomia e vendit në vitin 2021 është rritur për 10.7% në terma real, mund të përfundojmë që në vitin 2022 të ketë një rritje prej 4.5%, projeksionet për vitin e ardhshëm po ashtu janë një rritje ekonomike 4.5%, prapë më e larta në rajon.

Eksporti i mallrave është trefishuar krahasuar me vitin 2019, kurse eksporti i shërbimeve është dyfishuar krahasuar me vitin 2020.

Tregu i punës në Kosovë vazhdon të jetë i varfër dhe nuk prodhon vende të mjaftueshme të punës, por mund të përfundojmë që në vitin 2022 të kemi rreth 400 mijë vende të punës që janë diku rreth 130 mijë më shumë se sa 267 mijë të afektuar nga pandemia, kur u bë propozimi për tërheqjen e 10% nga Trusti pensional.

Prepotentët e tërheqjes e justifikojnë tërheqjen si zëvendësim të politikës fiskale me arsyetimin që Qeveria s'ka bërë asgjë.

Të nderuar deputetë,

Kur është analizuar projektligji dhe ndikimi buxhetor në konsultim me Trustin pensional, kemi marrë këto të dhëna.

Projektligji nënkupton tërheqjen e 594 milionë euro nga kursimet pensionale.

Ky propozim është i ndërtuar kryesisht në tri kategori. Fillimisht për fituesit më të mëdhenj, rreth 4 mijë euro mesatarisht, tërhiqen nga 66 850 kontribues, apo 5% e fuqisë punëtore. Pra, gjysma e kësaj shume të propozuar do të tërhiqej nga 5% e fuqisë punëtore. Gjysma tjetër, mesatarisht rreth 160 euro, u shpërndahen kategorive të tjera. Kurse në kategorinë e tretë, afro 600 mijë qytetarë të Kosovës të aftë për punë nuk përfitojnë asgjë.

Si konkludim, 95% e njerëzve të aftë për punë nuk tërheqin asgjë dhe kjo politikë nuk i ndihmon ata. Ky propozim është i dizajnuar për t'i ndihmuar 5% e shtresës së mesme të lartë dhe të lartë në Kosovë, pra nuk e mbërrin efektin e luftimit të inflacionit. Në fakt, kjo kategori afektohet më së paku nga inflacioni.

Asistenca edhe masat e Qeverisë së Kosovës gjatë vitit 2022 kanë qenë më gjithëpërfshirëse dhe kryesisht të dizajnuara për këtë 90% që nuk fiton asgjë nga tërheqjet e kurimeve pensionale.

Asistenca e përgjithshme e Qeverisë së Kosovës shkon me rreth 5% të GDP-së dhe në bazë të Bankës Botërore dhe Fondit Monetar Ndërkombëtar, është ndër më të lartat në rajon.

Gjatë vitit të kaluar Qeveria ka shpenzuar mbi 2.6 miliardë euro, 2022 është viti kur Qeveria ka bërë shpenzime rekord në Kosovë.

Programet e shpenzimit kanë qenë ato tipike që i rekomandojnë institucionet ndërkombëtare për ta luftuar inflacionin. Po i renditi:

Rritje të shpenzimeve për skemat sociale të shtresave të varfra, rritje të shpenzimeve për pensione, rritje të shpenzimeve për nëntat dhe lehonat, rritje të shpenzimeve për bujqit, ndihmë për studentët, shtesa për fëmijë, ndihmë të njëhershme për punëtorët e sektorit privat, shtesat në rrogat e sektorit publik, shtesat për garantim të punësimit të rinjve dhe të grave dhe Ligji për paga në sektorin publik. Do t'ia shtoj kësaj që në asistencë dhe programe ka pasur edhe në formë të subvencionimit të energjisë dhe asistencë për bujqit e Kosovës.

Aspekte të rëndësishme, po shpeshherë mungojnë në debatin publik, është fakti se çka nënkupton tërheqja e 594 milionë euro sot, për kursimet dhe kthimet në investim në 20 vjetët e ardhshme.

594 milionë euro sot me normën e kthimit mesatar nënkuptojnë rreth 2 miliardë euro pas 20 vjetëve. Në mesatarisht, qytetarë të nderuar, kemi pak kursime pensionale, secili prej nesh i kemi rreth 3 mijë euro, kjo nënkupton një tërheqje prej 250 euro për dy vjet, është i varfër si fond dhe ky nuk mund të preket.

Si konkluzion, të nderuar qytetarë,

Ky propozim është i dizajnuar në atë mënyrë që t'i mundësojë shtresës së lartë dhe shtresës së mesme të lartë disa shpenzime shtesë. Ky propozim nuk e lufton inflacionin, përkundrazi shtresa e mesme e lartë dhe shtresa e lartë rrezikon t'ia bartë inflacionin në import shtresës së varfër, e rëndon gjendjen e familjeve të varfra.

Debati ynë duhet të zhvendoset në atë...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Urdhëroni, zoti Muja, nëse mund ta përmbyllni diskutimin.

ARMEND MUJA: Po e përfundoj.

Në debatin duhet ta zhvendosim se çka ne duhet të bëjmë për 700 mijë qytetarë të Kosovës që s'punojnë asgjë, për 300 mijë punëtorë të sektorit privat që paguhen keq dhe natyrisht për 140 mijë pensionistë që jetojnë keq, për shkak se kursimet e tyre janë vjedh nga Serbia. Nuk rekomandojmë kështu tërheqje.

Dhe në emër të Grupit Parlamentar, i nderuar kryetar, nuk kemi argument shtesë tjetër përpos të rekomandojmë deputetët e këtij Kuvendi që të njëjtit të mos e miratojnë.

KRYETARI: Edhe Qeveria e ka fjalën e saj, nëse do, nëse nuk dëshiron, atëherë mund të kalojmë në grupet parlamentare. Për procedurë.

Zoti Hoti, e ke fjalën, urdhëro për procedurë!

AVDULLAH HOTI: Faleminderit, kryetar!

Vlerësimi që u prezantua nga deputeti Muja, ai me sa mora vesh, ka folur në emër të komisionit, ato që i tha ose do të duhej t'i fliste në emër të komisionit, ato që i tha në foltore nuk janë qëndrime të komisionit, janë qëndrime të tij personale, të gabuara komplet, po ka të drejtë t'i prezantojë qëndrimet e veta. Nuk mund të flasë kështu në emër të komisionit, s'mund të përdorë asnjë argument as të guvernatorit, as të Fondit Monetar për të prezantuar qëndrimin e komisionit. Ka pasur një proces të votimit, ai është i autorizuar sipas rregullores të prezantojë vetëm ato që i ka vendosur komisioni, kur flet në emër të tij ose në emër të grupit të tij parlamentar, ajo është

çështje tjetër. Unë mendoj që ky duhet të tërhiqet nga ai fjalim dhe ta respektojë Rregulloren e Kuvendit.

KRYETARI: Vazhdojmë me grupet parlamentare. Kush flet në emër të Vetëvendosjes?

A domethënë, pas paraqitjes së qëndrimit të komisionit, e vazhdove drejtpërdrejt. E po, mirë.

Jo, jo, nëse më ka kërkuar leje dhe s'e kam dëgjuar, në rregull është. Jo zoti Muja i ka ndarë këto, paraqitjen e vendimit të komisionit dhe pastaj fjalimin e tij.

Urdhëro, zoti Muja!

ARMEND MUJA: I nderuar kryetar!

Unë fillimisht e paraqita faktin që Komisioni për Buxhet nuk e ka votuar, po pastaj ndoshta për shkak të zhurmës nuk u dëgjua, po thashë po flas në emër të grupit parlamentar.

KRYETARI: Po, kështu ka mundur të jetë.

Diskutimet sidomos ajo që e mori kohën kryesore i zotit Muja kishte të bënte me qëndrimin parlamentar të Vetëvendosjes. Tash kalojmë te PDK-ja, kush e shpreh qëndrimin e grupit? Deputeti Ferat Shala.

FERAT SHALA: I nderuar kryetar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Në emër të Grupit të Partisë Demokratike shprehim mbështetjen e fuqishme për këtë nismë legjislative, e cila parimisht ka arsytet e veta.

Arsyeja të cilën e mbështesim ne është, sepse është nismë qytetare, për herë të parë na jepet shans edhe morali edhe legjislativi që të mbështesim një nismë qytetare.

Nën dy, është nismë dhe kërkesë, e cila mbështetet fuqishëm nga gjendja ekonomike sociale dhe ekonomike të cilën kjo Qeveri e ka sjellë vendin.

Arsye e kësaj kërkesë është gjendja pas pandemisë, kriza energjetike në vend, inflacioni i lartë i imponuar nga kjo Qeveri dhe me mospolitika të saj, vonesa e Ligjit të pagave dhe loja me Ligjin e pagës minimale, po ashtu nga institucionet e shtetit dhe mazhoranca parlamentare.

Politikat joadekuate zhvillimore tash e dy vjet kanë arritur gjendjen ekonomike të vendit ta sjellin para situatës kur qytetarët e vetëdijshëm në shkallën më të lartë si asnjëherë tjetër po i shfrytëzojnë mjetet e kursyera, të cilat parimisht edhe ata i kanë deponuar për misionin dhe

qëllimin e tyre fisnik, për moshën e pleqërisë, e që kjo Qeveri po i obligon pa dashjen e tyre t'i shpenzojnë para kohe dhe në rrethana krejtësisht joadekuate.

Nëse e marrim arsyeshmërinë e Qeverisë mbi të cilën po mbështetet, duke u munduar të aludojë dhe të arsyetojë refuzimin e këtij draftligji, po i përmendim që mjetet janë duke u menaxhuar shkajshmërisht jo mirë nga Trusti, sepse po menaxhohen ato mjete në institucione krejtësisht ndërkombëtare, mbi 90% në mekanizma financiare ndërkombëtare, në situatë të krizave më të mëdha globale në dy dekadat e fundit në kuptimin ekonomik dhe të sigurisë.

Nuk kemi parë asnjë politikë qeverisëse që në bashkëpunim me Trustin dhe me BQK-në që këto fonde të arrijnë një shkallë të lartë të sigurisë, duke llogaritur që janë miliarda euro mjete tona, e që Qeveria përveç që insiston që ato të mbeten në tregjet ndërkombëtare, asnjë alternativë ligjore apo ekonomike nuk ka sjellë.

Sot këto mjete të deponuara në mekanizma ndërkombëtarë po rrezikohen në shkallë të lartë dhe humbjet janë mbi 120 milionë, siç tha parafolësi im nga Partia Demokratike.

Po i ekspozohen edhe mekanizmave të tjerë, sepse siç u tha në mbledhjen e komisionit, mbi 500 milionë euro mjete të Trustit janë në institucione mikro-financiare, apo unë i quaj dhe janë në mjete kesh. 500 milionë euro janë duke u mbajtur në mekanizma mikro-financiare kesh, mjete të Trustit, të cilat parimisht po ekspozohen një shkallë të lartë prej 13 deri në 15% të inflacionit.

Vetëm nëse shkallën e inflacionit dhe humbje që ka pas Trusti gjatë këtyre dy vjetëve nga mjetet e mbajtura kesh e arsyetojnë çdo kërkesë qytetarët që mjetet e tyre të mos i ekspozohen rrezikut dhe humbjeve, por t'u kthehen atyre të cilat edhe realisht janë.

Humbjet në tregjet ndërkombëtare po ashtu janë sfida e veçantë dhe përsëri si Grup Parlamentar mendojmë nëse institucionet e shtetit nuk kanë aftësi menaxhuese që të sigurojnë normalitet dhe menaxhim të mirë, më mirë është që mjetet t'u kthehen atyre të cilët kanë nevojë, sepse sigurisht ata që nuk kanë nevojë, edhe nuk do t'i tërheqin, do të jetë qëndrim i tyre moral dhe legjislativ për mjetet e tyre t'i lënë në ekspozitura ndërkombëtare, apo t'i kthejnë në xhepin e ekonomisë familjare.

Nëse i kthehemi pjesës së Qeverisë, mbi 700 milionë euro suficit të Qeverisë, mosrealizim të projekteve kapitale, e kanë rënduar tej mase dhe nuk ka arsyeshmëri tjetër, përveç të cilat ne duhet t'i mbështesim nisma qytetare, sepse kjo Qeveri nuk po arrin dhe nuk po di të menaxhojë buxhetin, të cilën e ka në dispozicion në mënyrë legale dhe ligjore.

Mortaliteti i rrejshëm i institucioneve qeveritare sepse këto mjete e rrisin inflacionin nuk qëndron, po e përmend vetëm një fakt. U tha dhe është e vërtetë që Qeveria ka shpenzuar mbi 2,6

miliardë euro mjete. Ku i shpenzoi qeveria 2,6 miliardë euro mjete, kur nuk ka investuar asnjë milion në investime kapitale. Pra, nëse Qeveria ka ndarë mjete kesh, ka subvencionuar de fakto edhe de jure bankat, duke marrë përfitime të jashtëzakonshme, si asnjëherë tjetër, ka ndarë rreth dy miliardë euro mjete e subvencione të kategorive të ndryshme të merituar, por kanë ndikuar direkt në ngritjen e inflacionit dhe në destabilizimin e normalitetit të tregut me paratë kesh, që ka lëshuar po kjo Qeveri.

Atëherë, çka ndryshon në kuptimin konceptual ekonomik, nëse edhe qytetarët, një pjesë e tyre që nuk kanë mundur të përfitojnë nga subvencionet e Qeverisë, të fitojnë mjetet e veta. Pra, demant klasik, joreal dhe joekonomik është që këto mjete rrisin çështjen e shkallës së inflacionit.

Shikoni, më shumë se tri herë më shumë sesa mjetet në total që mund t'i tërheqin qytetarët, Qeveria ka lëshuar para kesh në këtë mandat. Prandaj, Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike, duke parë shumë të arsyeshëm dhe duke parë edhe çështjen e qasjes së Qeverisë, po e përmend vetëm një shembull. Po kjo Qeveri me marrëveshje të porealizuara ndërkombëtare dhe vendore, me neglizhencën e saj, vetëm gjatë vitit 2022 ka arritur të ndajë njëqind milionë euro jashtëligjshëm dhe jashtë çdo parimi për pjesën veri. Dhe sot, nuk ka mjete t'i ndajë ato të hyra, të cilat janë të qytetarëve. Pra, si ka logjikë që t'i ndajë njëqind milionë euro për një vit në pjesën veri, edhe pe ka marrëveshje, edhe pse ka ligj, edhe pse vetë e kanë nënshkruar marrëveshjen, edhe pse vetë e kanë shkëlur udhërrëfyesin, sot mjetet e qytetarëve ua ndalon të drejtën e tyre që t'i tërheqin, e në anën tjetër, njëqind milionë i ka dërguar në pjesën veri dhe vazhdon t'i dërgojë këtë vit me siguri, me këtë trend, edhe njëqind milionë euro të tjera.

Pra, amoralitet politik, ekonomik dhe social, dhe është pasinqeritet i Qeverisë. Janë mjetet e tyre. Në kushte normale dhe rrethana, edhe ne do të kishim qëndrim tjetër, por në rrethanat ekonomike, sociale dhe politike, me vonesa të ligjeve që realisht rregullojnë tregun ekonomik dhe ekonomisë familjare, ne nuk mund të jemi të tjerë, përveçse të mbështesim këtë nismë dhe kërkojmë nga të gjithë deputetët që ta votojnë këtë nismë legjislative, sepse nuk e dëmton buxhetin e shtetit, nuk e rregullon, as nuk e destabilizon ekonominë e vendit. Nuk krijon asnjë precedent social, sepse ata që kanë, nuk i tërheqin, i tërheq kategoria që ka nevojë. Nuk mund të jemi ne mbi, as në kuptimin social e njerëzor, më human se sa ai vetë për familjen.

Ju po thoni sot: “Qëndroni, bëni çfarë të doni, vdisni, hyni në borxhe, hyni në kredi... Unë mendoj për ju në pleqëri.” Mendo sot për ta, se sot jenë pushtet, nesër s’do të jesh ti, nesër e zgjidh ai vetë problemin, me votën e vet, me punën e vet, me angazhimin e vet. Ju sot po i sanksiononi. Ju sot po i dënoni ata, ju sot po i lëndoni të gjitha ekonomitë familjare në emër të asaj demagogjie populliste që keni ardhur këtu: “Unë po mendoj për ju pas nja dy dekada a tri dekada...”

Krijojani mundësinë, ai vendos vetë për fatin e vet dhe nuk gabon më, siç ka gabuar kur ju ka votuar juve. Faleminderit!

KRYETARI: Kush e jep qëndrimin e Lidhjes Demokratike për këtë çështje? Deputeti Avdullah Hoti.

AVDULLAH HOTI: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar deputetë,

Përfaqësues të Qeverisë,

Po e nis kështu diskutimin tim, pse na duhet ky projektligj?

Janë dy arsye madhore, besoj. E para, se viti 2022 ka qenë ndër vitet më të rënda në aspektin ekonomik dhe social në Kosovën e pasluftës dhe, e dyta, përjashto disa masa, që unë i vlerësoj periferike, jo substanciale, nuk ka pasur intervenim të fuqishëm të Qeverisë për të mbrojtur qytetarët dhe familjet që janë ndikuar nga inflacioni dhe rënia e të ardhurave reale.

Unë do t'i përmend krizat nëpër të cilat kemi kaluar, dhe pastaj për të parë se si ka vepruar ose nuk ka vepruar Qeveria, për të mbështetur argumentet tona që ky projektligj duhet të mbështetet.

E para – kriza energjetike. Sigurisht kjo na u imponua, por u menaxhua në mënyrë kaotike nga Qeveria. ZRRE-së iu diktua vendimi për rritjen e tarifave për qytetarë, jo edhe për biznese, edhe pse raporti preliminar i ZRRE-së për diskutim publik thoshte tjetër gjë.

E dyta, Qeveria çdo ditë shpallte gjendje emergjente në energjetikë, siç u tentua edhe sot të futej në rend dite, po pa asnjë efekt. I vetmi efekt i këtyre vendimeve ka qenë legjitimimi i reduktimeve të KEDS-it, nëse kanë ndodhur dhe siç po ndodhin nëpër komuna të caktuara.

Këshillat e Qeverisë ndaj qytetarëve për kursim të energjisë u kthyen në tallje publike, sepse vërtet ishin tallje me qytetarë. E tash, ky menaxhim kaotik i krizës energjetike krijoi pasiguri te qytetarët dhe çfarë ndodhi? U rritën çmimet e lëndëve djegëse, gati u dyfishuan, edhe pse nevojat ishin të njëjta sikurse në dimrin e kaluar. Edhe bizneset u detyruan të gjejnë zgjidhje alternative, e cila gjë i rriti kostot e prodhimit dhe rrjedhimisht çmimet e produkteve në treg. Ne propozuam si opozitë heqjen e TVSH-së në energji për një periudhë, nuk u mor parasysh.

Kriza e dytë është te çmimet e naftës. Këtu çmimi i naftës u rrit, por norma e TVSH-së në naftë nuk u ndryshua. Dhe, çka ndodhi? Qytetarëve iu dyfishua ngarkesa tatimore. Ja një shembull shumë i thjeshtë për ta pasur të qartë të gjithë qytetarët. Kur çmimi i naftës në treg ishte 1 euro, Qeveria mblidhte 14 centë TVSH për litër të naftës. Kur çmimi arriti 1,85 euro, Qeveria mblidhte 27 centë për litër të naftës. Pra, gati dyfish barra për qytetarë. E kemi argumentuar në vazhdimësi se Qeveria do të mblidhte njësoj të hyra, sikur ta përgjysmonte TVSH-në në naftë.

E në vend se të ulej TVSH-ja, Qeveria mori disa vendime absurde. Shihni tash, në pjesën e parë të vitit caktoi marzhën tregtare 4% për shitje me shumicë dhe 6% me pakicë. Po kjo çfarë nënkuptonte në realitet? Pra, kur çmimi i naftës ishte 1 euro shitjet me shumicë kishin marzhë tregtare 4 centë, e ata me pakicë 6 centë, por kur çmimi shkoi 1,85 marzhat u rritën 7 centë me shumicë dhe 10 centë me pakicë. Çfarë ndodhi? U dyfishuan marzhat tregtare në terme absolute për tregtarë. Kush e barti këtë barrë? E bartën qytetarët e vendit.

Kur e pa absurditetin e këtij vendimi, mandej Qeveria kaloi me një vendim tjetër te çmimi i naftës, duke caktuar çmimin maksimal për litër të naftës. Edhe pse kjo qasje ishte e gabuar në mendimin tonë, me caktimin e çmimit maksimal përgjysmimi i TVSH-së që ne e propozuam në naftë do të kishte funksionuar në mënyrë perfekte, sepse argumenti i Qeverisë për të mos ulur TVSH-në thoshin se nuk do të reflektohet në çmimin e tregut. Por, kur çmimi maksimal caktohet me vendim, ulja e TVSH-së do të ishte e plotë në çmimin e tregut të naftës.

E treta, është inflacioni në çmimet e mallrave të konsumit, të cilat u rritën pa përjashtim. Sigurisht kjo edhe për shkak të importit, sepse varemi shumë nga importi. Por, Qeveria nuk u doli në ndihmë as këtu qytetarëve. Sikur në rastin e naftës, qytetarët paguanin shumë më tepër tatim si TVSH, për shkak se TVSH-ja mbeti e njëjtë, edhe pse ne sugjeruam që të ulej nga 18 në 8%, siç e parasheh ligji në fuqi për TVSH-në për një listë shtesë të produkteve ushqimore. E në vend se të ulej TVSH-ja dhe të ndihmoheshin qytetarët, këta dilnin vazhdimisht në konferenca dhe lavdëroheshin për rritje të të hyrave buxhetore, e cila në fakt vinte nga rritja e çmimeve, e jo nga aktiviteti i shtuar ekonomik, sepse statistikat tregojnë që rritja ekonomike nga 16% në tremujorin e dytë, kur këta e morën qeverisjen, në muajt e parë kur e kanë marrë qeverisjen, ka rënë në 2% në tremujorin e tretë të vitit 2022.

Nuk i ndërmoren as masat që i ndërmoren në fakt vendet e tjera, siç ishte rritja e pagës sipas normës së inflacionit, ulja e ngarkesave tatimore, ndihma pa përjashtim e qytetarëve dhe masa të tjera. E kriza më tutje u thellua edhe për shkak të rënies së investimeve kapitale dhe ekonomisë si rezultat sot i mungojnë qindra miliona euro në qarkullim. Kur vendi përballet me krizë, një ekonomist që ka një formim elementar dhe kur ka pozitë vendimmarrëse, çfarë propozon? Të shpenzojë sa më shumë. Kjo është logjika elementare për të kaluar krizat ekonomike.

Çfarë bënë këta? I ulën investimet kapitale rekord, në vetëm 11%, deri në tetor 2022 dhe përtej kësaj, edhe konsumi final i Qeverisë ra në -3 dhe -2% në tremujorin e dytë dhe të tretë të vitit të kaluar, nga një rritje prej 21%, që ne e kishim bërë në muajt e fundit të Qeverisë kur ishim atëherë. Këtu na u prezantuan shifra për të mbuluar dhe për të paraqitur gjendje tjetër të rritjes së eksporteve. OK, në rregull jemi, janë rritur pak eksportet, por importet janë dhjetëfishuar krahasuar me rritjen e eksportit dhe kah kanë ardhur ato importe? Shihni, pas disa viteve është kthyer Serbia në partnerin kryesor tregtar të Kosovës në rajon.

E tash, ekonomistët e Qeverisë garantë dalin e thonë, siç e kam përmendur edhe një herë tjetër, që kjo është tregti e lirë, a po? Po, tregti e lirë ka qenë edhe kur i rrotullonit kamionët njëherë e një kohë.

E çka ndodhi me këtë menaxhim? U rrit bilanci bankar i Qeverisë, shkoi në 700 milionë euro në tremujorin e tretë të vitit 2021 dhe tash po presim për raportin vjetor të këtij viti. U ulën shpenzimet kapitale, ra konsumi final i Qeverisë, humbën këto mjete në sistemin bankar, për shkak të inflacionit, në vend se t'u jepeshin qytetarëve.

Prandaj, të nderuar deputetë, me gjithë këto kriza dhe kur mbështetja e Qeverisë mungon, është e natyrshme që opozita të propozojë masa, siç është tërheqja e kursimeve pensionale nga Trusti. Kjo nuk është zgjidhja e duhur, sigurisht. Gjithkush e ka të qartë se nuk mund të tejkalohet kriza ekonomike dhe sociale me tërheqje të mjeteve nga Trusti pensional, por është zgjidhja e vetme që ka mbetur në dispozicion të qytetarëve.

Ne kemi propozuar vazhdimisht dhe ka qenë plotësisht e realizueshme, sepse bilanci bankar shkoi në 700 milionë, që të rriten pagat në sektorin publik, së paku për normën e inflacionit, të rritet paga minimale në sektorin privat. E nisët iniciativën, e harruat, sepse hytë në eksperimente dhe në fyerje publike ndaj veteranëve, duke i quajtur "mercenarë" dhe e harruat komplet atë iniciativë ligjore, uljen e TVSH-së nga 18 në 8%, asnjërin nga këto masa nuk e ndërmorët, edhe pse kanë qenë plotësisht të realizueshme për buxhetin e shtetit.

Çka ndodhi? E mbyllni vitin me bilanc bankar dyfish më shumë se sa që është i nevojshëm, 700 milionë euro, të cilat me një statistikë shumë të thjeshtë janë afër 100 milionë euro, që janë zhvleftësuar tanimë, janë humbur për shkak të inflacionit. Aq shumë pasiguri keni krijuar që më 1 shkurt të hyjë në fuqi Ligji i pagave dhe 85 mijë veta në sektorin publik nuk e dinë sa kanë pagën. Shumica prej tyre kanë kredi në banka, shumica prej tyre kanë obligime të rregullta mujore. Nuk e dinë sa e kanë pagën. Kurrë pasiguri më të madhe nuk ka pasur te qytetarët se sa tash. Në këtë situatë ne nuk kemi zgjidhje tjetër, përveçse ta mbështesim plotësisht këtë projektligj dhe të ftojmë të gjithë deputetët e Kuvendit të Kosovës që ta mbështesin këtë projektligj. Faleminderit!

KRYETARI: Ky ishte qëndrimi i Lidhjes Demokratike. Tash e ka radhën AAK-ja, shefi i grupit, Besnik Tahiri.

BESNIK TAHIRI: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar deputetë,

I nderuar zëvendëskryeministër,

Kabinet qeveritar,

Qytetarë të Republikës së Kosovës,

Po e nis fjalën time me konstatimin e parë, i cili mendoj se është më i rëndësishëm dhe është fakti që sot po e trajtojmë një nismë të qytetarëve të Kosovës, e cila pa asnjë dyshim është përmbi interesin politik dhe partiak, në këtë rast edhe të opozitës, mirëpo edhe të pozitës.

Po e trajtojmë Trustin për herë të dytë. Hera e parë ishte iniciativa e deputetit Haxhiu, e cila u pa si iniciativë opozitare. Ju e dini, ka qenë edhe qasja e kryeministrit që thoshte: “A do të votoni për iniciativën e deputetit, apo për iniciativën tonë?”

Sot jemi para një situatë të re, një situatë ku me mijëra qytetarë kanë sjellë para nesh një propozim, i cili së paku do të duhej të trajtohet seriozisht dhe të trajtohet prej këndvështrimit të interesit publik dhe qytetar dhe jo të kullës politike prej lidërshiptit politik.

Po e nis fjalën time me një konstatim të parë, se mjetet e grumbulluara në Trust, para së gjithash janë mjete të qytetarëve, janë mjete të kontributdhënësve, janë mjete të punëtorëve, si në sektorin privat, po ashtu edhe në sektorin publik. Mohimi i qasjes dhe shfrytëzimit të një përqindjeje nga vetë kontributdhënësit është pa dyshim një qasje nënshtruese, e përbuzshme dhe në emër të barazisë dhe sigurisë sociale.

Në goftë se, roli i Qeverisë është rol më shumë i kujdestarisë, për shkak se Trustin e menaxhon një bord, është fond i pavarur, atëherë të analizojmë pak pse kemi ardhur këtu. Ta analizojmë pak qasjen e Qeverisë në raport me gjendjen sociale. Janë dy vjet, po bëhen dy vjet më 14 shkurt prej kur nuk ka asnjë veprim, ama asnjë veprim më të voglin, për ta zbutur varfërinë, për ta zbutur krizën sociale dhe për t’i adresuar çështjet që tash e sa kohë janë ngritur.

Po e nis prapë me sektorin privat. Numri më i madh i të punësuarve që kërkojnë tërheqjen e parave të tyre, paratë që ata i kanë kursyer në këtë Trust, është tepër joserioz. Paga minimale vazhdon të jetë e njëjta. Veprimet në mbështetje të zhvillimit ekonomik të zbutjes së papunësisë janë zero. Fjalë sa të duash, veprime asnjë.

Në goftë se flasim për sektorin publik dhe flasim për 80 mijë kontributdhënës, shohim se për tri herë radhazi dështoi Ligji i pagave dhe sot në fillim të vitit 2023 ende nuk dihet vlera, e lëre më rritja e premtuar, jo me fjalë, por rritja e premtuar nga Qeveria me agjendë legislative, se ky ligj do të kalojë dhe do të hyjë në fuqi. Po qasja ndaj një kategorie tjetër, të cilët sot presin prej nesh të marrim një vendim meritator në mbështetje të kërkesës së tyre, ka qenë tepër joserioze.

Kur flasim për ekonominë dhe për çmimet. Unë nuk po ndalem shumë, se u fol nga të gjithë ne për rritjen e çmimeve dhe secili prej nesh merret, ka familje, e di se sa është rritur shporta e konsumit për një familje. Kërkesa për votimin e Trustit është kërkesë legjitime, e cila po ashtu buron nga disa të dhëna të tjera që duhet të cekën këtu.

Kjo Qeveri edhe pas dy vjetësh nuk arriti ta kuptojë, se e vetmja rrugëdalje nga varfëria është zhvillimi ekonomik dhe njerëzor dhe qasja proaktive ndaj një gjendjeje të jashtëzakonshme, të cilën secili shtet, edhe në Evropën Juglindore, po gjithandej globit, e ka trajtuar me kujdes të veçantë.

E kam shtruar më herët një çështje dhe kam pyetur: për interesa të kujt po punoni?

Pse të mos lihet një periudhë kohore prej një muajsh për ata që duan t'i tërheqin kontributet e tyre?

Ta kuptojmë se kush do t'i tërheqë. Jam i bindur, duke e pasur parasysh edhe presionin që e kemi prej qytetarëve, kërkesave dhe thirrjeve që i kemi tani, që një numër i madhi tyre do të kërkonin të bëjnë tërheqjen e fondeve dhe mjeteve të tyre.

Në qoftë se bëjmë një analizë tash të Trustit, raportimet janë se vetëm në vitin e kaluar mbi 100 milionë euro kanë humbur në këtë Trust. A doni t'i lëni të humbin edhe 100 milionë euro, apo do t'ua mundësojmë qytetarëve të Kosovës që të marrin një kursim, për të cilin do t'i bëjnë disa veprime, do ta shuajnë pak a shumë, do ta zbusin pak a shumë jetën e tyre sociale.

Në qoftë se ju e keni ndarë mendjen, shpresoj që ende nuk e keni ndarë mendjen për të mos e votuar, atëherë ju po ushtroni një dhunë të dyfishtë mbi njerëzit. Po mohoni mjetet, si dhe po dhunoni vullnetin e lirë qytetar.

Krejt kjo në emër të asaj se ju po shihni dhe po e dini se çfarë na pret pas 10 vjetësh, 20 vjetësh dhe 30 vjetësh, përderisa as sot e kësaj dite nuk jeni të aftë të definoni çështjet më të thjeshta, ta definoni çështjen e koeficientit, për shembull, të definoni veprimet konkrete që janë në vitin që po vjen.

Po e përmbyll fjalimin tim me dy porosi:

E para, të nderuar deputetë, sot secili prej nesh do të shihet se a jemi në urdhër të liderit, apo jemi të përzgjedhur të popullit dhe të votojmë për interesat e tyre.

Dhe, e dyta, që për mua është shumë e rëndësishme, dje u konfirmua që ky Kuvend votoi kundër një ligji, që ishte me vendim të Gjykatës Kushtetuese. Pra, dje ishte vendimi antikushtetues, sot mos ta bëjmë, të mos votojmë një vendim kundër qytetarëve të Kosovës. Faleminderit!

KRYETARI: Mirë. Tash Lëvizja Vetëvendosje nuk më ka sjellë kurrfarë liste. A doni të shkojmë sipas rendit që e keni kërkuar fjalën? Mirë. Jo, po u kryen grupet. Nëse dëshiron ministri, po ashtu e ka të drejtën e fjalës së tij. Urdhëro, zoti Murati!

MINISTRI HEKURAN MURATI: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Të nderuar deputetë,

Të nderuar kolegë të Kabinetit qeveritar,

Jemi këtu përsëri për të njëjtën temë, që tashmë ka marrë një përgjigje nga Kuvendi dhe dihet përgjigjja. Pra, herën e kaluar që ishte nismë legjislative e një grupi të deputetëve nga PDK kishte marrë përgjigje negative, ajo që edhe do të duhej të ishte. Mirëpo, prapë është sjellë këtu me arsyetimin dhe argumentin, që gjoja se tani po e kërkojnë qytetarët dhe duhet të votohet. Dhe, u tha edhe një e pavërtetë, se gjoja ky na qenka ligji i parë, apo nisma e parë ligjore që vjen si nismë e qytetarëve.

Më lejoni t'jua rikujtoj që po në këtë Kuvend ka qenë edhe një nismë tjetër e tillë, që ka pasur të bëjë me homologimin e automjeteve. Edhe për atë çështje janë mbledhur mbi dhjetë mijë nënshkrime nga qytetarët dhe kur ka ardhur çështja në seancë të Kuvendit, më saktësisht në vitin 2021, opozita e keni votuar kundër. Domethënë, ka qenë për të mirën e qytetarëve dhe ju e keni votuar kundër.

Pra, këtu shihet se nuk ka të bëjë me interesa të qytetarëve, por kur ballafaqohen interesat e qytetarëve me interesa private e personale, ju normalisht që interesat e qytetarëve nuk i merrni fare parasysh. Në rastin konkret, kemi të bëjmë me një popullizëm, i cili edhe po të vinte nga Qeveria, nga opozita, po të kishte një opozitë të përgjegjshme normalisht, se nga ju s'besoj që mund të kërkohej një gjë e tillë, nga opozita do të duhej të ndalohej.

U tha “qytetarët po e kërkojnë”. Qytetarët e kanë votuar edhe Qeverinë tonë me 50,2%, por çka po synohet këtu, me këtë nismë është shkatërrimi i një sistemi pensional, se kjo tashmë edhe është thënë nga deputetë të opozitës. Pra, synimi është që të merren këto 30%, pastaj edhe një 30% tjera dhe të shkatërrohet si sistem dhe të kalojmë në sistemin ku kontribuon gjenerata për gjeneratë. Pra, gjeneratat aktuale që kanë kontribuar duhet të vazhdojnë të kontribuojnë edhe për gjeneratat e tjera duhet të paguajë dyfish, kushdo që ka paguar në Trust, për shkak e dikujt i është tekur të shkatërrojë sistemin. Ne e kemi pasur një sistem pensional, të cilin na e ka shkatërruar Serbia dhe i ka marrë fondet. Tash edhe opozita po do ta shkatërrojë këtë sistem, që mezi e kemi ndërtuar. Domethënë, ky është synimi.

U tha çështja, ose u përmend që nuk është bërë asgjë, ose që është bërë pak dhe nga LDK-ja u tha që është propozuar heqja e TVSH-së 8% për të zbutur krizën energjetike. Po, më lejoni t'ju them që ne kemi bërë shumë më shumë se aq, sepse ju kujtohet besoj, kur në këtë Kuvend thuhej nëpër fjalime që për energjinë do të trefishohet çmimi, do të jetë dimër i papërballueshëm, kostoja enorme, do të bankrotojnë qytetarët e shteti dhe ja ku jemi, lëre që s'është rritur çmimi i energjisë elektrike, sepse e kemi subvencionuar në tërësi koston e shtuar të importit, por kemi rastin që kurrë më lirë qytetarët nuk kanë paguar nga muaji shtator deri në muajin dhjetor, për shkak se tarifatat dhe faturat u janë subvencionuar nga Qeveria për secilën familje që ka kursyer.

Pra, janë mbi dyqind mijë familje që kurrë më lirë s'ë kanë paguar energjinë elektrike. Pra, kjo është shumë më se tetë për qind.

Kur jemi te TVSH-ja, i nderuar deputet Hoti, sa keni qenë ju ministër i Financave, TVSH-ja nga 16 është bërë 18 për qind. Besoj ju kujtohet. Për më tepër, kur ka kaluar tërheqja e parave të Trustit, kemi qenë në Komisionin Parlamentar për Buxhet dhe Financa, dhe ministrja Hykmete Bajrami asokohe ka qenë prezente aty dhe ka qenë amendamenti i PDK-së për rimbursim, sepse fillimisht ligji pat ardhur që të jetë vetëm tërheqje. Pastaj PDK-ja e pat shtuar amendamentin për rimbursim. Kur kam pyetur se si po mendoni t'i paguani, sepse bëhet fjalë për mbi njëqind milionë euro që do t'i kushtojë kjo, përgjigjja ka qenë e bëjmë TVSH-në njëzet për qind prej tetëmbëdhjetë se jemi vendi i vetëm në rajon që e kemi nën njëzet për qind.

d.m.th. po të ishit ju në Qeveri, TVSH-ja do të rritej. Ky ka qenë plani dhe kjo ka qenë përgjigjja. Ne kemi gjetur shumë mënyra të tjera me të cilat u kemi ndihmuar qytetarëve. Për më tepër, mua më vjen shumë keq që nga një person si deputeti Hoti të ketë edhe dezinformata dhe gabime elementare edhe me shifra edhe në llogaritje. Thotë që ka rënie të aktivitetit ekonomik, ndërkaq nuk e prezanton as edhe një fakt të vetëm kredibil nga çfarëdo institucioni me kredibilitet minimal. D.m.th, ku është rënia e aktivitetit ekonomik? Një shifër, për shkak se aktiviteti ekonomik, qoftë nga Agjencia e Statistikave, qoftë nga Banka Qendrore, qoftë nga të dhënat e Administratës Tatimore është rritur për së paku njëzet për qind vitin e kaluar krahasuar me vitin paraprak. U tha që investimet kapitale kanë qenë njëmbëdhjetë për qind, po ashtu e pavërtetë. Investimet kapitale për vitin e kaluar kapin shifrën 422 milionë euro, pra tejkalojnë edhe nivelin e vitit 2021, edhe nivelin e vitit 2020. Pra edhe një dezinformata tjetër.

U tha që shtatëqind milionë euro është bilanci bankar në fund të vitit. Po ashtu e pavërtetë. Bilanci bankar në fund të vitit ka rënë për shkak se zakonisht siç edhe jua kam sqaruar, zakonisht pagesat e faturave për investimet kapitale bëhen në tremujorin e tretë. Kjo nuk varet as nga Qeveria, as nga Ministria e Financave. Varet nga organizatat buxhetore edhe të nivelit qendror, edhe ato lokal, por edhe nga punëkryesit se kur kryhen punët, kur sillen faturat dhe kur paguhen. Do ta pranoni shumë shpejt raportin, mirëpo ju lutem mos dezinformoni.

Sa i përket asaj që u tha se importi është dhjetëfishuar, është rritur dhjetëfish, po ashtu një e pavërtetë. D.m.th. nëse ka qenë katër miliard euro në vitin 2021, kjo po i bie që në vitin 2022 qenka bërë dyzet miliardë euro. Ju lutem, i nderuar deputet, mosni me këso dezinformata, sepse është joserioze edhe për ju.

U tha që Serbia është bërë partneri kryesor tregtar. Kjo hiq më larg se para ca ditësh u demantua nga një organizatë e shoqërisë civile që kishte publikuar të dhëna të detajuara për secilin shtet. E vërtetë që importi i formalizuar ka rritje në raport me një vit paraprak, por ende as për së afërmi nuk është në nivelin kur e keni lënë ju në qeverisje. Për më tepër, arsyeja kryesore pse është

rritur ky import, se më duhet edhe t'jua them këtë, pra kontributori kryesor është një kompani, pra pije të gazuara. Pra pije të gazuara me sheqer të shtuar, që importi është pesëdhjetë milionë euro. A e dini, i nderuar deputet Hoti, pse është rritur ky import? A e dini? Është rritur për shkak se gjykatat në Kosovë kanë vendosur që të ndalohej importi nga Shqipëria dhe e dyta ju kur keni qenë në Qeveri për ato pak muaj e keni hequr akcizën për këtë produkt. Ju i nderuar deputet në qeverisjen tuaj për këtë produkt. Ky është kontributori kryesor i rritjes së importit nga Serbia.

Prandaj, ju lutem edhe një herë konsultoni si duhet faktet, sepse pastaj po vijmë në situata të tilla.

U tha që nuk ka pasur as edhe një mbështetje për qytetarët. S'qenka deputeti këtu, ndoshta më vonë mund edhe të replikojmë e të diskutojmë, por këtë e dinë më së miri qytetarët. Mbështetja që Qeveria jonë ka bërë ndaj qytetarëve ka qenë më e madhja në shtetet e rajonit, por edhe më larg, por normalisht që një krizë globale e në fakt disa kriza globale normalisht që e vështirësojnë jetën e qytetarëve dhe secili shtet dhe secila Qeveri shumë më të forta se ne e kanë sfidë që të kompensojnë dhe të mbështesin të gjithë qytetarët, e aq më tepër kur neve na mungojnë edhe sistemet, për shkak se po tentojmë pra që sa herë ta sjellim në Kuvend marrëveshjen me Bankën Botërore për reformim të skemave sociale dhe pensionale, do të jetë hera e tretë që vjen dhe nga po ky Kuvend votohet kundër. D.m.th. po ta kishim një sistem më të mirë, ose po ta kishim trashëguar një sistem më të mirë, do ta kishim më të lehtë të mbështesim qytetarët më shpejt dhe në mënyrë më të drejtë. Faleminderit!

KRYETARI: Replikat tash janë. Replikën e parë ia japim, jo z. Shala po ia japim replikën.

FERAT SHALA: Faleminderit, kryetar!

Sinqerisht të dëgjosh një ministër të thotë ne po e shkatërrojmë sistemin, i cili minsitër tërë jetën e vet s'ka ndërtuar gjë, veç ka shkatërruar, ka thyer e ka bërë, është goxha interesant ta dëgjosh. Pra, ta dëgjosh një ministër i cili thotë kam ndihmuar energjinë e i cili e ka sjellë KEK-un me humbje ditore 150 milionë euro për shkak të zvogëlimit të kapacitetit dhe këtë shumë kthehet e importon nga mafia energjetike, edhe kjo është shumë interesante. Ta dëgjosh një ministër që thërret për populizëm opozitën, i cili tërë jetën e vet mbi bazën e populizmit të rrejshëm ka ardhur në pushtet, edhe kjo nuk do koment.

Pa më thuaj ministër, dymbëdhjetë vjet qeveritë e kaluara kanë subvencionuar pjesën në veri me 78 milionë. sa ke dhënë ti vetëm vitin e kaluar? Sa ke planifikuar këtë vit? Ku janë këto mjete? Bëjeni barazimin dhe dil në foltore, tregoji shifrat saktë. Nuk po kërkojmë ta shkatërrojmë sistemin. Po kërkojmë barazi qytetare. Qytetarë janë edhe këta të jugut. Jepu vetëm aty sa po u jep në pjesën në veri, jepu edhe këtyre në jug. Qe unë po të ofroj një alternativë. Merre të lutem ato mjete që ke për t'i ndarë këtë vit për pjesën në veri, ndihmë janë ato, plaçkë janë ato qytetarëve në jug që po ua bën, kthejua këtyre në jug. Aq para dhe kthej në anë të linjave të tua buxhetore që i ke dhe nuk kanë nevojë njerëzit ta heqin Trustin. Vetëm atyre që po bëjnë

kërkesë, jepu aq sa po i jep veriun. Nuk është populizëm kjo sa po ta jap ty, se ky është populizmi yt.

KRYETARI: Tash fjalën ia japim deputeti Avdullah Hoti për replikë.

AVDULLAH HOTI: Faleminderit, kryetar!

Tash unë ndoshta më duhet ta pyes Kujtimin ose edhe juve t'i përdorë fjalët e kujdesshme parlamentare që mos t'i thuhet një ministri ose një deputeti as gënjeshtar as mashtrues. Po kështu po flet ministri. Kur ka thënë një zyrtar i LDK-së që do ta rrisim TVSH-në nga tetëmbëdhjetë në njëzet për qind. Kurrë asnjëherë. Si i interpretova unë të dhënat për importin dhe eksportin? Atë që e thashë unë, nëse eksportet të janë rritur me tetëdhjetë milionë, importet të janë rritur me tetëqind milionë, është një me dhjetë raporti. Është thelluar deficioni tregtar për një miliard euro më shumë sesa ka qenë vitin e kaluar.

Tjetra, të dhënat e Agjencisë së Statistikave të cilat i kanë bërë publike, tregojnë që rritja ekonomike matur sipas produktit të brendshëm bruto, në tremujorin e dytë 2021, merr shënime, ka qenë gjashtëmbëdhjetë për qind, në tremujorin e tretë 2022 ka rënë në dy për qind. Ku është ai aktiviteti ekonomik dhjetë për qind? Po shihni, një ministër i Financave, dëgjo mirë kur flas të kisha lutur, një ministër i financave që i shkojnë shtatëqind milionë euro i rrinë në bilanc bankar me inflacion mesatar dymbëdhjetë për qind, a e di çka do të thotë kjo? domethënë që njëqind milionë euro gati po të humbasin, po të zhvlerësohen. Një ministër i Financave që i ka shtatëqind milionë euro në llogari edhe kërkon kredi për skemat sociale, çfarë ministri i Financave është ky?

Ose anomali edhe më e madhe, a e di çfarë marrëveshje të kredisë ke sjellë? Ke sjellë marrëveshjen e kredisë me këtë Bankën Zhvillimore të OPEC-ut e je marrë vesh me atë bankë, merre me mend ti, je marrë vesh me atë bankë të OPEC-ut të lindjes për reformat që i kemi bërë në Kosovë. hej, merre me mend, me një bankë të OPEC-ut ku aksionarë.

KRYETARI: Replikë Bekim Haxhiu po ashtu.

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, kryetar!

Do të jem i rezervuar për t'i dhënë përgjigjen e merituar ministrit të Financave për faktin që sot i përfaqësoj me autorizim këta 21 398 qytetarë të cilët nuk janë gjoja, po janë qytetarë të Republikës së Kosovës, të cilët me nënshkrimet e tyre, duke u identifikuar në sheshet e Kosovës kanë nënshkruar iniciativën për rikthimin e Projektligjit për Trustin në Kuvendin e Kosovës.

T'i quash qytetarët si gjoja, është ofendim për ta dhe në anën tjetër, nuk do të duhej një qasje e tillë e ministrit të dalë në foltore dhe të shpif, se askush nuk e tha, unë të paktën nuk e thashë që për herë të parë vjen një iniciativë ligjore nga qytetarët në Kuvendin e Republikës së Kosovës.

Në anën tjetër, i dimë, nëse keni kërkuar në të kaluarën që të votohen, edhe nëse në emër jeni drejtuar këtu në Kuvend që populli duhet të pyetet, ky është populli. Ai po kërkon t'i tërheq mjetet nga Trusti. Tash Hekuran, po mendon më mirë për qytetarët se ata për vete. Ndoshta. Ndoshta po mendon më mirë për bankat, sepse asnjëherë më shumë nuk kanë pasur profit bankat se në vitin 2020. Kjo është edhe për shkak të politikës së Qeverisë. Prandaj, ndryshojeni këtë qëndrim. Na ke premtuar në vitin 2021 në komision parlamentar se do të sjellësh reformën pensionale në vitin 2022 dhe nuk e ke sjellë reformën pensionale. Nuk e ke sjellë asnjë ligj të reformës pensionale. As koncept-dokument del s'të këtë hartuar për reformën pensionale. Nuk po dua t'i numëroj premtimet që i keni dhënë si Vetëvendosje.

KRYETARI: Hykmete Bajrami, po ashtu.

HYKMETE BAJRAMI: Faleminderit, kryetar!

Ministër, asnjëherë nuk kam deklaruar që do të rritet TVSH-ja prej tetëmbëdhjetë në njëzet për qind. Përndryshe, në kohën kur z. Hoti ka qenë ministër i Financave, po ta rikujtoj që shporta bazë e konsumatorit, TVSH-ja është zbritur prej gjashtëmbëdhjetë për qind në tetë për qind. Ndërkohë që ju keni premtuar dhe keni ardhur në pushtet se do ta bëni zero, po nuk e keni bërë asnjëherë zero.

Tjetër, ministër, është shtrenjtuar energjia elektrike në fillim të vitit 2022, 85 për qind e ke shtrenjtuar tarifën e lartë, 104 për qind tarifën e ulët ose vice-versa. Investimet kapitale në raportin që ju e keni dorëzuar ministër, 704 milionë euro të parapara në buxhetin e vitin 2022, vetëm njëmbëdhjetë për qind, raporti që është draftuar prej ministrisë tënde, ka thënë që është realizimi në nëntëmujorin e parë. Çka ka ndodhur në tremujorin e tretë, ne nuk e dimë se ato informata ende nuk i kemi, i keni vetëm ju dhe ne flasim me shifra.

Tjetra, ministër, nëse akcizën që e kemi larguar ne në Qeveri për lëngjet e gazuara, urdhëro hiqe, qe dy vjet e ke Qeverinë. A e di si bëhet ajo? Me vendim tëndin shkon në Qeveri, sillet në Komisionin për Buxhet, Financa dhe Transfere. Nëse është i keq, 51 për qind të kanë besuar qytetarët. Pse nuk po e ribën? Merre e zhvlerësoje.

Tjetër, je ministri i cili sot e merr vetëm gjysmën e pagës për kontestin që e ke me drejtorin e Doganave e drejtori i ATK-së më falni, e merr gjysmën e pagës për shkeljet që i ka bërë rreth gjashtëdhjetë personave në stafin e ATK-së. Kështu i udhëheq institucionet. Je në gjysëmpage ti, në gjysëmpage ai, e ai është pa mandat prej shkurtit të vitit 2022. Nuk fola asgjë për pagën minimale.

KRYETARI: U kryhen replikat. Tash është mundësia e ministrit që të përgjigjet. Jo dhjetë minuta. Ia jepni vetëm katër minuta ministrit, ju lutem.

MINISTRI HEKURAN MURATI: Tash vetëm u konfirmua që shumë prej të thënave pra paskan qenë dezinformata që u thanë, sepse e panë të nevojshme të risqarohen dhe u rikonfirmua pra që as nuk qenka dhjetëfishuar importi, e as nuk qenka Serbia partneri kryesor tregtar e as nuk qenka që nuk është ndërmarrë asnjë masë.

Sa i përket TVSH-së, znj. Bajrami keni qenë aty, keni qenë ministre, unë kam qenë kryetar i Komisionit për Buxhet, Financa dhe Transfere. Kur ka kaluar amendamenti në komision, pyetja ime ka qenë si mendoni ta financoni, sepse janë njëqind milionë euro. Bedri Hamza ka thënë e bëjmë njëzet për qind dhe ju jeni pajtuar. Mirëpo, ju keni qenë ministre dhe keni votuar që të kalojë ai amendament, për shkak se nuk keni pasur mundësi se si ta kaloni. D.mt.th. po të kishit qenë ju edhe njëherë në koalicion, qysh e keni koalicionin tradicional, TVSH-ja do të rritej. Pra qytetarët duhet ta dinë këtë.

Te çështja, u përmend këtu fondi i OPEC-ut, unë s'di deputeti Hoti çka ka kundër fondit të OPEC-ut. Nëse ka diçka e ftoj që të na sqaroj. U përmend që padrejtësisht paskam thënë se hera e parë, e tha një koleg i juaj, ishte deputeti Shala që tha se është hera e parë që po sillet diçka prej qytetarëve për votim këtu.

Edhe u kërkua se pse s'po bëhet reforma pensionale. Të njëjtën gjë jua kam thënë në Komision se sapo ta votoni marrëveshjen me Bankën Botërore, reformën e kemi të gatshme do ta sjellim në Kuvend. Këtë e kam thënë dhe kësaj i qëndroj prapa çdo ditë të javës.

Kurse, sa i përket mënyrës se si funksionojnë bilanci bankar, si funksionon buxheti, viti fiskal e inflacioni, po besoj që këtu nevojitet më shumë sesa minutat që i kam në dispozicion për ta sqaruar. Mirëpo ka shtete që kanë norma të inflacionit edhe njëzet e tridhjetë për qind, por bilancin bankar e kanë shumë më të lartë, e kanë dhjetëra miliarda euro, sepse shteti nuk mbahet me teori dhe me ide e mendime që te ne realisht gjejnë hapësirë në skeçe humoristike. Unë konsideroj që ekonomistët do të duhej të ishin më seriozë se kaq. Faleminderit!

KRYETARI: Tash kemi të paraqitur grupet e tjera parlamentare, prej VV-së nuk po më del askush, kështu që kalojmë te PDK-ja. Ia japim fjalën deputetit, a shkojmë me radhë? Si të vendosim? Siç janë paraqitur këtu. Hisen Berisha, pra!

HISEN BERISHA: I nderuar, kryetar,

Në lidhje me kërkesën e qytetarëve të lodhur nga keqqeverisja apo degradimi ekonomik i vendit dhe varfërimi social i tyre, për të tërhequr nga paratë e tyre të ndara në Trust sipas asaj formulës popullore paraja e bardhë për ditë të zezë, besoj që duhet të arsyetohet si e tillë, sepse ditë më të zeza për qytetarët e Kosovës nuk ka pasur se këto dy vite të qeverisjes, bile mendoj se as në vitet e para të pasluftës kur çdo gjë ishte rrënuar tërësisht dhe ishim pa shtet.

Kjo kërkesë arsyetohet edhe me faktin se ju sot i keni prodhuar sipas deklaratave që ka bërë Kryeministri në këtë foltore 341 mijë njerëz që i mbështetni me social, pra jetojnë në varfëri, keni prodhuar të varfër që jetojnë nga njëqind euro. Në këtë kategori hyjnë po ashtu edhe 330 mijë të punësuar në kompanitë punëkryese të cilat për këto vite e kanë shuar apo e kanë ndaluar aktivitetin e tyre për shkak se Qeveria ka ndaluar të gjitha projektet investive kapitale dhe ka mbajtur paranë e bllokuar në banka. Këto nëse u referohemi të dhënave, atëherë në vitin 2020 ishin 21 mijë kompani që e kanë ndaluar apo shuar aktivitetin e tyre, në vitin njëzet janë pesë mijë dhe në v.2022 deri në tetor ishin 1 800 të tilla që d.m.th. diku afër 27 mijë kompani që i bie veç një njeri ta kenë janë 27 mijë punëtorë, po ku janë tre e ku ka edhe me treqind.

Po ashtu, duhet theksuar se veç në vitin 2021 janë raportuar 42 mijë qytetarë që kanë ikur nga Kosova, potencial për të punuar. Kurse, këtë vit, vetëm në Ambasadën e Zvicrës janë gjashtëdhjetë mijë të tillë.

Pastaj, të gjitha këto janë komponente që tregojnë se këta qytetarë vërtet kanë nevojë imediate për këto para dhe për kohën e zezë që po kalojnë në varfërinë sociale.

U përmendën këtu çështjet e krimit të organizuar të ikjes së financave e ku ta di unë, prodhimet dhe produktet që po vijnë sot nga Serbia e po u vendoset barkodi i Kosovës janë mashtrimet më të mëdha. Vjen vaj me cisterna, mbaj përgjegjësi për këto, le të urdhërojnë organet inteligjente të hetuesisë të merren me to, nga Ukraina, nga Rusia, nga Bullgaria paktohen në Kosovë dhe i vihet barkodi i Kosovës. Vjen qumësht nga Serbia me barkod të Kosovës. Keksa, çokollata, vjen suxhuk me mish të dyshimtë.

Tani që unë po flas në veri të Kosovës kjo nisma që e nxitët në Kosovë, largimin e produkteve serbe, janë akumuluar të gjitha në veri Coca-Cola, Sprite, Fanta e çka janë ato. Veç një dorë kanë hyrë dyqind mijë tiketa Made in Albania dhe ka të rinj që sot po punojnë në veri nga njëzet euro duke ua hequr ato Made in Serbia dhe duke i bërë këto të Shqipërisë banderolë dhe t'i kthejnë prapë në vendin tonë.

Por, unë dua të ngre ky çështje të tjera për të cilat jam i shqetësuar sa i përket çështjes së Trustit. Krahas mbështetjes që i jap kërkesës së qytetarëve për nevojën për të tërhequr një përqindje nga Trusti i tyre, e cila është e drejtë, sepse kam parë polic që vendosin stenda me kredi, kam parë policë që shërohen nga kanceri me kredi. Pyetja ime a do t'i konsideroj Qeveria këto tërheqje si huazim që po ia bëjnë qytetarët për ta sanuar gjendjen e tyre sociale, të cilën ua ka shkaktuar po kjo Qeveri dhe a do të rimbursohen këto mjete dhe cila është shkalla e rimbursimit nga huadhënia e parë që ua kanë bërë qeveritarët duke tërhequr në Trust.

Çështja e dytë që më shqetëson janë ushtarakët të cilët po pensionohen pesëdhjetë vjeç dhe 55 vjeç nënoficer apo oficerë dhe atyre nuk u lejohet tërheqja e Trustit deri në moshën 65-vjeçare,

edhe pse ata nuk punojnë dhe nuk kontribuojnë më në atë Trust. Cila është arsyeja e këtij keqpërdorimi?

Për fjalët që i dëgjova këtu dhe tendencat për të arsyetuar qëndrimin kundër lejimit të qytetarëve që të tërheqin nga mjetet e tyre, me një fjalor pa fije konsiderate për gjendjen sociale në të cilën janë qytetarët, me një fjalor që ngjasonte me ato personazhet, gjuhën e shifrave të personazheve të Xhorxh Orvellit. Vërtet ndjeva keqardhje, por nuk befasohe. Nga ajo çfarë u dëgjua në hyrje të kësaj seance, keqardhjes së treguat për humbjen e madhe që e kishit pasur për Oliver Ivanoviqin dhe diplomacisë strategjike që keni bërë me atë deklaratën e kryeministrit që prapë është keqpërdorim në fatkeqësi të atij që ka vdekur, vërtet nuk befasohe dhe besoj nuk befasohen as qytetarët e Kosovës.

Më lejoni në fund që Kryeministri dhe krejt Qeverinë për kryeshëndosh edhe ndonjë deputeti që është ndjerë keq për këtë humbje, t'i shpreh ngushëllime, Zoti ju lashtë shëndosh edhe në emrin tim edhe krejt këtyre burrave e grave të Partisë Demokratike.

KRYETARI: Tash ia japim fjalën deputetit Eman Rrahmani.

EMAN RRAHMANI: Faleminderit, kryetar!

Fillimisht, unë personalisht distancohem nga fjalimi i z. Muja ku në emër të Grupit Parlamentar paraqiti ato qëndrime. Ajo pse detyrohem të flas sot ndoshta për shkak edhe të një opinionit që është krijuar rreth kësaj teme, kësaj çështje, ku edhe qytetarët kanë jashtëzakonisht interes për të diskutuar dhe për të parë të vërtetën edhe mundësinë më të mirë që mund ta nxjerrim nga ky propozim apo nga kjo iniciativë e cila ka ardhur me iniciativë të disa qytetarëve të Republikës së Kosovës, e që më herët ka ardhur prej deputetëve të PDK-së.

Unë si deputet edhe në legjislaturën e kaluar kam votuar kundër. Mendoj që ka qenë diskriminuese për shkak që sot për ato mjetet që janë tërhequr në atë vit, paguajnë ata që nuk kanë përfituar atëherë. Pra, ka qenë një masë diskriminuese e pabarabartë, por që është kundërshtuar dhe si deputet nuk kam pranuar as t'i tërheq ato mjete as atëherë.

Sot, kjo iniciativë mendoj që është më ndryshe, mirëpo prapë nuk është e duhura dhe besoj që mund ta gjejmë një zgjidhje që nuk dëmtohet as kontributdhënësi edhe largohemi pak prej kësaj retorikës të akuzave të njëri-tjetrit që po ia bëjmë çdo ditë.

Nuk mendoj që korrekte që të kërkojmë dhe t'ju mundësojmë që sot të tërhiqen mjetet e që kur qytetarët të mos i kenë ato ndoshta kohën më të nevojshme. Mirëpo janë disa mënyra edhe kemi shumë praktika edhe vendeve të tjera të cilat e kanë rregulluar këtë çështje dhe besoj që edhe ne në qoftë se ulemi diskutojmë dhe bisedojmë bashkërisht mund ta gjejmë një zgjidhje e cila do të jetë e përshtatshme edhe për kontributdhënësit, por edhe për neve si legjislaturë në përgjithësi.

Te tërheqja e mjeteve, unë mendoj që mund të propozohet në dy raste; njëra është kur kontributdhënësi ka nevojë për trajtim shëndetësor. Ne e dimë që në institucionet shëndetësore publike ka shumë raste që nuk mund të trajtohen, dhe nuk besoj që një pjesë të atyre qytetarëve u duhet Trusti kur u shkojnë qindra-mijëra euro e nuk mundet as ato t'i sigurojë që të trajtohet jashtë vendit.

Në këto raste është një pjesë një përqindje që as shteti nuk e mbulon trajtimin e tyre. E në këto raste mendoj që duhet secili prej nesh ta mbështesë për shkak që shumica e vendeve edhe e kanë rregulluar në këtë mënyrë që për raste shëndetësore u lejohet të tërhiqen këto mjete nga kursimi pensional. Pra, besoj që një kontributdhënëse, më e rëndësishme për të është t'i marrë këto mjete për t'u shëruar sesa shumë prej tyre të mos e kenë mundësinë e shërimit e ndoshta edhe të vdekjes për mungesë të mjeteve financiare.

Te çështja tjetër e që besoj që është fokusi se si duhet të dalim nga kjo zgjidhje që të mos dëmtohen kontributdhënësi dhe të përfitojë në një situatë ku sot realisht nuk është gjendja e mirë as ekonomike, por edhe në të gjitha fushat e tjera për shumë arsye, e më së paku për arsye të kësaj qeverisje.

Kjo mund, besoj që si amendament në qoftë se edhe kalon në lexim të parë, unë do ta prezantoj që tërheqja e mjeteve deri në 30% apo edhe në qoftë se e kemi një dakordim të përbashkët, t'u mundësohet qytetarëve me kushtin që të vendoset amendament që ato të kthehen nga vet kontributdhënësi për një periudhë 10-vjeçare. Kjo u mundëson që sot të tërheqin ato mjete, të dalin dhe të ndihmojnë veten e tyre, familjen e tyre për të kaluar një periudhë të vështirë që një pjesë e konsiderueshme e qytetarëve e kanë sot, dhe që prapë ato t'u kthehen deri në kohën kur pensionohen.

Pra, edhe kur të dalin në pension ata do ta kenë pensionin e plotë, ashtu siç parashihet. Pra, të hyrat nga kursimet pensionale do të mund t'i kenë, por edhe do të kursehet buxheti i shtetit për shkak që nëse kalon në këtë mënyrë, tatimi që parashihet paguhet, kur tërhiqet Trusti nuk paguhet, dhe kjo është një kosto buxhetin e shtetit, e në atë mënyrë në qoftë se ato kthehen brenda dhjetë viteve, ato prapë kur tërhiqen në moshën e pensionimit paguhet tatimi siç është i paraparë me ligj.

E vërteta dhe interpretimi i statistikave mund të bëhet në secilën mënyrë edhe si të duam duke ia dhënë mundësinë secilit, por besoj që duhet të jemi realist për gjendjen dhe që njëra prej çështjeve kryesore që sot kemi e duhet të merremi secili pa marrë parasysh dallimeve politike edhe pozitive që kemi qoftë në Ekzekutiv, Legjislativ, nivel qendror, lokal, është problemi i ikjes së qytetarëve nga vendi.

Dhe, nëse i shohim statistikën, po e marrë një krahasim të cilin e kemi kërkuar si Komision për Buxhet nga Trusti të na e dërgojë, të gjithë anëtarëve të Komisionit për Buxhet, Punë dhe

Transfere është që nëse e krahasojmë shtatorin e vitit 2021 me shtatorin e vitit 2022, kontributdhënës janë 67 750 persona më pak. Pra, në vitin 2021 persona që kanë paguar kontribute pensionale janë 389 942 persona, kurse në vitin 2022 janë 322 192 persona.

Këto statistika janë statistika zyrtare që na janë dërguar prej Trustit dhe i kemi të gjithë anëtarët e Komisionit për Buxhet, Punë dhe Transfere dhe besoj janë shifra të cilat na japin shumë sinjale që bashkërisht të angazhohemi dhe të përmirësojmë jetën e qytetarëve në përgjithësi.

Si praktikë, po e them, dhe si iniciativë nuk është e mirë, por ka mundësi të përmirësohet edhe të formulohet edhe më ndryshe edhe më mirë, edhe që të mos dëmtohet as qytetari, as Buxheti i Republikës së Kosovës.

Ka mundësi që të rregullohet kjo çështje, por që mendoj që duhet edhe një vullnet i përbashkët edhe të merremi pak më seriozisht me këtë çështje për shkak që do të kemi probleme shumë serioze në të ardhmen në qoftë se vazhdon ky trend i ikjes së njerëzve nga Kosova.

Sot, në secilin biznes në secilin vend kemi njoftime ku kërkohen punëtorë profesional. Nesër do të kemi edhe më shumë nëse vazhdojmë kështu. Në sektorin publik ka ikje nga vendi i tyre të punës. Në shumë kategori ka edhe mungesë interesimi për aplikim për punë. Nëse e shohim se cilat janë nevojat edhe kush po kërkon më shumë që të tërhiqen këto mjete, është pikërisht sektori publik për shkak që ka një periudhë 10-vjeçare që nuk ka ndryshim të pagave, inflacionet e vazhdueshme vit për vit e kanë humbur vlerën reale të pagës së tyre dhe duhet të jemi real ndaj kërkesave të tyre. Jo duke dëmtuar të ardhmen e askujt, mirëpo duke ofruar zgjidhje konstruktive të cilat janë në të mirën e përgjithshme.

Kjo besoj që mund të bëhet edhe kisha kërkuar prej secilit që të reflektojë dhe të iniciojmë qoftë edhe ndryshimin e ligjit në tërësi për shkak që ka nevojë të jashtëzakonshme dhe ky ka qenë konstatim edhe i komisionit në përgjithësi, i të gjithë anëtarëve kur kemi diskutuar edhe i përfaqësuesve të Trustit edhe i Bankës Qendrore edhe secilit, për shkak që ka mangësi shumë të mëdha orientimi i investimeve përkufizohet në mënyrën jo të duhur të mjeteve që mban Trusti, ka mundësi të përfitimit shumë më shumë në qoftë se e iniciojmë ndryshimin e ligjit në tërësi.

Shumicën e atyre mjeteve duhet t'u mundësohet të investohen në Kosovë për shkak që ligji e ndalon një gjë të tillë për momentin, ndalon në shumë kategori të investohet. Është i orientuar në kategori të caktuara, ku në Kosovë kanë pak interes të investohet dhe besoj që koha ecë shumë shpejt, ne duhet të veprojmë edhe më shpejt që t'i arrijmë hapat e ta ndalim një ikje të tillë të qytetarëve të Republikës së Kosovës nga Kosova.

Nesër besoj që do të jetë vonë me këtë trend, dhe të gjithë këtu mund të flasim e të bërtasim ditë edhe natë, por që realiteti në terren besoj që e dimë secili mjaft mirë për shkak se secili jemi dhe takojmë qytetarë ditë e përditë. Faleminderit!

KRYETARI: Nga Lidhja Demokratike ia japim fjalën deputetit Driton Selmanaj.

DRITON SELMANAJ: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Në mendoja të flisja, sepse unë jam i vetëdijshëm që secili nga ne kemi familjarë tanë, kemi rrethinë tonë, kemi njerëzit që na rrethojnë dhe unë jam i bindur që nëse e themi të vërteten secilit prej nesh na kanë shkruar, na kanë thirr na kanë thënë, votojeni këtë.

Nëse thoni ndryshe, po jetojmë në dy realitete paralele. Unë kam bindjen që edhe juve u kanë thënë njerëzit që ta bëni këtë. Dhe tash duhet shtruar çështja dhe nuk po arrij ta kuptoj se si ky ministër i Financave edhe për këtë temë që është delikate për mirëqenien sociale të njerëzve të njerëzve e fut Serbinë në mes, fut terma, jo do gaz, jo do pije të gazuara, jo do kështu, do... Por, mos, ju lutem, mos, ju lutem, sepse jemi duke folur për mirëqenien e njerëzve në Kosovë dhe jemi duke folur pse kemi ardhur në këtë situatë.

Dhe, unë dua të vazhdoj vetëm pak ku parafolësi shtroi një çështje me shumë shqetësim është kjo, të nderuar kolegë deputetë, ikjet e njerëzve në Kosovë janë më të mëdha që nga paslufta në këto dy vitet e fundit. Nuk po e them që faji është i kësaj Qeverie, vetëm i kësaj Qeverie, është faji ynë si shoqëri, është faji yni si politikë që s'kemi arritur të ndërtojmë shpresë për të jetuar në këtë vend.

Njerëzit që po aplikojnë sot për të marrë kredi për një investim në Kosovë, bankat kanë filluar s'po u japin, me çfarë arsytimi, sepse me këtë trend të ikjes pas 10 vjetësh në Kosovës do të ketë vetëm 800 mijë banorë, dhe si rezultat s'do të ketë më njerëz që mund të konsumojnë shumë produkte, prandaj si të tilla nuk u japim para për të bërë investim pak më të madh për ndërtimin e një qendre tregtare ose diçka të tillë. Këto janë shpjegime zyrtare që bankat po ua japin sot njerëzve që po kanë interes për të marrë kredi për një investim pak më të madh në Kosovë.

Të mos harroni se nëse ky trend i ikjes vazhdon në Kosovë, ne pas 10 vitesh do të mbesim 700 mijë ose 800 mijë banorë, ngjashëm si shteti fqinj Mali i Zi. Tash në këtë kontekst duhet parë gjërat. A janë vërtet nevojat e njerëzve të tilla që së paku të kthejmë shpresën që të kemi kujdes ndaj njerëzve. A ia kemi qëlluar me masa apo jo.

Nuk po themi që kjo Qeveri s'ka ndërmarrë kurrfarë masash, por po del që nuk janë efikase, sepse nëse shtrenjtimi i të gjitha produkteve bazike në Kosovë ka ndodhur, janë dyfishuar, janë trefishuar çmimet, dhe këtë po e përjetojmë secili besoj. Edhe që ju shkoni për të blerë nëse

shkoni vet për të blerë në marketet tuaja. Shihni sa është shpenzimi i madh i të gjitha produkteve bazike, dhe po del që këto masa që janë marrë s'kanë qenë efikase akoma.

Njerëzit akoma po vazhdojnë të mendojnë që s'ka shpresë për të jetuar në këtë vend, duhet ikur. Të gjithë njerëzit në Kosovë, çdo i dyti i ri në Kosovë nuk projekton ndërtimin e të ardhmes së vet në Kosovë. Që bie, hajt tashti ne e kemi e menduar, edhe në Qeverinë e kaluar kemi menduar që ndoshta tërheqja e parave të Trustit është njëra nga mundësitë dhe e kemi bërë këtë. Ka dalë, thënë të drejtën, që ka pasur efikasitet, sepse shumë njerëz e kanë lavdëruar si proces, sepse kanë bërë një zgjidhje; dikush ka blerë pajisje për shtëpi, dikush ka blerë diçka të caktuar, e kështu-kështu me radhë.

Dhe, unë, zoti ministër, në njërën nga seancat e kaluara jam befasuar me qasjen tuaj kur dole këtu në foltore dhe thatë, qeveritë e kaluara na kanë lënë borxhe në Trust, që u kanë premtuar njerëzve. Po normal që u kemi lënë borxhe, ne s'ju kemi lënë borxhe për njerëzit e Krallevës as të Pozharevcit, të Kosovës, njerëzit tanë, shqiptarët e Kosovës. Populli i Kosovës i ka marrë ato para.

Dhe, normalisht që u kemi lënë borxhe, sepse ju kemi thënë që do t'ju rimbursojmë, dhe kemi bërë mirë. Unë jam i bindur që kemi bërë mirë. Sikur që po themi tash duke i parë këto rrethana që unë po i përmendi. Unë jam i bindur që kjo mund të njëra nga masat, nuk po them që kjo i ndalë njerëzit të mos dalin jashtë, absolutisht, jo. Kjo mund të jetë njëra nga masat që njerëzit mund të bëjnë një zgjidhje të përkohshme të tyre, derisa eventualisht vjen ndonjë masë tjetër e Qeverisë, të cilën unë akoma s'po e shoh.

Nëse kemi rritje enorme të çmimeve të produkteve bazike, s'kemi fare prekje të pagave, as rritje të tyre, përkundrazi, po mendojmë ndoshta edhe kjo mundësi është si një mundësi e mirë për t'i ndihmuar njerëzit për ta bërë një zgjidhje. Unë mendoj që kjo temë nuk duhet të na dallojë për mënyrën se si po flasim. Ne mund të themi që kjo masë nuk është mirë, më mirë është diçka tjetër, por të mos të ndahemi të provojmë që të ndahemi në formën e tillë për të thënë që, jo ju jeni popullistë, jo këtë jo këtë. Nuk është kjo qasje.

Ne jemi parti e djathtë LDK-ja. Kemi më së shumti ekonomistë se secila parti politike në Kosovë. Kemi marrë vlerësimet e tyre profesionale për këtë fushë. E dimë që nuk është zgjidhja më e mirë kjo. E kemi analizuar dhe kemi ardhur në përfundime. Nuk është zgjidhja më e mirë kjo, por duket që është e vetmja, sepse masat që ju i keni marrë deri tash, po del që nuk kanë dhënë rezultatin e duhur.

Unë në një seancë tjetër do t'jua sjell edhe listën e kompanive, sepse ju në një kohë neve na thoshit, si ka mundësi ju ta subvenciononi Viva-fresh-in, si ka mundësi Elkos-in, si ka mundësi, çfarë keni kështu kur ata kanë fituar. Do t'jua sjell listën e kompanive në Kosovë që kanë

përfituar si rezultat i subvencionimit tuaj në energji, me emër me mbiemër, të gjitha këto që i thasë janë aty rend, prej të parës deri te e fundit. Ato janë tonat, por çfarë po dua t'ju them, mosni me këtë qasje, mosni me këtë frymë të diskutimeve, sepse po dilni sikur jeni parti kundër këtij populli.

Nëse dje e keni votuar, merreni me mend çka keni rrëzuar dje, ministër! Një projektligj që ua njeh stazhin e punës njerëzve që kanë punuar në vitet '90-'99. Një projektligj i cili e heq atë kufizimin 15-vjeçar. Domethënë, cili është mesazhi që ne si politikë, ju tash po ia qitni vulën, por kjo ka ndodhur që 20 vjet në Kosovë.

Në Qeverinë tonë e kemi sjellë në Kuvend, po u rrëzuar për ta hequr këtë, nuk arritëm. Por, duhet thënë që 20 vjet, po, po që 20 vjet kjo ka ndodhur, përfshirë edhe juve tash që po ia jepni vulën kësaj. Çka po u thoni njerëzve, më mirë të punonit në regjimin e Milosheviqit dhe ne do t'ju vlerësonim sot, se keni bërë keq pse e keni lëshuar punën në atë kohë.

Njeriu që është sot kryetar gjykata po del në pension po e merr pensionin 100 euro. Po e marr shembullin në Prizren është rasti konkret, prej 1 mijë e kusur euro rrogë 2 mijë euro, del në pension sepse 1 ditë 2 ditë nuk arrin ta plotësojë 15 vjeteshin stazhin e punës, dhe ju dje e rrëzuar. Ju dje e rrëzuar atë, sot doni ta rrëzoni edhe idenë që njerëzit t'i marrin disa para të tyre nga Trusti. Qeveri e kujt jeni? Qeveri për kë jeni? Kundër popullit?! Kundër këtij vendi?!

Prandaj, po them as s'e kisha idenë të flas, por duke e parë qasjen tuaj, duke e parë përkushtimin tuaj me sa zell dilni kundër ideve të tilla për mbështetje të njerëzve, të më besoni që po më ngjallni, jo shqetësim, por nga njëherë frikë për të thënë, nga na erdhën këta njerëz në krye të kësaj Qeverie dhe për të udhëhequr me këtë vend.

Mund të themi s'po pajtohemi me këtë politikë, e ndërrojmë. OK! E kemi një plan tjetër rezervë, të nderuar kolegë deputetë, të nderuara parti politike opozitare, të nderuar njerëz që keni dalë dhe i keni dhënë këto nënshkrime, por të fyeni e të dilni herë në Shkup e herë në Shkodër me biseda, unë mendoj që po i fyeni njerëzit dhe po e mbytni, vërtet po e mbytni shpresën që ka shpresë në këtë vend, dhe njerëzit normalisht që më pas të vetmin projektion e kanë, edhe ata të cilët janë të kualifikuar, qysh t'i mbledhin valixhet dhe ta marrin një vizë diku e të ikin nga Kosova. Të ikin prej politikës, prej njerëzve që sot i udhëheqin, por edhe atyre që i kanë udhëhequr deri dje, sepse nuk mund të themi se ka vlerësime maksimale.

Megjithatë, po themi është koha kur ne duhet të ndërrojmë qasje dhe të kemi kujdes të tregojmë bashkë si politikë, kujdes për njerëzit që jetojnë në Kosovë.

Unë jam i sigurt që 90% e deputetëve këtu, nesër janë në gjendje t'i nxjerrin ato para të Trustit edhe pse kemi paga të mira krejt kemi nevojë e lerë më ata të cilët kanë 200-300 euro rrogë dhe kanë para minimum të kursyera aty.

Mendoj që duhet të kemi një qasje pak më pragmatike dhe më të përgjegjshme karshi njerëzve dhe popullit tonë që jeton këtu. Faleminderit!

KRYETARI: Ministri dëshiron që ta marrë fjalën. Urdhëro, ministër!

MINISTRI HEKURAN MURATI: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Vetëm një çështje, po besoj, ka nevojë të ritheksohet. Është thënë tashmë disa herë, sa herë që është sjellë kjo temë që nga viti 2020 e deri tash, që një nismë e tillë nuk i ndihmon ata që kanë nevojë, i nderuar deputet. Pra, këtë e dini edhe ju.

Ata që kanë më së shumti nevojë nuk kanë mjete të kursyera në Trust. Këtë e kanë dëshmuar edhe ata që i kanë tërhequr mjetet në të kaluarën. E ka thënë disa herë edhe Trusti. Pra, nga statistikat që i dorëzojnë për shumatat ose si është shpërndarja e shumave që dikush i ka të kursyera në Trust. Si duhet të ndihmohen qytetarët, është përmes masave që ne i kemi ndërmarrë, disa kanë qenë vendime qeveritare, disa duhet të miratohet edhe në Kuvend. Për ato që është dashur të miratohen në Kuvend, fatkeqësisht, ose nuk i keni votuar ose i keni votuar kundër ose i keni çuar në Gjykatë Kushtetuese.

Për shembull, një masë që do t'i ndihmonte qytetarë që çmimin e vajit të blihet më litër, 1 litër vaj, kur litra e vajit po importohet me çmim 1 euro e 20 centë në kufi, do të ishte Ligji për çmimet tavan. Pra, do të vendosje një çmim tavan që litra e vajit të mos kushtonte 2.99 euro centë siç po abuzojnë tregtarët. Por ju, madje më duket ju personalisht e keni dërguar në Gjykatë Kushtetuese këtë ligj. Pse? Sipas jush po ndërhyhet në punën e super-marketeve, e për qytetarët pse e paguajnë 2.99 euro centë 1 litër vaj nuk është edhe aq problem.

Kjo është kjo diskrepanca që qytetarët e shohin çdo ditë. Kur ju thirreni në emër të tyre se gjoja po doni t'i ndihmonin, e në anën tjetër veprimet që i keni nuk përkojnë me mbështetjen për qytetarët. Faleminderit!

KRYETARI: Kundër-replikë, Driton Selmanaj.

DRITON SELMANAJ: Faleminderit, kryetar!

Unë po provoj që diskutimin ta vendos në normalitet. Tashti edukatën e kam të vështirë t'ia transmetoj dikujt dhe t'ia transferoj, por unë po kërkoj së paku mirëkuptim në qasje bre.

Ju nuk mund të më thoni mua se çka di unë. Atë e di unë, zoti ministër. Sikur s'mund t'ju them unë juve çka dini ju. Aq sa dini është çështje juaja, është çështje e përgatitjes suaj, shkollimit tuaj. Çka dini unë, e di unë për vete, dhe kjo nuk është qasje.

E dyta, s'po dua të flas për çështjen tjetër, sepse po e shoh se për çdo gjë ti ke qejf ta zhvendosësh temën. Nuk e kemi çuar atë ligj në Gjykatën Kushtetuese për t'i mbrojtur super-marketet, por t'i mbrojtur mini-marketet. Dyqanet e vogla ju me këtë qasje keni dashur t'i mbyllini me mijëra-mijëra biznese të vogla në Kosovë keni dashur t'i mbyllni, dhe ne e kemi çuar që të ndalet kjo mbyllje.

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Jo, nuk ka replika, Besnik, në kundër-replikë. Kur të vjen rendi e merrni fjalën. A jeni ju zonja Bytyqi? Urdhëro! Po lirisht. Urdhëroni!

ALBANA BYTYQI: Faleminderit, kryetar!

Të dashur qytetarë të Kosovës,

Të nderuar kolegë deputetë,

Sot, ndër të tjera, po flasim përsëri për Trustin, veç kësaj here nuk po flet vetëm opozita, por vet ata që ju votuan. Pra, qytetarët.

Kosova si asnjëherë më parë po përjeton krizë ekonomike, ngritje çmimesh, inflacion. Pra, një gjendje të rëndë për të gjithë ne, e veçanërisht për qytetarët e këtij vendi. Qeveria juaj e përgjumur siç ka qenë qysh nga fillimi, shikon edhe vetëm godet 20-vjeçarit e fundit duke tentuar që tërë padijeninë tuaj, ta hedh tek të tjerët si një faj i kamufluar me propagandë videosh që nuk janë më shumë se dizajnim i egos suaj të tmerrshme për pushtet medial.

Por, derisa ju po ushqeheni me këtë gjë, qytetarët janë lodhur nga rrugët e gjata tuajat drejt dështimit. Ata kanë nevojë për vende pune, rroga më të larta dhe siguri. Pra, gjëra që ju teorikisht i keni mjaft të orkestruara, por praktikisht u ka rënë diçka në sy.

Trusti, paratë e qytetarëve që u kanë votuar, për të satën herë po vjen te ju si kërkesë. Vërtet aq shumë herë sa që as nuk mbahen mend numri, por sot ajo që duhet të mbahet mend është numri i qytetarëve që kanë nënshkruar peticionin me kërkesë për tërheqjen e Trustit. Kur ishte kërkesë e opozitës nuk e votuar pasi mbaheshit mbi fjalën, vetëm për interesat tuaja, por tani është interes të qytetarëve, cila do të jetë përgjigjja juaj?

E vetmja përgjigje në këtë mes qëndron mbi faktin se ju nuk keni qenë të zotë të krijoni asnjë mundësi të re për qytetarët e këtij vendi që dita e ditës kanë para që janë zhvlerësuar përgjysmë

në duart e tyre. Nuk ishit të aftë të krijonit ekonomi të mirëfilltë dhe vende të reja pune. Të sillni investitorë të rinj, përkundrazi, i humbëm shumë nga ta.

Nuk ishit të dijshtëm aq sa për të krijuar stabilitet ekonomik, vetëm me tendencë për të krijuar një shtet social, u bë një shtet më social. Dhe, ata që punojnë tani kërkojnë social, sepse rroga e tyre është përgjysmuar nga çmimet e larta. E duke e ditur tërë këtë faj dhe padijeni tuajën në udhëheqjen jo të duhur të shtetit, duhet të jeni më vigjilentë për të dalë nga kjo krizë dhe t'i ndihmoni qytetarët. Në fakt, sa ndihmë nuk mund të quhet direkt pasi që ata do t'i marrin paratë e tyre, e jo tuajat. Andaj, edhe është cinike ta bëni një gjë të tillë dhe të mos bëni një votim të tillë.

Ne si Aleancë gjithmonë kemi qëndruar në krah të qytetarëve të këtij vendi. Jemi bërë aleatë në luftën e tyre për një situatë më të mirë në këtë vend. Ne e dimë për ju, rrogat tuaja në postet që i keni nuk është e vështirë jeta me këto çmime, por për ata që vërtet jetojnë me rrogat mesatare në këtë vend kjo është e papërbalueshme.

Andaj, ju bëj thirrje të gjithë kolegëve deputetë që ta votojnë këtë kërkesë nga mijëra qytetarë që ju kanë votuar dhe t'ua dëgjojnë zërin e tyre, pasi që do të ishte shumë e padrejtë t'ua kthejmë shpinën në këto ditë të vështira. Faleminderit!

KRYETARI: Tash ia japim fjalën deputetes Eliza Hoxha.

ELIZA HOXHA: Faleminderit, i nderuar kryetar!

U tha shumëçka për arsyen dhe nevojën që qytetarët e Kosovës janë mbledhur dhe në masë të madhe kanë nënshkruar zyrtarisht, duke e deponuar si petition nevojën e tyre për mundësinë për t'i tërhequr mjetet e tyre.

Nëse 21 398 qytetarë janë për ministrin 'gjoja se', mendoj që kjo është qasja më e gabuar që cilido qeveritar ose aktor politik mund ta ketë një pozicion publik.

Ne këtu jemi falë këtyre, jemi zëri i tyre dhe duhet t'i shtyjme përpara nevojat dhe kërkesat e tyre, si e para.

Nuk dua të diskutoj as për nevojën imediate për një mirëqenie më të mirë në një krizë ekonomike dhe inflacion të theksuar në Kosovë, për rritje jo të dyfishta, po të shumëfishta të çmimeve të produkteve bazë, për masat periferike të kësaj Qeverie, e cila pak e aspak i ka ndihmuar qytetarët e Kosovës, por për pagat e njëjta që nuk kanë lëvizur në një inflacion të madh çfarë po përjetojnë sidomos vitin e fundit.

Dua të qëndroj tek argumenti juridik. Trusti është fond i mirëbesimit, nuk është fond shtetëror pensional, ky është argumenti i parë dhe i fundit për të cilin duhet të diskutojmë ne sot këtu.

Paratë në Trust janë para të cilat qytetari i Kosovës ia ka besuar një grupi të caktuar t'i menaxhojë dhe është antikushtetuese çfarëdo diskutimi që sot e dëgjojmë këtu e që mundohet t'i përcaktojë se çfarë duhet të bëjë qytetari i Kosovës me paratë e veta, është antikushtetuese ta detyrosh t'i mbajmë paratë e dikujt me forcë, sidomos kur shteti nuk garanton dhe nuk merr përgjegjësi nëse ato para humbën diku në treg. Pse po e them këtë? Sepse Trusti e ka mbyllur vitin kalendarik me mbi 120 milionë humbje, ato janë pikërisht paratë e këtyre qytetarëve të Kosovës për të cilat shteti i Kosovës nuk merr kurrfarë përgjegjësie e as nuk jep kurrfarë garancie për to.

Prandaj, të thuash se si qytetari duhet t'i harxhojë paratë e veta apo e guxon t'i marrë ato apo edhe t'i diktosh se për çfarë arsye duhet t'i marrë ato, është diçka që nuk qëndron, prandaj ky debat i sotëm, ashtu si edhe debatet e kaluara për Trustin kur ne kemi propozuar si grup parlamentar këtë iniciativë ligjore, duhet të jetë momenti kritik për ta kuptuar se sa e rëndësishme është reforma pensionale në Kosovë, në një ligj i cili fondin pensional të vërtetë e bie në shprehje.

Sot ka diskutime të shumta në botë, shtetet që frikësohen edhe ato që kanë fonde të pensionale apo fonde të sigurimit social të garantuar nga shteti, mendojnë që deri në 2025 shumica e tyre do të dobësohen ose edhe mund të humbasin. Çka ndodh me ne, çka ndodh me ne për paratë për të cilat nuk garanton shteti?

Me kushtetutë është në vullnetin e njerëzve të Kosovës që nëse secili nga ne ka një nevojë të caktuar t'i marrë paratë e veta, shteti nuk mund t'ia ndalon atë, sepse paratë janë të tyre dhe qytetarët mund të bëjnë çfarë të duan me to.

Nuk mund të funksionojmë me logjikën se “unë e di më mirë se a të duhen ty paratë dhe pse duhet t'i shpenzosh t'i paratë e tua apo a guxon t'i marrësh t'i paratë e tua”.

Argumenti kushtetues qëndron në anën e qytetarëve, këto janë para të cilat janë dhënë në mirëbesim të një fondi për një moshë të shtyrë, e që mendoj se është mirë, po që nëse të njëjtën kohë argumenti juridik prapë është në anën e qytetarëve.

Ato para janë të qytetarëve të Kosovës dhe është e drejtë e tyre të kërkojnë që t'i kenë në këtë kohë të vështirë dhe në nevojën në të cilën gjenden. Faleminderit!

KRYETARI: Ia japim fjalën deputetit Dimal Basha.

DIMAL BASHA: Faleminderit, kryetar i Kuvendit!

Po besoj u debatua shumë këtu dhe po besoj është hera e tretë e katërt që diskutojmë në këtë Kuvend. Përfundimisht si deputet gjithë kemi mendime të ndryshme, mirëpo kur të vjen puna te Trusti, u tha këtu që janë para të qytetarëve, po janë edhe para të punëdhënësve që i kanë dhënë, e që janë të garantuara për një pleqëri me një mirëqenie pak më të mirë.

Arsyeja pse unë e kam kundërshtuar është që shkatërrohet apo pritet të kolapsojë një sistem pensional.

LDK-ja pati ardhur fillimisht me një propozim 10%, pastaj PDK-ja me 30, AAK del nesër në fushatë elektorale me 50% dhe përfundojmë me kolaps të një sistemi pensional. Kjo nuk është forma që po besoj ne duhet udhëhequr një shtet, me një formë mendimi se brenda natës i shpërndajmë paratë, përfitojnë qytetarët, ndoshta fitohen edhe disa vota, po kolapson sistemi.

E dyta, pyetja është te qytetarët kush përfiton. Studentët nuk përfitojnë, pensionistët nuk kanë Trust, punëtorët e krahut që kanë nevojë, shtresa me më së shumti nevojë, nuk kanë Trust, qytetarët në skema sociale nuk kanë Trust. Pyetja, kush përfiton? Klasa e lartë që kanë Trust, ata kanë edhe para dhe s'u duhet Trusti për të kolapsuar një sistem për t'i avancuar interesat e veta.

Edhe e dyta shumica e punëtorëve në sektorin publik që kanë kontribuar në Trust pjesën më të madhe të jetës së tyre. A kanë nevojë, ka prej tyre që ka nevojë, mund të pajtohem. Mirëpo, prapë po them, nuk shkatërrohet Trusti për këtë shtresë që megjithatë kanë paga të rregullta mujore. E për më tepër, sektori publik edhe gjatë COVID-it, kur sektori privat ka qenë komplet i mbyllur e njerëzit s'kanë punuar, edhe kanë pasur shumë nevojë, sektori publik megjithatë nuk iu ka ndalur paga asnjëherë, po nuk besoj që shtresa që ka nevojë më së shumti.

Dhe aso kohe kur ka qenë kriza më e madhe, pra ku sektori privat ka qenë shumë në nevojë e s'ka pas asnjë cent, LDK-ja që sot kërkon t'i ndihmojë, i ka ndihmuar supermarketet, të vetmit objekte afariste, të vetmit afaristë që kanë operuar në atë kohë kanë qenë supermarketet, këta kanë vendosur t'i ndihmojnë ata që kanë fituar më së shumti. Kur krejt bizneset kanë qenë mbyllur, ata kanë përfituar, ndihma ka qenë për supermarkete.

Po s'po besoj që ka kredibilitet moral të flitet sot për ata që kanë nevojë, për shkak se Trusti nuk i ndihmon ata.

Atëherë, meqenëse po thirremi në krizë, duhet folur se kë dhe çka duhet ndihmuar. Për ato shtresa që kanë nevojë, kjo Qeveri ka bërë politika të mjaftueshme, po duhet përsëritur, për shkak se po harrohen dhe s'po thuhet qëllimisht nga opozita.

Pensionistët kanë pasur pensionin 90 euro, është bërë 100 euro, për 11% rritje, a është shumë, jo, po megjithatë është rritur për 11%. Për më tepër tri herë kanë marrë nga 100 euro.

Fëmijët, 300 mijë fëmijë sot në Kosovë marrin një shtesë që diku janë 40 milionë euro që shpërndahen nëpër familje në vit. Domethënë iu shkon, po, deputetë, 10 euro, po ju s'ua keni dhënë as ato 10. Ne kur të kemi më shumë, do t'ua kthejmë atyre, por jo supermarketeve. 40 milionë tash shkojnë as te Bechtel&Enka, as në supermarkete, po shkojnë nëpër familje të qytetarëve. Njëjtë vlen për lehonat. Studentët, ata kanë nevojë, atyre u kemi dhënë dy herë nga 100 euro, për më tepër është kjo Qeveri që e ka bërë shkollimin falas në sektorin publik, kjo është për t'i ndihmuar ata që kanë nevojë.

Masa ka pasur për punësimin e vajzave dhe grave, ka pasur masa për subvencionimin e kredive të bizneseve që kanë rritur kapacitetet e prodhimit. Kjo është të ndihmohen bizneset dhe rrjedhimisht sot kemi rritje të eksporteve.

100 milionë euro janë ndarë për rrymë, ku jemi vendi i vetëm në vend që nuk është rritur çmimi i rrymës, për shkak të subvencionimit të Qeverisë. Kjo Qeveri ka bërë subvencionime për pajisje eficiente, 10 mijë familje kanë përfituar, ata qytetarë e dinë. Kjo Qeveri ka bërë kompensim për ata qytetarë që kursejnë rrymën, është një masë që kanë filluar ta kopjojnë edhe vendet e tjera. Bujqit kanë përfituar gati 100 milionë euro, ka qenë 30 milionë euro, 15 milionë euro kanë shkuar për hajni, 15 milionë euro për bujq përpara, për atë sot e kemi gjysmën e Ministrisë së Bujqësisë në burg, sot është rritur gati në 100 milionë euro dhe do të vazhdojë në vitin 2023.

Tash kthehem te sektori publik që po kërkon t'i ndihmohet dhe që kanë Trust. Të njëjtë, sektori publik ka marrë shtesa. Ju e dini, për muajt shtator, tetor, nëntor dhe dhjetor janë ndarë nga 50 euro për shumicën e sektorit publik, në të njëjtën kohë kanë marrë edhe paga. E tani nuk duhet harruar që është po kjo Qeveri dhe ky Kuvend që e ka kaluar edhe Ligjin e pagave që pret të bëjë harmonizimin, po edhe rritje të pagave. Këtë s'e keni bërë ju kurrë, krejt këto masa që u përmendën, nuk i kanë bërë asnjëherë, prandaj këto janë masat që i ndihmojnë njerëzit që kanë nevojë më së shumti. Jo supermarketet, jo Bechtel&Enkës, këto do t' i përsërisim sa herë të ketë nevojë, për shkak se është me rëndësi dhe qytetarët e dinë se kush është duke i prirë.

Për fund, Trusti nuk shkatërrohet, siç e thashë në fillim, dje LDK-ja i pati dhënë 10% dhe thoshin se është hera e vetme dhe e fundit, pastaj doli PDK-ja me 30%, nesër AAK-ja me 50, edhe brenda 5 vjetësh ta kolapsojnë sistemin, nuk është kjo formë që udhëhiqet shteti.

E dyta, Trusti nuk e ndihmon studentin, as pensionistin, as ata që janë me skemë sociale, pra jo ata që nuk kanë, për ata Qeveria ka krijuar masa të shumta që i prek të gjithë qytetarët e Kosovës, po Trusti nuk është njëra prej formave. Kurse sektori publik është një mundësi, e thashë me shtesa, dhe përfundimisht me Ligjin e pagave do të adresohen disa shqetësime të tyre,

e sigurisht që nëse opozita e ka seriozisht të vazhdojë ndihmën e atyre në nevojë, pra ju kërkohet që nesër ta votoni edhe Ligjin për pagë minimale, ku minimalisht do të përfitojnë edhe 100 mijë qytetarë që marrin në 250 euro. Faleminderit!

KRYETARI: Replika është e Bekim Haxhiut me Dimal Bashën.

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, kryetar!

I nderuar koleg deputet,

Në emër të qytetarëve po të ftoj ta votosh këtë projektligj.

Kryetari i Sindikatës së sektorit privat ka dalë me qëndrim publik për të kërkuar votën e deputetëve për projektligjin. Artistë të shumtë e njerëz të shkencës e të artit e të sportit, ata që janë në marrëdhënie pune dhe ata që s'janë në marrëdhënie pune janë duke e kërkuar mbështetjen dhe votën e deputetëve për këtë iniciativë ligjore.

Familjet kosovare mbështeten nga këto kursime, në ato familje janë edhe studentët, por nëse shteti fokusohet të mbështesë ata që kanë mjete dhe ne deputetët e mbështesim këtë iniciativë të qytetarëve, atëherë Qeveria do të ketë mjete të fokusohet edhe t'i mbështesë të papunët. Po ne s'kemi parë mbështetje për të papunësuarit, nuk ka pasur mbështetje gjatë atyre veprimeve të Qeverisë, lëmoshat që i ka lëshuar gjatë vitit 2022 kanë përfitur më së shumti bankat, me ato 10 euro shtesa të fëmijëve, 1.5 euro deri në 2 euro i marrin bankat e Kosovës. Prandaj, atje është fitimi 190 milionë euro, prandaj, atje rritja e kredive është 1.5 miliardë euro. Vetëm vitin e fundit 1.5 miliardë euro hyrje në borxhe, po kërkohet qytetarët, prandaj të jemi unik në këtë, i nderuar koleg deputet. Kaloje këtë zhargonin e përditshëm politik, dil atje bashkë me Adnanin, me Bilallin dhe me Beratin, bëhu si ata dhe dëgjoj ata, sepse do të shkojmë prapë pas...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Dimal Basha, kundër-replikë!

DIMAL BASHA: Faleminderit, kryetar!

Pra, në fund e tha që prapë do të shkoni të kërkonit votën, që po tregon që kjo masë është populliste, qysh e tha edhe ministri, është duke u bërë për vota, po jo për të mirën e qytetarëve. Pra, jeni mbledhur bashkë LDK, PDK, AAK që po doni ta bëni për vota. Njëkohësisht kjo dëshmon që e kolapson sistemin pensional, s'e keni problem atë, tregoj, studentët, pensionistët, skemat sociale, njerëzit në nevojë nuk kanë Trust, ata s'e kërkojnë, ata që kanë tash me Ligj të pagave dhe me masat shtesë që i kemi bërë dhe i kemi ndihmuar të gjitha familjet. E pyetja është që ata që kanë nevojë më së shumti, nuk e kërkojnë, kurse nëse e keni bërë këtë për vota, jo për parim, flet shumë për juve, e aq më shumë për neve që jemi parimorë, e ju nuk jeni. Faleminderit!

KRYETARI: Vazhdojmë me deputetët, sipas radhës. Fjalën ia japim deputetit Rashit Qalaj.

(Ndërhyrje)

Jo, jo, Dimali foli i fundit nga Vetëvendosja, PDK-ja pas LDK-së dhe me radhë.

RASHIT QALAJ: I nderuar kryetar,

I nderuar Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Të dashur qytetarë,

Ju që me nënshkrimet tuaja kërkuat nga ne që sot të diskutojmë për gjendjen e rëndë tuajin.

Të dashur qytetarë që na detyruat sot të flasim për problemet me të cilat po kaloni ju dhe po kalon e tërë shoqëria kosovare, problemet që e kanë prekur çdo familje, çdo shtresë të shoqërisë.

Ju e dini që kemi nisur vitin e kaluar me një gjendje të rëndë shumë ekonomike, me probleme shumë në sektorin e energjisë, për shkak të ngritjes enorme të çmimit të energjisë, për shkak të ngritjes enorme të çmimeve të konsumit, të artikujve elementarë për qytetarët e Kosovës, atyre artikujve të cilat konsumohen nga çdo qytetar i Kosovës, nga çdo familje e Kosovës dhe artikuj që për ditë e më shumë është vështirë të blihen në masën e nevojshme për familjet dhe nga familjet kosovare.

Të nderuar qytetarë,

Posaçërisht ju qytetarë që me nënshkrimet tuaja, prapë po e përsëris, na detyruat të flasim për gjendjen e rëndë ekonomike të popullit të Kosovës, ju që me të vërtetë po ballafaqoheni me një situatë të rëndë për shkak të gjendjes që na e ka sjellë kjo Qeveri dhe gjendjes që është imponuar edhe nga jashtë, për shkak të krizave që po ndodhin edhe në botë.

Mirëpo, krizat në vendet e tjera u menaxhuan mjaftë mirë, ndërsa kriza në këtë vend po menaxhohet keq, për të mos thënë edhe shumë keq. Nuk duhet shumë komente në lidhje me nevojën e qytetarëve që kanë dhënë nënshkrimet e tyre dhe ne e dimë që tërheqja e parave të tyre nga fondi i mirëbesimit nuk do t'ua ngritë standardin atyre qytetarëve, mirëpo do t'ua zgjidhë një problem, do t'ua zbutë një hall, qoftë të larjes së borxheve, qoftë ndihmës së pagesave për shkollim të fëmijëve apo nevoja të tjera që i kanë, e këto nevoja janë shumë të mëdha.

Ju e dini që e patëm një vit pa investime kapitale, pa para në treg, një vit që qytetarët e vendit nuk e kishin përjetuar kurrë. Kosova ka qenë vend ku është punuar, Kosova ka qenë kantier i ndërtimit të rrugëve të autostradave, ku kanë punuar kompani e nënkompani, kompani të ndryshme private e publike, të cilat kanë përfituar në mënyrë direkte ose indirekte dhe që

qytetarët kanë pasur mundësi të punojnë në këto kompani dhe pastaj këto para t'i shfrytëzojnë në bazë të nevojave të tyre.

Kosova po e përjeton keq lajmin që Trusti Pensional i Kosovës ka humbur 120 milionë gjatë vitit të kaluar dhe kjo është fakt, po ashtu Kosova, populli i saj, po e përjeton mjaft rëndë çështjen e dëmtimit të buxhetit për shkak të inflacionit, parave të cilat nuk kanë hyrë në punë, po parave që nuk janë shpenzuar nga Qeveria për shkak të mospasjes së mundësisë të investimeve kapitale.

Të nderuar deputetë,

Është e vërtetë që tërheqja e parave nga Fondi i Mirëbesimit, nga Trusti i Kosovës, ne e dimë të gjithë që nuk është mirë për sistemin, që nuk është mirë për Trustin, ama që është e nevojshme për qytetarët, besoj që s'ka nevojë për diskutim. Tek e fundit, janë qytetarët që po e kërkojnë dhe ata 21 mijë e sa qytetarë të cilët kanë vënë nënshkrimet, kanë anëtarë të familjes, 2,3,4 e 5 dhe kushdo që thotë se ka njerëz këtu të papunë dhe nuk kanë Trust, është e vërtetë, po ata njerëz të papunë kanë të punësuar në familje, kanë prindërit, kanë vëllezërit, kanë motrat dhe do të përfitojnë edhe indirekt nga tërheqja e shumës së Trustit nga anëtarët e familjes së tyre.

Është e vërtetë që në këtë Parlament nuk kaloi, nuk u votua, nuk erdhi prapë për votim ligji shumë i nevojshëm, ligji i cili i prek sidomos shtresat e varfra, Ligji për pagën minimale dhe kaluan disa muaj që jemi duke pritur që ky ligj të vijë prapë.

Ju e dini që ky ligj nuk kaloi për shkak të shtresës më të ndjeshme të kësaj shoqërie, për shkak të veteranëve, të cilët i do shumë ky ministër.

Pra, po e presim Ligjin për pagë minimale, nuk vjen, e kemi miratuar, në fakt e keni votuar Ligjin për paga, po asnjë njeri në këtë vend nuk e di sa e ka pagën, nuk e di a e di edhe ministri.

Pra, zotëri Demal Basha, bashkëvendës imi, ku është rritja e pagës, kush e di në këtë vend a ka rritje të pagës apo jo, cila shtresë e shoqërisë, cili punonjës, ministër, a e di, a të është rritur paga? S'e di. Pra, nuk e di as ministri, besoj që nuk e di as zëvendëskryeministri.

Prandaj, nuk mund të flasim për rritje të pagave kur vlera monetare e koeficientit mbahet sekret, nuk mund të flasim për ngritje të mirëqenies kur s'e dimë sa i kemi pagat. Dhe është e vërtetë që qytetarët tanë po ikin, po ikin në masë, po ikin të punësuar e të papunësuar dhe po na shkojnë, dhe çka mund të themi, kur nuk dimë asgjë, kur gjëja më elementare vlera e koeficientit bëhet sekret, a thua pse?

Pajtohem me zotin deputet Eman Rrahmani, i cili pati një diskutim për mua mjaft konstruktiv dhe përmbajtësor, për gjetjen e mundësive që ky Trust apo kjo kërkesë e qytetarëve të kalojë për tërheqjen e parave dhe ndoshta kjo do të ishte e mirë në kohën para leximit të dytë. Mirëpo, ajo

që është evidente, është që ne duhet ta mbështesim kërkesën e qytetarëve, të cilët çdo njërin prej nesh, qoftë në rrugë, qoftë në sheshe, qoftë në platforma sociale, qoftë në fshatra e qytete kudo që na takojnë pyetjen e parë e ka: a po na e kaloni Trustin?

Dhe jam i bindur që secili prej nesh, pa përjashtim të partive politike, jemi duke u ballafaquar me këto kërkesa.

Të nderuar qytetarë, që ju po na shikoni sot dhe që po pritni nga ky Kuvend që të kalojë kërkesën tuaj për tërheqjen e parave nga Fondi i Mirëbesimit, e di që me votën tonë sadopak do t'ju ndihmojmë që ju të kaloni së pakut një problem financiar që e keni në familje që t'ua mundëson së pakut ta keni një hall më pak që ne deputetët e këtij Parlamenti e kemi obligim gjithmonë që t'ju mbështesim në çdo situatë, e sidomos kur kemi të bëjmë me situatat e vështira, prandaj edhe unë bëj apel te të gjithë ne këtu, që ta votojmë kërkesën e mbi 20 mijë qytetarëve për tërheqjen e parave nga Trusti.

Dhe po ashtu e kam një kërkesë për ministrin e Punëve të Brendshme, që në seancën e radhës të vijë të na raportojë e të na njoftojë, atë që mund të njoftojë, mbi kërcënimet që i kemi pasur, që kemi dëgjuar, për deputetët e Parlamentit të Kosovës, të cilat kërcënime si duket janë mjaft serioze dhe kemi nevojë si deputetë të marrim informata, po e përsëris, ato që mund të jepen në lidhje me këto kërcënime. Faleminderit!

KRYETARI: Ne i dënojmë ato kërcënime dhe një gjuhë të tillë dhe kërkojmë nga organet e rendit dhe të drejtësisë që t'i hetojnë këto dhe t'i kapin ata që bëjnë veprime të tilla.

Tash po shkojmë në pushim, sepse e kemi lënë një takim të rëndësishëm me shefat e grupeve parlamentare në orën 14:00. Këtë e keni ditur paraprakisht, besoj. Urdhëro, Dimal!

DIMAL BASHA: Faleminderit, kryetar i Kuvendit!

Zoti Qalaj herë thotë i Ferizajt, herë i Lipjanit, është mirë të përcaktohet.

Me rëndësi është se ata që kanë nevojë, pra ata që kanë nevojë asnjë s' doli të thotë që studentëve e pensionistëve u duhet kjo. Tjetra, nëse doni t'i nderoni mësuesit dhe mjekët, do ta shihni me Ligjin e pagave. Për mjekë sigurisht se është problem që marrin 3,5 euro në orë, tash me ligjin e ri do të nderohen, por jo me Trust. Pra Ligji i pagave hyn në fuqi shpejt.

E treta, te BQK-ja ka rëndësi që ka kaluar një rregullore në dhjetor dhe prej muajit gusht për qytetarët e Republikës së Kosovës do të bëhet falas mirëmbajtja e xhirollogarive bankare, diçka që ju s'e keni bërë kurrë. Unë e di që tash janë duke paguar, por ne jemi duke punuar për ta adresuar edhe këtë problem. Dhe e fundit, këtu u përmend që do të vijë edhe Lista serbe për t'ua përkrahur Trustin, edhe po kam qejf të shoh a është koalicioni aq i gjerë sa ka kaluar deri tek Lista serbe dhe sigurisht po mendoj që u shpërfaq ajo që janë duke e bërë për vota, ku edhe vetë

deputeti Qalaj e pranoi që kolapsin sistemi, po duhet bërë se kanë qytetarët nevojë, e ata jemi duke iu ndihmuar ne. Faleminderit!

KRYETARI: Kundër-replikë e zotit Qalaj, një minutë.

RASHIT QALAJ: Zoti deputet Basha,

Fillimisht, nuk është e vërtetë që thashë “kolapson sistemi”, por thashë që nga aspekti ekonomik ne të gjithë e dimë që nuk është mirë për sistemin që të tërhiqen paratë, po të lutem, tipikë e juaja që t’i ndërroni fjalët dhe t’u jepni kuptim tjetër. Prandaj, të lutem mos shpif, po trego atë që është e vërtetë.

KRYETARI: Shkojmë në pushim dhe kthehemi në orën 15:30.

* * *

Vazhdimi i mbledhjes, pas pauzës

Mbledhjen e drejton kryetari i Kuvendit, z. Glauk Konjufca.

KRYETARI: Vazhdojmë me seancën aty ku e lamë. Në rend ishte Besiani, por më duket nuk qenka. Besian, këtu je apo nuk e ke fjalën? Në rregull. Vazhdojmë me Aleancën për Ardhmërinë e Kosovës. Pali s'qenka këtu, kështu që kalojmë te Time Kadrijaj.

TIME KADRIJAJ: Faleminderit, kryetar i Kuvendit!

Të nderuar deputetë,

Të nderuar qytetarë të Kosovës,

Sot qytetarët e Kosovës i kanë të drejtuar sytë dhe vëmendjen nga deputetët, nga mazhoranca dhe opozita, ashtu siç e kishin vëmendjen dje pensionistët kontributdhënës në lidhje me skemat pensionale për heqjen e kushtit për pesëmbëdhjetë vjet, ku fatkeqësisht u zhgënjyen nga votimi i deputetëve në pushtet, sepse tentuam ta zhbënim një padrejtësi që u është bërë gjithë këtyre punëtorëve dhe nuk ia arritëm.

Sot qytetarët i kanë të drejtuar sytë dhe vëmendjen nga deputetët dhe mazhoranca parlamentare, sikurse i kishin të gjithë qytetarët me muaj të tërë për bërjen realitet të Ligjit të pagave, për të cilin pushteti e mban ende sekret në kuptim të koeficientit. Sot qytetarët i kanë sytë dhe shpresën te vendimi dhe vota jonë, se si do të votojmë për Trustin.

Të nderuar kolegë,

Më besoni, që ngado që shkoja dhe kudo që të jem dhe këdo që e kam takuar nga qytetarët gjithandej Kosovës, pyetja që na është parashtruar dhe kërkesa e parë ka të bëjë me çështjen e Trustit dhe rëndësinë jetike që e ka për ta bërë realitet këtë projektligj. Ne duhet ta kuptojmë që tërheqja e Trustit nuk është dëshirë, ne e kuptojmë që nuk është dëshirë, por është nevojë urgjente. Ne duhet ta kuptojmë që tërheqja e Trustit nuk është çështje politike, por është zgjedhje ekonomike. Ne duhet ta kuptojmë që qytetarët kanë rroga të vogla e çmime të larta. Ne duhet ta kuptojmë që jemi betuar si deputetë për t'u shërbyer qytetarëve dhe jo për t'i zhgënjyer ata. Ne duhet të kuptojmë që janë 1001 arsye pse duhet t'ua lejojmë qytetarëve që me ligj të kenë të drejtën të marrin 30% të vlerës së Trustit.

A po arrijmë ne t'i përfaqësojmë denjësisht qytetarët? A po arrijmë që denjësisht t'i prezantojmë dhe të bëhemi zë i tyre për hallet dhe problemet që i kanë?

Kishte qenë mirë që ne të kishim jetuar në një gjendje të mirë ekonomike, kur kemi pasur paga të dinjitetshme, ku kishim pasur pensione të mira, ku asnjë kategori nuk do të kishte nevojë për tërheqjen e 30% të Trustit, por e vërteta është krejt ndryshe, se po jetojmë në një vend ku ka krizë ekonomike, ku ka krizë sociale, ku kemi paga të vogla, ku kemi pensione të ulëta dhe që

është nevojë imediate që t'i përkrahim këto kategori, në mënyrë që të tërheqin 30% të Trustit për një jetë më të mirë dhe për një jetë më të dinjitetshme.

Dua t'jua kujtoj që logoja e Lëvizjes Vetëvendosje për të ardhur në pushtet ishte një zemër e kuqe, ku morët më shumë se 50% të votave të pushtetit, prandaj sot ose kurrë, dëshmojeni atë me zemër, sikurse keni kërkuar vota me zemër, që jeni për qytetarët e Kosovës, që jeni dhe do të shërbeni për interesat e qytetarëve të Kosovës dhe jo për interesa të pushtetit. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka deputeti Vendenis Lahu. Me mikrofon të Vendenisit, Tinka Kurti.

TINKA KURTI: Faleminderit, kryetar!

Fjala ime është kryesisht në një formë replike me një nga pasaktësitë e shumta që u thanë sot. Është fjala për pagesën për xhirologaritë që duhet t'i bëhen bankës. Edhe pse, u përmend shkurt nga kolegu im, dua ta theksoj rëndësinë e Rregullores së re të Bankës Qendrore të miratuar në dhjetorin e fundit. Pra, sipas Rregullores së re të miratuar nga Bordi i ri i Bankës Qendrore, bankat nuk duhet të vendosin pengesa për konsumatorët që duan të përfitojnë nga përparësitë që sjell pjesëmarrja e tyre në tregun financiar.

Edhe kjo mund të bëhej më herët, por nuk ka ndodhur për shkak se me Bankën Qendrore ka udhëhequr PDK-ja dhe LDK-ja, sipas modelit Bedri Hamza, ose modeli tjetër Sokol Havolli. Asnjëri nuk janë brengosur në këtë pikë, ndërsa kjo ka qenë nevojë edhe më herët.

Krejt propozimet për tërheqjen e Trustit dhe kjo bujari, pra, e opozitës sot që kontributet e qytetarëve t'i shkatërrojnë dhe nuk janë për të zgjedhur ndonjë hall, por të zhdukin edhe formën e vetme të ruajtjes së mundit dhe djersës së punëtorëve e profesionistëve.

Qeveria është duke përdorur tashmë dhjetëra modele për ata që janë në nevojë dhe janë në vështirësi e janë duke u ballafaquar me to. Pyetja sot këtu nuk është, se a kemi nevojë për mjete të Trustit, por sa do të kemi nevojë për to kur jemi mbi 65-vjeç? Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka Xhavit Haliti. Xhaviti nuk qenka këtu. Me radhë Isak Shabani pastaj.

ISAK SHABANI: I nderuar kryetar i Kuvendit,

I nderuar ministër,

Të nderuar kolegë deputetë,

Të dashur qytetarë,

Në kohën kur tërheqja e parave nga Fondi i Kursimeve Pensionale në Kosovë përsëri është bërë temë e pashmangshme, ne si përfaqësues të qytetarëve e kemi obligim që edhe një herë t'u dalim në përkrahje atyre, apo më mirë të themi, të përcjellim mesazhin e tyre në këtë Kuvend.

Ideja për tërheqjen e parave nga Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës nuk ka rrjedhur nga ne si parti, as nuk ka qëllime politike, as nuk është mjet luftimi i Qeverisë. Ne veç po përcjellim një amanet të qytetarit, të nënshkruar nga mbi 21 mijë qytetarë.

Në këtë krizë të rëndë që ka kapluar Kosovën qytetarët kërkojnë që me mjetet e tyre të kursyera nga puna dhe djersa e tyre që t'u lejohet të përdorin nga ana e tyre për t'i përmbushur nevojat elementare në këto ditë të vështira për të gjithë ne. Votimi i këtij ligji për qëllim të parë ka të ndihmojë qytetarin e Kosovës, i cili në këtë periudhë dimri po përballet me mungesa shumë të mëdha të gjërave elementare jetësore. Kjo kërkesë thjesht buron nga qytetari, i cili ka një kohë që po përballet me krizën ekonomike më të madhe që nga përfundimi i luftës e këndej, e që manifestohet kryesisht me rritjen apokaliptike të çmimeve të të gjitha produkteve të konsumit të gjerë të domosdoshëm për jetën e përditshme.

Në këtë krizë që ka ardhur për disa arsye, fatkeqësisht Qeveria e Kosovës duke mos vepruar, apo duke vepruar në mënyrë retroaktive, vetëm sa e ka rënduar situatën. Qeveria, përkundër disa përpjekjeve ad hoc dhe jo mirë të planifikuara në lidhje me mbështetjen e qytetarëve përmes të ashtuquajturave 'pako ekonomike', jo mirë të konsultuara nga ana e ekspertëve, nuk ka ndërmarrë hapa të mirëfilltë dhe të qëndrueshëm ekonomikë në lidhje me zbutjen e gjendjes së rëndës sociale dhe ekonomike, që mbretëron në Kosovë si mënyrë për t'iu kundërvënë kësaj krize.

E kuptojmë qëllimin e Fondit të Kursimeve, por ne po flasim për një gjendje jo të zakonshme. Nuk e kuptoj pse Qeveria e Kosovës sot insiston aq shumë për ruajtjen e parave të kursyera nga ana e qytetarëve në Fondin e Kursimeve Pensionale të Kosovës, kur u takojnë vetë atyre dhe ata vetë po i kërkojnë për të tejkaluar sado pak më lehtë krizën në të cilën gjenden një shoqëri për shkak të shtrenjtimit të mëdha. Nëse pozita po "merakoset" aq shumë për kursime të qytetarëve dhe për jetë më të mirë të tyre pas pensionimit, pse gjatë gjithë këtij inflacioni, avarie që po ndodh në jetën tonë sot, pas gjithë këtyre shtrenjtimit nuk ka ndërmarrë asnjë hap të dukshëm për lehtësimin sado pak të vuajtjes ekonomike, që ka kapluar familjet kosovare, pothuajse të të gjitha shtresave, ndërsa pagat mbeten të njëjta, akcizat dhe tatimet gjithashtu.

Në fund të fundit, askush nuk do të pranonte të shpenzonte kursimet e Trustit nëse nuk do të kishte nevojë, apo në rast se Qeveria do të dilte në mbrojtje në çfarëdo mënyre që të lehtësonte jetesën e tyre.

Konsideroj e ky Kuvend punën më të ndershme që mund të bëjë sot është të votojë këtë ligj. Thjesht, ky Kuvend duhet të lejohet qasje në paratë e kursyera nga ana e qytetarëve, sepse nevoja është e madhe për mbulimin e shpenzimeve bazike mujore.

Më parë ka pasur deklarata, qasje qesharake, nga disa funksionarë në lidhje me shpenzimet e këtyre parave, parafrazoj: “Njerëzve po u ngutet të shkojnë në det, apo t’i shpenzojnë atë mjete për qejfi”. Nuk do të befasohet fare nëse sot apo nesër i dëgjojmë të njëjtin duke deklaruar se pas tërheqjes së një pjese të Trustit do të shkojnë në bjeshkë në ski, sepse të tillët nisen nga vetja. Thotë një thënie popullore se “i ngopuri nuk ia beson të uriturit”.

Askush normalisht, që përballet me mungesa të mëdha, nuk do të bëjë qejf, sepse duket qartë se sot nuk është kohë qejfi, por është kohë mbijetese. Qytetari po përballet çdo ditë me brenga se a do t’ia dalë të sigurojë, apo të mbulojë harxhimet mujore, të paguajë faturat super të shtrenjta të rrymës, barnave të shumta, apo a do të mund të sigurojë kafshatën e gojës për vete dhe fëmijët e tyre. Sipas mendimit tim, sot Kosova ka një qeveri apatike, e cila qeveris me përralla dhe utopi, pa më të voglën ide se si të ecet përpara, me një qeveri që qytetarëve nuk po u jep aspak shpresë për një perspektivë.

Kemi inflacion të madh, nuk kemi rritje të pagave dhe pensioneve, nuk kemi sigurime shëndetësore, kurse ajo më shqetësuese është ikja e qytetarëve e të rinjve nga Kosova, sa që as në kohën e Milosheviqit nuk ka pasur kërkesa më shumë për të ikur nga Kosova.

Andaj, me aprovimin e këtij ligji në këtë periudhë të rëndë ekonomike Kuvendi kryen vetëm një obligim për qytetarët, duke plotësuar kërkesën e tyre, duke u bazuar në Ligjin për tërheqjen e një pjese të parave nga Trusti i tyre.

Të nderuar kolegë,

Si përfaqësues i popullit duhet me çdo kusht të jemi të ndershëm dhe t’u përgjigjemi pozitivisht kërkesave të mijëra qytetarëve, siç është rasti i kërkesës për paratë e Trustit dhe të tregojmë se qytetari dhe kërkesa e tij është mbi çdo interes grupor, partiak, apo tjetër. Andaj, ju ftoj të votoni këtë projektligj, me të cilën gjë i plotësoni kërkesat e qytetarëve.

Po shfrytëzoj rastin të përmend kolegun deputetin Eman Rrahmani, i cili kërkoi që të shqyrtohet mundësia t’u lejohet, sidomos atyre që janë të sëmurë, që t’i tërheqin këto mjete. Besoj që edhe me këtë projektligj kanë mundësi ata t’i tërheqin, kurse ata që nuk kanë nevojë t’i tërheqin, munden edhe të mos i tërheqin. E dimë që sigurime shëndetësore sot nuk ka, prandaj do të ishte mirë që t’u ofrohet kjo zgjidhje qytetarëve për të përzgjedhur vetë. Faleminderit!

KRYETARI. Fjalën ia japim deputetit Mefail Bajqinovci. Kush e ka kërkuar? OK, deputeti Avni Dehari.

AVNI DEHARI: Qytetarë të nderuar,

Jeni në një kohë të madhe krize. Keni shumë nevojë për këto të holla të Trustit. Kurrë nuk keni pasur nevojë se sa keni tash. Se sa jua zgjidhin krizën nuk e di, mirëpo një gjë mund t’ju siguroj.

Kur t'i bëni 65 vjet, atëherë nuk do të keni nevojë për këto të holla, se ju mjaftojnë vitet e pleqërisë.

KRYETARI: Ardian Kastrati e ka fjalën.

ARDIAN KASTRATI: Të nderuar qytetarë,

I nderuar kryetar,

Deputetë,

Unë prita sot që sinqerisht këto diskutime t'i bëjmë në një frymë tjetër, jashtë këtij petkut partiak, me të cilin jemi mbuluar të gjithë, por në fakt debati rrëshqiti prapë në ato retorika boshe, në këto akuza e kundërakuza, me argumente e pa argumente. Ideja është që mund ta spostojmë gjithmonë në rrafsh më konstruktiv, siç ishte rasti, për shembull, me një nga deputetët e juaj, zotin Rrahmani. Por, si të doni ju. Mund të vazhdoni me këto statistikat boshe, statistikat manipuluese, që i thotë ky djaloshi. Por, në fakt, një jam i sigurt, që ju keni ndjesi për këtë punë dhe t'u thuhet ta hapni telefonin secili dhe ta bëni transparent para kamerave, jam i bindur që aty ka teze, dajë, axha e nipa, a po votohet sot, a po votohet sot, duke ju pyetur.

Po, pse s'e votoni? Do të thotë, ju keni besim në këtë iniciativë, jo politike, po për nevoja të qytetarit, po në fakt, veproni ndryshe. Veproni ndryshe sepse jeni të burgosur prej Albinit. Dëgjoni, individi është vlera themelore e çdo shoqërie moderne dhe kjo nuk do të thotë se këtu s'ka demokraci. Këtu ka demokraci brenda jush, sepse ju jeni duke votuar, jeni përfaqësues të qytetarëve, po kjo është demokraci pa individë. Ju në fakt nuk lejoheni ta thoni mendimin e juaj të lirë lidhur me çështjen të cilën sot po diskutohet. A e dini pse? Sepse marrëdhënia juaj me Albinin është sikurse ajo e foshnjës në barkun e nënës e cila nuk mund ta shkëpusë kordonin nga kërthiza, sepse është e varur prej saj.

Kur e thashë të burgosur, ndoshta më mirë të thuhet që jeni të vetëburgosur, e jo ai burgu me ato prangat që vringëllijnë, sepse aty është mirë të jesh në qeli, e ke një dënim e mban pesë-gjashtë vjen dhe del, po ky është ai burgu i madh që jua ka vendosur ky e nuk mund të dilni. Edhe prej aty dilni veç ju nëse doni vetë me vullnetin e juaj, në emër të këtij interesi ose të kësaj nevoje të qytetarëve. Sa më shumë që i nënshtroheni, kjo i shkon për shtat këtij karakteri autoritarist të Kurtit, i cili ka qejf të nënshtrojë sa më shumë, të jetë nënshttrimi sa më gjithëpërfshirës dhe sa më absolut.

Tash arsyen e gjeni secili mes jush, a e keni nga frika nga ekzistenca nuk e di. Ndoshta dikush ka menduar që do të përfundojë këtu edhe në pleqëri si deputet, ndoshta dikush nuk ka punë, se dëgjova që disa prej jush e keni punë të parë deputetin. Këtë duhet ta diskutoni ju. Ideja është sot themelore që askush nuk po ju kërkon juve të jeni tjetërkush, të tjetërsohet, po të jetë vetvetja në kuptimin e individit të lirë.

Pra, ju vetë të vendosni sot në raport me çështjen që po diskutohet dhe që është nevojë imediate e qytetarëve. Nuk po guxonim prej Albinit, pra e hidhni inatin përpara arsyes dhe jo arsyen para inatit. Pas kësaj futeni në këto statistikat monotone të cilat tashmë askush s'i beson e madje futeni edhe në mbrojtje të këtyre mega-afereve këtu e pastaj ju dalin lakrat në shesh. A është Albini Albin, a Albini Martin, a Martini Albin në kuptimin e mega-afereve së hajnisë që raportojnë gazetatat sllovene. Tash të jetë ai Albini që premtonte se s'do të ketë kurrë korrupsion, s'është Ablini Albin, po tash Albini është Martin, sepse s'po guxon të flasë ato që i ka dhënë gazetatat sllovene. E Martini është Albini gjithsesi se atij i konvenon të mos flasë. Po si Albini Martin, si Martini Albin, të dy dalin që të janë të përfshirë sipas supozimit të gazetës sllovene në këtë megahajni të madhe rajonale. Kjo nuk e justifikon çështjen për të cilën flisni.

Pastaj këtu trumbetoni jo qeverisje, sytë janë për të parë, është duke u gërryer sovraniteti përbrenda, e keni falur veriun për shkak të politikave banditeske, diletante dhe amatoreske. Në subjektivitetin ndërkombëtar, Kosova më nuk ekziston, çnjohjet janë duke u renditur atje, ju s'keni kurrfarë reagimi, kurse ka aktakuza për Gërvalla, për Liza Gashi e kush janë këta për korrupsion për mosdeklarim të pasurisë. Po keni bërë punë, po edhe e keni bërë atë urën tri metra që po t'ia mësyjë unë me tre djemtë e mi për dy javë edhe atë e kisha mbaruar.

Taksat ua ka ënda t'ua merrni qytetarëve, keni vjedhur naftë disa prej juve këtu. Ka që jeton në rrugën B e që e keni paraqitur që jetoni në Prizren ose Mitrovicë. Kurse kur vjen puna t'ia lejoni qytetarit t'i marrë paratë e veta, ju kështu në mënyrë arbitrare thoni që nuk bën. Kjo është njëfarë lloj situatë sikur në trafik, por pa rregulla, sepse ta zëmë se ju jeni makina dhe qytetari që po kërkon Trustin është këmbësori dhe ai ka përparësi në kalim e ju doni ta shkelni me makinë ta gjuani krejt në tokë.

Dëgjoni, ne të gjithë këtu në sallë e dimë që kjo bota ku jeton ka shumë mëkatarë, ka edhe njerëz të mirë, po të mos kishte mëkatarë, s'kishte pasur nevojë të ketë as kisha as xhami. Me një votë për Trustin, ne mund ta shndërrojmë këtë Kuvend në një shtëpi shprese për qytetarin, sepse ne krejt jemi të vetëdijshëm çfarë krize po kalon ai sot dhe jo më kot secili ju pyet a po bëhet Trusti, apo jo. Po me një vendim çfarë ju po e proklamoni për të mos e votuar Trustin, besomëni që ato mëkate do të mbeten të pashlyeshme në raport me qytetarin dhe do të jetë pak problem të dilet në shesh dhe të ecni disa prej jush.

Sot, prandaj unë thërras në ndërgjegjen e juaj. Jashtë politikës, jashtë petkut të partive politike, që në emër të edukatores, në emër të mësueses... Qesh ti qesh! ...të cilës ia dorëzoni fëmijës çdo mëngjes, dhe e cila jua pret me buzëqeshje, votojani Trustin, sepse ajo ka probleme, ajo ka kredi. Në emër të atij policit që e keni dërguar në veri, votojani Trustin. Në emër të ushtarit të FSK-së, në emër të administratës komplet publike, në emër të këtij sektori privat, në emër të taksistit që ju ka sjellë deri këtu, në emër të asaj frizeres që ta ka bërë frizurën që po qesh ti sot, në emër të kamerierit që ju ka shërbyer kafet sot, votojani Trustin, se kjo nuk është kalkulim politik. Kjo

është thjeshtë pra për interes të qytetarit. Mos harroni, kështu si jeni, po veproni si tufa, dhe jo si individë. Nuk keni as doktrinë të partisë. Ky Albini juaj ju ka ndërtuar veç një klima të të menduarit dhe klima e të menduarit të juaj është kështu që qeshni dhe veç ta gjuani kundërshtarin politik, duke e hedhur në rend të dytë interesin e qytetarit që definitivisht ka nevojë për këto paratë e Trustit. Hapni telefonat, qitni para kamerave, i bindur jam që edhe juve çdo i dyti ju ka shkruar, oj teze ti që po qesh, a po na bëhet Trusti sot, a po kupton, votoje bre teze a po kupton.

Armëpushim është dashur të bëhet sot ndërmjet nesh, sepse s'ishte bërë kiameti as nami, ata kanë bërë armëpushim në Luftë të Parë Botërore, janë vrrarë nga njëqind a dyqind mijë Natën e Kërshëndellave, pastaj kanë vazhduar prapë të vriten nesër. Ne s'po themi të vritemi, po në kuptimin e armëpushimit tipik, që të diskutojmë në mënyrë konstruktive.

Për fund po ju them këtu është problemi esencial. Nuk është te këto raportimet e mbrojtjes teknike, jo statistikat, jo ekonomia etj. Është problemi që kjo është ajo demokracia pa individë. Jeni të prangosur. Vetveten e keni prangosur. Nuk bëhet kiameti mos ta dëgjosh Albinin sot. Mos u tutni, sepse marshimi i lirisë në shpirtin e njeriut në fakt është premisa kryesore për liri politike e ju s'keni liri politike, sepse shpirtërisht e keni vendosur ta burgosni vetveten dhe të mos votoni në interes të qytetarit. D.t.th. kjo është argumentuar edhe me çështje e Oliver Ivanoviqit. Secilin prej jush po ta kishit pyetur dje a pardje, a e ka pasur Albini gabim, secili prej jush, jashtë petkut partiak, kishit thënë po e ka pasur qind për qind gabim, po nuk keni guxuar të reagoni, siç nuk guxonin të reagoni sot me vendimmarrje të pavarur, individuale në interes të qytetarit. Faleminderit!

KRYETARI: Eman, pse më herët, jo Ardiani. Nuk e dëgjova. Jo më herët iu përmend emri prej z. Isak Shabani.

EMAN RRAHMANI: Faleminderit, kryetar!

Unë po besoj që këtu në Kuvend secili e përfaqësojmë edhe veten edhe nëse dëshirojnë të jemi konstruktiv dhe të kërkojnë mbështetje, me fyerje të tilla nuk mund të arrijë askush. Kështu që nëse e keni veç për të dalë dhe të mbani një fjalim dhe të fyeni në mënyrë të tillë dhe të mundoheni të kërkonin mbështetje, besoj që është problem. Nuk e keni qëllimin te arritja e mbështetjes, po te fyerja dhe ndasia, e kundërta e krejt asaj që ju po kërkonin në njëren pjesë të fjalimit, kurse me vepra konkrete e bëni krejt të kundërtën.

Kështu që edhe përmendja e emrit tim, besoj që nuk mund t'ju jap shembull juve që të kërkonin te të tjerët dhe t'i akuzoni të tjerët duke u krahasuar me mua, për shkak që secili këtu e kemi edhe mendimin, edhe kemi moshën madhore të vendosim, edhe ashtu kur mendojmë ndryshe. Këtë besoj që na takon neve secilit dhe jo të kemi vlerësime prej kujtdo që del në foltore aty edhe flet për mendime dhe qëndrime të dirigjuara prej dikujt tjetër.

KRYETARI: Po ashtu i inkurajoj deputetët që të mos flasin për pamjen fizike të të tjerëve dhe kjo është në kuadër të gjuhës korrekte parlamentare.

Vendenis Lahu, urdhëro. Radhën e ka konsideroj Aleanca. Pali paska ardhur këtu, kështu që ia japim fjalën.

PAL LEKAJ: Faleminderit, kryetar!
I nderuar ministër,
Po më vjen keq që kanë lënë vetëm.
Të nderuar kolegë deputetë.

KRYETARI: Pal, të lutem veç pak, se një replikë po më thotë Mirlinda. Me Ardian Kastratin, urdhëro.

MIRLINDA TISHUKAJ-SADIKU: Përshëndetje!

Faleminderit për fjalën!

Të pranishëm deputetë,

Gjuha bullizuese seksiste, ofenduese është standard i PDK-së. E kanë dëshmuar shumëherë, mirëpo këtu e kemi një deputet, i cili vjen në Kuvend me korrespondencë, ka përdorë gjuhë bullizuese edhe ndaj pamjes fizike të Presidentes. Është një shou-men, i cili sa herë del në foltore, nuk flet asnjëherë në mënyrë substanciale për temat që diskutohen, por nuk pritet më mirë prej një plagjiatori.

KRYETARI: Urdhëro një minutë, z. Kastrati.

ARDIAN KASTRATI: E para e punës, unë nuk e pata me ty me frizere, po me një tjetër, tash nuk e di pse reagoje. E dyta e punë, nuk ke kalori intelektuale të mjaftueshme të tregosh se kush e ka bullizuar Vjosa Osmanin ose atë. Unë e kam cituar Faik Konicën dhe në fakt unë jua kam nxjerrë bullizmin prej barkut, se ju i jeni gjuar asaj pastaj. Hajde ditën e mirë!

KRYETARI: Vazhdo Pal!

PAL LEKAJ: Faleminderit, kryetar!

KRYETARI: Ju lutem qetësi, sepse po flet deputeti Pal Lekaj.

PAL LEKAJ: Sot po diskutohet për një temë e cila përket drejtpërdrejt qytetarin e Kosovës. Sot ne jemi ulur në këto ulëse të Kuvendit falë besimit të votës së qytetarëve të shtetit tonë të cilët e vlerësuan se ne do të jemi zëri që do të mbrojmë interesat dhe kërkesat e tyre në çdo kohë. Prandaj, para vetes përveç që e kemi mundësinë e kemi edhe obligim moral e politik që të

përkrahim kërkesën e tyre mbi tërheqjen e tridhjetë për qind të Trustit. Ne e dimë që lejimi i tërheqjes së një pjese të Trustit do të ndihmonte tejmas ekonominë e vendit, prandaj na duhet reflektim i të gjithëve dhe është momenti që të bëhemi bashkë pozitivë dhe opozitivë. Pa interesa politike të votojmë në dobi dhe interes të qytetarëve të Kosovës.

Është e vërtetë që ka zëra kundër, ka teori që e kundërshtojnë, por si opozitivë jemi të shqetësuar për humbje të njëpasnjëshme që po i ndodhin parave të taksapaguesve të vendit, qoftë përmes Trustit Pensional që është një vlerë mbi 120 milionë euro, e cila ka ardhur si pasojë e shumë faktorëve, por kryesoret janë menaxhimi i burimeve dhe i fondeve të Trustit dhe shitja e tyre. Gjithashtu, inflacioni dhe devaluimi.

Të nderuar kolegë,

Duhet të jemi të kujdesshëm dhe duhet të lëmë anash çdo lloj kalkulimi politik dhe të mundësojmë që një pjesë e parave të taksapaguesve të kthehen te qytetari. Në mënyrë që këto mjete të kthehen në qarkullim përmes qytetarëve dhe që përfitimet nga kthimi i vlerës tridhjetë për qind do të jetë rreth katërqind milionë, kurse vetë shteti do t'i merrte mbi shtatëdhjetë milionë euro TVSH e që kjo do të ishte një infuzion i mirë për vendin. Pra, shkurt e shqip po përfiton qytetari, po përfiton ekonomia dhe po përfiton edhe shteti përmes TVSH-së.

Nuk dua të zgjatem më shumë, sepse është folur mjaft sot, por qytetarët vërtet si asnjëherë më parë kanë nevojë për Trustin dhe unë si përfaqësues i tyre, si përfaqësues i Grupit të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, ju lus që në mënyrë kolegjiale të ngrisni duart pro Trustit. Faleminderit!

KRYETARI: Tash ia japim fjalën deputetit Hajdar Beqa.

HAJDAR BEQA: Faleminderit, kryetar i Kuvendit!

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Të nderuar deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës,

Ministër i pranishëm,

Ne sot po diskutojmë një projektligj i cili ka buruar apo është kërkesë e 21.398 qytetarëve të cilët për vetëm tetë ditë i kanë mbledhur nënshkrimet, për shkak se hallet e tyre e kanë bërë që ata të bëjnë një procedurë aq të shpejtë të nënshkrimit për të kërkuar një të drejtë imediate.

U tha këtu që realisht këto mjete qytetarëve u duhen kur ta bëjnë moshën e pleqërisë, që është shumë e vërtetë, po sa të besojnë qytetarët kur kjo Qeveri nuk angazhohet të jetë afër qytetarëve, e lëre atëherë kur ju nuk jeni edhe kompetentë. Kur sot jemi kompetentë të bëni diçka për qytetarët, nuk po bëni.

E dimë që kjo nuk është zgjidhje perfekte, por është zgjidhje e imponuar në mungesë të mbështetjes nga Qeveria. Nëse Qeveria ka zgjedhur që të mos i mbështesë, atëherë të paktën të

mos i pengojë qytetarët në kërkesën e tyre, sepse ata po i kërkojnë mjetet e tyre. Nuk po kërkojnë t'u ndihmohet qytetarëve, t'u ndihmojë Qeveria, por t'u lejohet që t'i tërheqin mjetet sa ata kanë nevojë. Nuk është mirë të bëjmë krahasime me shtetet e tjera, sepse një fond i tillë qysh është Trusti, në shtetet siç janë Shtetet e Bashkuara të Amerikës e ka edhe atë rrisht e rrezikut dhe qytetari duhet të bëjë një deklaratë paraprake që i merr edhe përgjegjësitë. Në krejt këtë situatë qytetarët po detyrohen të largohen nga vendi. Mbi dyzet mijë qytetarë janë larguar nga Kosova vetëm në v. 2021. Fatkeqësisht, trendi i njëjtë ka qenë edhe në v. 2022 dhe vazhdon të jetë edhe në vitin të cilin jemi sot.

Sot ne deputetët e Kuvendit të Republikës së Kosovës duhet të miratojmë Projektligjit për tërheqjen e mjeteve nga Trusti. Ata qytetarë që kanë nevojë t'i tërheqin mjetet, i tërheqin, kurse ata qytetarë të cilët nuk kanë nevojë për ato mjete, nuk i tërheqin.

Unë jam i bindur se me këtë formë të qeverisjes pa strategji, pa zhvillim ekonomik, tërheqja e këtyre mjeteve nuk e zgjidh krizën ekonomike në vend, po jam i bindur dhe jam shumë i bindur që do ta zbusë situatën e vështirë ekonomike me të cilën po përballen fatkeqësisht qytetarët e vendit tonë.

Sot është momenti të votojmë për qytetarët, sepse kërkesa e tyre përveç që është legjitime, është edhe imediate. Kërkesa për tërheqjen e mjeteve nga Trusti, është kërkesa e qytetarëve të cilët po përballen me gjendje të rëndë ekonomike. Mos harroni, çmimet e shportës familjare janë rritur mbi tridhjetë për qind. Varfëria e Kosovës, sipas të dhënave të raportit për vendin, është shumë e lartë. Tetëmbëdhjetë për qind e qytetarëve të Kosovës jetojnë në pragun e varfërisë apo nëse e kthejmë me shifra diku dyzet e pesë euro në muaj, ose një euro e gjysmë në ditë, siç e definojnë edhe Banka Botërore.

Gjithashtu, raporti gjen që pesë për qind e popullatës jetojnë në pragun e varfërisë ekstreme. Ndërsa, në anën tjetër bankat private kanë pasur një rritje enorme, sidomos në dy vitet e fundit.

Në të njëjtën kohë, Qeverinë aktuale dhe ministrin as Kryeministrin nuk i pengon ambasadori i Republikës së Kosovës, Martin Berishaj t'i tërheqë një milion e pesëqind mijë euro nga banka, t'i tërheqë mjetet pa ditur se nga i vijnë ato mjete. Ende nuk kemi një sqarim për opinionin publik ku janë ato mjete, ku kanë shkuar ato mjete. A i ka marrë mazhoranca për fushata, a i ka marrë Martini me dy-tre individë, me ata të cilët sot po i mbrojnë apo çfarë ka ndodhur?

Unë e pata një rast ta them, një qytetar nga Gjakova, edhe ai e ka emrin Martin, tha nuk e di çka po e pengon ministrin e Financave, Kryeministrin, mua diku më bien rreth 1700 euro t'i tërheqë nga Trusti, kurse ai Martini tjetër tha i ka tërhequr një milion e pesëqind mijë euro edhe nuk po i pengon. Nuk e di cili është problemi këtu.

E them se kam disa miq që i kanë emrat Martin, po nuk janë milionerë. Kanë probleme të tjera, e të cilat besoj që duhet t'i kalojnë. Pra le të jetë e ditur, kjo Qeveri dhe kjo shumicë po e shtyn njëfarë forme po e ngulfat varfërinë. Në vend se të bëjë zgjidhje, Albin Kurti po mbështet fatkeqësisht vetëm individë të caktuar, jo bizneset, jo ndërmarrësit, jo prodhuesit, po mbështet oligarkët. P.sh. kemi raste ia jep 99 hektarë falas një kompanie e cila është afër këtu me pushtetin, kurse i ngulfat bizneset të cilat fatkeqësisht çdo ditë kemi kompani që po falimentojnë dhe po i mbyllin bizneset e veta, për shkak që nuk po gjejnë klimë investuese në republikë. E lëre që me keqardhje e them, po ju jeni shumë optimistë, se jeni dëshmitarë okularë që nuk keni investitorë të jashtëm të interesuar të vijnë ta fusin kapitalin e vet në tregun e Republikës së Kosovës.

Deputetë të nderuar,

Ky projektligj që është në lexim të parë, është kërkesë e qytetarëve. Ndoshta keni pasur të drejtë në të kaluarën të thoni që e ka sjellë një subjekt politik apo një deputet nga një subjekt politik dhe të bëhet politikë. Tash të mos bëjmë politikë. As nuk është interes i një grupi parlamentar, por është interes i të gjithëve. Jam shumë optimistë se ata njëzetetë mijë qytetarë janë të të gjitha subjekteve politike. Kanë votuar për të gjithë, nuk kanë votuar vetëm për PDK-në, ose për LDK-në a AAK-në, po kanë votuar edhe për juve.

Andaj, gjenduni tani se ka ardhur momenti dhe mes dy leximeve ne kemi mundësi të japim kontribut. Komisioni që tani tha z. Muja normalisht po qesh se nuk e ka këtë problem, sepse e ka një pagë të mirë e solide, nuk ka problem të hyjë në kredi t'i blejë barnat, edhe nëse e ka një anëtar të familjes të sëmurë. Ne kemi qytetarë, që jam optimistë edhe juve, çdo ditë ju thonë shihni e kam një problem, e kam prindin sëmur, më duhet t'i blejë barnat, a po më ndihmon pesë euro, a po më ndihmon dhjetë euro t'i gjendet një rrugë t'i ndihmohet se shteti nuk po mund të jetë në shërbim të qytetarëve.

Unë kisha kërkuar t'i lëmë sot petkun politik, t'i lëmë interesat ditore apo të dy-tre individëve apo urdhrat e dy-tre individëve, ta votojmë kërkesën e qytetarëve, të ulet Komisioni për Ekonomi e Financa bashkë me përfaqësuesit e qytetarëve dhe aktorë të tjerë dhe ta gjejnë formën më të mirë e t'u dalim zot qytetarëve.

Edhe një herë po them që nuk bëhet krahasimi me komunitet tjetër, po bëhet krahasimi me ata që kanë kontribuar. Edhe ata kanë të drejtë ligjore, legjitime e morale t'i tërheqin mjetet e veta. Është më mirë ta përkrahim qytetarin, sesa të përkrahni në këtë rast, po e shihni sa të lumtur kanë dalë Albini e Martini. Edhe ministër, nëse nuk e përkrah këtë, dil bëjë selfie.

Faleminderit! ju kërkoj ta na përkrahni kërkesën e qytetarëve, jo të Partisë Demokratike.

KRYETARI: Fjalën e ka Haki Abazi.

HAKI ABAZI: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Deputetë të nderuar,

Qytetarë të dashur,

Sigurish fjala e parë e gjithsecilit këtu është që mos e politizoni çështjen e Trustit. Në fakt, krejt fjalimet që i kemi parë sot për vazhdimësi është që mbi fukarallëkun e qytetarëve të ndërtohen kauza politike. Është e tmerrshme. Unë nuk e di ku e gjejnë energjinë deputetët ta përmendin faktin që qytetarët s'kanë sigurim shëndetësor. Ku kanë qenë këta njerëz njëzet vjet që të mos e bëjnë sigurimin shëndetësor, për t'i lënë sot me idenë që ata duhet ta nxjerrin Trustin për të nxjerrë ilaçe? Është Partia Demokratike, është Lidhja Demokratike që e ka krijuar precedentin e parë të tërheqjes së Trustit.

Tani konceptualisht është ideja, a po duam ta thellojmë fukarallëkun apo po duam të gjejnë zgjidhje për ta përballuar krizën? Do të thotë, mbi idenë e dështimeve të së kaluarës, nuk mund të ndërtojmë me atë shkollë ide të cilat e dëmtojnë të ardhmen e njerëzve, qytetarëve të vendit. Kështu që, përbrenda anës konstruktive të kolegjalitetit do të duhej kjo punë të bëhej përbrenda diskutimeve që nuk e rëndojnë edhe më tutje qytetarin, duke tentuar të bëhemi shpirtgjerë këtu, kinse po mendon pak më shumë për atë qytetar. E kanë parë qytetarët.

Kjo kauzë që është krijuar kërkon një zgjidhje adekuate. Sot kishim një fjalim prej zotit Rrahmani, deputetit të Lëvizjes Vetëvendosje, që mendoj që nxjerr në pah mundësinë e largimit të këtyre hipokrizive mbi të cilën ndërtohet kauza.

Edhe puna e nënshkrimeve të petitionit. Partia Demokratike e di shumë mirë që në legjislaturat e kaluara ka pasur mbi 30 mijë nënshkrime të qytetarëve që të mos rritej çmimi i energjisë elektrike, asnjëherë në shqyrtim nuk është vendosur. Do të thotë, precedenti për të mos e respektuar qytetarin është krijuar moti.

Tani jemi te niveli i standardeve të reja që duhet krijuar. Propozimi është konkret. Qytetarët janë vendosur mbi idenë që mund ta tërheqin Trustin. E vërteta është që ka trusni të jashtëzakonshme publike për këtë çështje. Ka modele të suksesshme nëpër botë se si i lejohet një individ për ta bërë një gjë të tillë pa e cenuar të drejtën e atij individit, rrjedhimisht pa e cenuar edhe interesin publik, por edhe të ardhmen e kolektivitetit kur ata varen prej këtij Trusti.

Andaj, për t'i shkurtuar këto idetë e fyerjeve e kualifikimi të guximit intelektual e të deputetëve, mendoj që duhet të fokusohemi te modeli i zgjidhjes për të dalë prej këtij rrethi vicioz, sepse është lehtë me pas syrin te paratë dhe tek të hollat cilat janë të grumbulluara, është shumë vështirë të krijohet koncept të qëndrueshëm zhvillimor që qytetarët më nuk e kanë gajlen e fukarallëkut, por e kanë idenë e një prosperiteti në këtë vend, të cilën fatkeqësisht ua kemi cunuar pikërisht për shkak mendimeve afatshkurtra edhe politikave afatshkurtra me të cilat jemi marrë për më shumë se dy dekada.

Propozimi im është që me dashamirësi nëse vërtet ia doni të mirën qytetarin të tërhiqemi për t'u bërë bashkë të gjitha grupet parlamentare të dalim me një zgjidhje. A është 10% tërheqje pa pagesë të tatimeve, a është 30% tërheqje e drejtë e qytetarëve me ç'rast duhet paguhen tatimet sipas modele të tjera, sepse është tërheqje para kohe, ku nuk dëmtohet buxheti i shtetit apo është një modalitet i tretë brenda të cilit nuk ka humbës dhe fitues, por ka zgjidhje për qytetarin, është çështje e një debati ku duhet të thirren edhe ekspertët e këtyre çështjeve për të ikur tutje.

Edhe një gjë, të mos manipuloni me qytetarët se, kanë humbur 120 milionë. Vetëm ata që s'kuptojnë se si investohen portfoliot nëpër aksionet e bursave botërore, bëjnë kësi insinuata edhe shpërndajnë informata të rrejshme. Kjo portfolio e Trustit është i investuar nëpër tregjet globale, ato kanë ngritje edhe zbritje, por që nuk janë humbje, e unë mendoj që shumë kanë gajle qytetarët tanë që t'i ngarkojmë edhe me kësi informacione që janë të pavërteta.

Po e them edhe njëherë, kemi një nismë të mbarë e cila është propozuar prej Eman Rrahmanit, deputetit të Lëvizjes Vetëvendosje. Besoj që hapësira për një model të suksesshëm prej këtu për ta bërë qytetarin në linjë të drejtpërdrejt me institucionin dhe në anën tjetër, në këtu që të kalojmë këtë barrierë që me disa muaj po konsumon energji edhe brenda institucioneve edhe me publikun në anën tjetër.

Rrjedhimisht, zoti kryetar, nëse më lejohet mendoj që duhet ta shqyrtojmë mundësinë që grupi ndërparlamentar, komisionet përkatëse të ulen dhe të shohin se si të dalim prej këtij rrethi ku jemi futur edhe gjithçka që propozojmë është për të tensionuar qytetarët, të cilët mandej nuk dinë se në çfarë në fakt besojnë, në fjalim e kujt apo në të dhënat e kujt duhet besuar për ta tejkaluar këtë çështje të diskutimit. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ta ka përmend, por m'u duk si replikë me të njohshëm. Hajt s'ka lidhje. Urdhëro!

BEKË BERISHA: I nderuar kryetar,

Të nderuar deputetë,

Ne sot jemi duke folur për një çështje shumë të rëndësishme. Kur po flasim disa profesionistë e disa të ekonomisë nuk po marrë vesh kurrëgjë, mirëpo nga deputetë të ndryshëm e foli se kjo është më temë më njerëzore, në shprehem kështu, të biem me këmbë përtokë, se po e çojmë debatin nganjëherë në kundërshtime, nganjëherë në disa gjëra që janë të panevojshme.

Unë jam i vetëdijshëm se ky është një problem tërheqja e Trustit, edhe e di që dalin disa probleme që ju ekonomistët që po e dini ekonominë do të duhej ta dinit se si të zgjidhet ky problem.

A kanë nevojë qytetarët për këto mjete? Kanë nevojë. A i harxhon kush kursimet e veta veç badihava ose për mendje të madhe? Nuk është e vërtetë as ajo. Por, e kemi pasur një gjendje post

pandemike, e cila po kthehet e po bëhet aktuale prapë, inflacioni, fukarallëku, e plotë probleme të tjera, e çmime të larta.

A mundemi ne ta tejkalojmë vetveten sot, jo për argumentet që i përdorëm deri tash që i thanë shumë deputetë, po veç për përmbytjet që janë duke ndodhur tash që jemi duke folur ne, prej Mitrovicë e Skenderaj e krejt Dukagjini, ne do të duhej të mendonim edhe të reflektonim sot për t'ju ndihmuar atyre. T'i lëmë këto kundërshtim e teke të njerëzve, se me të vërtetë s'po i kuptoj. Faleminderit!

KRYETARI: Në emër të grupit replikë më kë? Me Haki Abazni? Urdhëro!

ELIZA HOXHA: Faleminderit! Vetëm një sqarim meqë unë e përmenda që humbjet në Trust në fund të vitit 2022 janë 120 milionë. Nuk janë spekulime, zoti Abazi. Më fal, të lutem! Unë vetëm po citoj çfarë kam lexuar dhe ju tani mund ta keni fjalën tuaj.

Kriza në tregjet financiare globale ka bërë që investimet e Trustit jashtë të kenë humbje mbi 120 milionë. Që i bie 5% minus të investimeve është Fondi i Trustit në Kosovë. Kështu që, nëse ju keni përgjigje të tjera, të lutem, i thoni, por të mos thoni që janë spekulime, se unë jam referuar diku.

KRYETARI: Një kundër-replikë një minutë për zotin Abazi, dhe pastaj kalojmë te diskutuesit e tjerë.

HAKI ABAZI: E vërteta është që ai është Fond, i cili bie ose ngrihet brenda vitit, por brenda viti kalendarit nuk mund të bëhet krahasimi i fondit. Këtu është ideja. Secili prej nesh kemi investime edhe individuale që janë të njëjtat në natyrë. Tani nëse e llogarisni numrin në fund të vitit 2021 dhe e krahasoni me fundit e vitit 2022, mund të qëndrojë krahasimi, por nuk janë ato humbje që është zhdukur fondi, janë zhdukur investimet e portfolios. Mund të ketë ngritje edhe mund të ketë zbritje. Vetëm ky ishte sqarimi.

Nuk mundet qytetari të mendojë që është zhdukur fondi edhe kanë humbur 120 milionë të fondit.

KRYETARI: Në radhë e kam Mërgim Lushtakun, por mos dëshironi t'ia lironi radhën Ganimetës, po kërkon? Urdhëro, zonja Musliu!

GANIMETE MUSLIU: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Të dashur qytetarë të Republikës së Kosovës,

Kjo Qeveri, po mund edhe të mburret me disa gjëra, disa prej të cilave po i radhis sot para jush. Kjo Qeveri mund të mburret për manipulim kolektiv të shoqërisë sonë dhe për kontrabandim të kauzave të rrejshme.

Kjo Qeveri mund të mburret për plaçkitje të qytetarëve edhe për ofendime kolektive ndaj sindikalistëve dhe mësimdhënësve të Kosovës. Kjo Qeveri mund të mburret për plaçkitje dhe manipulim të diasporës dhe të gjithë bashkatdhetarëve tanë. Kjo Qeveri mund të mburret për promovimin e varfërisë. Kjo Qeveri mund të mburret për përndjekje dhe diferencime politike. Kjo Qeveri mund të mburret për nxitje të urrejtjes dhe linçimit publik. Kjo Qeveri mund të mburret për arrogancë dhe dhunë sistematike ndaj administratës shtetërore. Kjo Qeveri mund të mburret për dështimet në garantimin e sigurisë territoriale dhe për shkatërrimin e diplomacisë.

Kjo Qeveri mund të mburret për dështime dhe për shkelje të premtimeve të veta. Kjo Qeveri mund të mburret për diktat ndaj qytetarëve, mediave dhe shoqërisë civile. Por, mbi të gjitha, kjo Qeveri mund të mburret me injorimin që ia bën historisë më të lavdishme të kombit, të luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës përderisa glorifikon kriminelët dhe vrasësit e shqiptarëve.

Të nderuar kolegë,

Të dashur qytetarë të Republikës së Kosovës,

Në këtë sfond të lavdishëm të qeverisje së këtij personi të papërgjegjshëm sot, ndoshta mund të shtohet se do të mburret edhe për injorimin e kërkesës së qytetarëve për tërheqjen e Trustit. Pse jo, kur në Kuvend ka instaluar njerëz të cilët e kanë shtypur pullën e pauzës në trurin dhe ndërgjegjen e tyre dhe vetëm ngrehin dhe ulin duart si marioneta të një gënjeshtari e të një mashtruesi të paprecedent në historinë e këtij Kuvendi.

Megjithatë, shpresoj shumë, po, shumë shpresoj që në ulëse e deputetëve të shumicës, sot do të dominojë përgjegjësia ndaj votuesit e jo ndaj lideri të cilit nuk mungon asgjë. Të dominojë njerëzorja ndaj votuesve të cilët mezi po i ngopin me bukë dhe po i shkollojnë fëmijët e tyre, e jo ndaj një lideri fëmijës të të cilit nuk po i mungon sot asgjë.

Të dominojë përgjegjësia ndaj qytetarëve të Republikës së Kosovës, e jo ndaj shefave të tyre, të cilët janë barrikaduar në Marigona Hill, e në lagjet më të shtrenjta të qytetit. Konformiteti, heshtja dhe tolerimi do t'ju bëjë pjesë e këtij krimi politik. Prandaj, të nderuar, gjejeni guximin dhe tregojini edhe Albinit edhe Vjosës se jeni njerëz të gjallë e jo vetëm marioneta të tyre.

Të mos lejoni të bëheni pjesë e promovimit të mjerimit dhe shkatërrimit të këtij vendi i cili i ngrit mbi sakrificën e disa prej jush dhe familjarëve të pjesës tjetër prej jush. Ky është vendi ynë. Ky Kuvend qëndron mbi Qeveri, mbi çdo kryeministër, e mbi çdo pushtet. Ky Kuvend është zëri i qytetarëve të Republikës së Kosovës.

Prandaj, të mos e injoroni kërkesën e mbi 21 mijë qytetarëve. Votojeni Trustin. Votoni për qytetarët e këtij vendi, të cilët edhe ashtu janë sflitur. Ndoshta do t'ju diferencojë lartmadhëria, lideri juaj shpirtëror, por të mos besoni se do të flini shumë më të qetë sot pas votimi pro të këtij vendimi.

Të dashur qytetarë të Republikës së Kosovës,

Më lejoni që të shpreh solidarizimin tim sot me të gjithë qytetarët të cilët po ballafaqohen me vërshime nga reshjet e fundit, e sidomos me qytetarët e Komunës së Skenderajt, atje ku tashmë është shpallur gjendje e jashtëzakonshme. Prandaj, kërkoj nga Qeveria e Republikës së Kosovës, nga institucionet e vendit, që qytetarëve atje t'u dalin në ndihmë.

KRYETARI: Fjalën ia japim deputetes Hykmete Bajrami.

HYKMETE BAJRAMI: Faleminderit, kryetar i Kuvend!

Në fakt nuk e pata në plan që diskutoj më tepër sa i përket kësaj pike, se besoj që është diskutuar mjaft, por megjithatë duhet të kthehem tek akuzat e zotit Abazi, i cili tha që qeveritë e kaluara nuk e kanë bërë Fondin Shëndetësor edhe për shkak të asaj sot qytetarët duhet të marrin kredi, në mënyrë që t'i blejnë barnat e tyre.

Unë ia rikujtoj zotit Abazit që kjo akuza për 20-vjeçarit e kaluar nuk është duke u shitur më në publik. Nëse i shohim shkollat, rrugët, infrastrukturën, qendrat e mjekësisë familjare, universitetet dhe plotë gjëra të tjera, çdo institucion që ne sot e kemi, është bërë pikërisht në 20-vjeçarit e kaluar.

Lidhja Demokratike e Kosovës nuk ka mundur ta bëjë Fondin Shëndetësor as në vitin 2000 kur buxheti i Kosovës ka qenë 200 milionë, as në vitin 2004 kur ka qenë rreth 400 milionë, as në pikun e pandemisë nuk ka pasur mundësi ta bëjë. Unë besoj që sot kritika e zotit Abazi dhe secilit deputet të Lëvizje Vetëvendosje do të duhej të drejtohej, jo nga ne deputetët e opozitës, por të drejtohej nga ministrat e Qeverisë së tyre.

Ta pyeste ministrin e Financave se qysh ka mundësi që në buxhetin e vitit 2023 i ka 271 milionë euro në kuadër të kontigjencave dhe rimëkëmbjes ekonomike dhe nuk e ka asnjë plan sa i përket themelimit të Fondit Shëndetësor dhe sigurimeve shëndetësore. Nuk ka plane.

Ju keni ardhur që ta bëni më mirë se të gjitha qeveritë e kaluara dhe qytetarët u kanë besuar premtimeve tuaja, të cilat sot asnjë prej tyre nuk i keni realizuar. Sot, Qeveria e Republikës së Kosovës nuk është në gjendje dhe t'u tregojë 83 mijë qytetarëve të vendit që janë zyrtarë publikë sa është koeficienti i pagës në sektorin publik.

Sot, që gjashtë muaj më herët e kemi Ligjin për pagën minimale të Komisioni për Buxhet, Financa dhe Transfere. Sot, nuk dihet se cilat do të jenë ndihmat në kuadër të adresimit të inflacionit për vitin 2023. Janë thjeshtë 271 milionë në Ministrinë e Financave për të cilat ministria e Financave nuk u tregon as deputetëve të vet se çfarë do të bëjë.

Andaj, në situatën që jemi sot dhe për temën që po diskutojmë na ka sjellë kjo Qeveri dhe jo opozita. Të mos harroni, i keni fituar 51% që ta bëni më mirë se krejt të tjerët dhe jo për t'u vajtuar, 4 vjet mandat se çfarë kanë bërë të tjerët. Tani të gjithë po e dinë se çka jeni në gjendje të bëni ju dhe çfarë kanë bërë të tjerët. U bë mirë që ra perdja dhe personazhet e të gjithëve tash krejt publiku i njeh. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka deputeti Shemsedin Dreshaj. Më fal zoti Dreshaj, një replikë e paska kërkuar Haki Abazi lidhur me atë që e tha zonja Bajrami.

HAKI ABAZI: Në fakt për t'i qëndruar konsistent kërkesë sime, nuk është replika për ta kërkuar fragmentimin e mëtutjeshëm. Por, ideja që i gjithë Fondi i Privatizimit ka mundur shumë lehtë ta krijojë bazën e Fondit të Sigurimit prej ditës së parë të privatizimit. Për shembull, si një model që të mos lihen njerëzit në mëshirën e fatit edhe të vendimeve arbitrare kur vjen puna për nevojat shëndetësore të tyre.

Ka pasur me qindra mënyra se si do të rregullohej sistemi shëndetësor deri sot, e jo justifikime pse s'është bërë për 20 vjet. Në anën tjetër, po kërkoj që kritikën ta bëni nga perspektiva e së ardhmes, sepse shkolla e së kaluarës nuk lë hapësirë për ta marrë seriozisht kritikën.

Shkolla e së kaluarës ka përfunduar në dështim këtu. Prej perspektivës së ardhmes? Po, besoj që ka momente kur ne mund të mësojmë nga njëri-tjetri dhe përvoja. Dhe, besoj që përbrenda Lëvizjes Vetëvendosje është zëri kritik që ju s'e keni bërë kurrë ndaj dështimeve kur keni qenë në qeverisje. Ju përmenda precedentin e parë që e keni bërë kur keni dhënë të drejtën për ta tërhequr Trustin, që në fakt ka shkaktuar këtë rreth vicioz të panevojshëm e energji të humbur te qytetarët, sepse duhet të flasim për agjenda zhvillimore e jo për sadaka edhe që t'u përgjigjemi qytetarëve për nevoja bazike elementare pas 23 vitesh çlirim.

KRYETARI: Zonja Bajrami!

HYKMETE BAJRAMI: Edhe unë pikërisht aty e kam. Urdhëro edhe kthehu nga e ardhmja, sepse i ke të gjitha nivelet e pushtetit dhe sot në vend se të tregoni se çka është dashur të bëjnë me Fondin e Privatizimit, unë besoj që e ke shansin e artë t'i tregosh Agjencionit të Privatizimit çka të bëjnë ata sot. Nëse nuk i ke informacionet, po ju informoj që janë disa milionë që vetëm muajve të humbur janë humbur nëpër konteste të ndryshme, dhe privatizimi po vazhdon po me tempo më të lartë se herëve të kaluara.

Në anën tjetër, edhe njëherë po ju tregoj zoti Abazi, 271 milionë janë te Ministria e Financave pa projekt, pa plan, pa vizion. Urdhëro kërkoni prej ministrit që të iniciojë sigurimet shëndetësore dhe të mos e vajtoni të kaluarën.

KRYETARI: Urdhëro, zoti Dreshaj! E keni fjalën.

SHEMSEDIN DRESHAJ: I nderuar kryetar i Kuvendit,

I nderuar Kabinet qeveritar,

Deputetë,

Sot, një debat kaq i gjatë vërtet e dëshmoi që ky problem është problem i madh për shoqërinë tonë. E di që nuk është zgjidhja më e mirë tërheqja e fondit për ditët e pleqërisë, por popullata jonë e gjerë po i konsideron si ditët më të zeza që i ka përjetuar deri më sot. Qëllimi është që kjo e keqe e madhe të zbutet sa më shumë, të kalohet sa më lehtë.

Ju kujtohet që në fillim kur ishte për herë të parë si iniciativë e zotit Bekim, kanë qenë plotë ekspertë të huaj dhe vendorë që kanë qenë kundër, edhe ata më zëshmit sot veç kanë filluar të heshtin. Arsyeja është që nuk ka mbetur alternativë tjetër përpos kësaj.

Unë jam që 37 vjet mjek dhe profesor. E di gjendjen e mjekut. E di gjendjen materiale të infermierit. E di gjendjen materiale të profesorit, të asistentit, të mjekut të ri. Të besoni, telefoni im pa reshtur është me mesazhe, ku kërkohet mbështetje. Ju lus që në emër të mbi 21 mijë nënshkrimeve dhe po aq të tjerë që janë duke na përcjellë syhapur përmes mediave elektronike, ta mbështesim këtë nismë, fundi i fundit është leximi i parë. Në mes të dy leximeve ka mundësi dhe iniciativa që do të mundësojnë të modifikohet shumëçka.

Unë ju lus që ta votoni Trustin! Unë do ta votoj. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka deputeti Ardian Gola.

ARDIAN GOLA: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar deputetë,

Mbi të gjitha, të qytetarë të Republikës së Kosovës,

Trusti nuk është problem realisht, është problem i stisur për shkak se problemi real është vështirësitë financiare që qytetarët kanë aktualisht, qoftë si rezultat i trashëgimisë së pandemisë, qoftë si rezultat i nivelit të caktuar të zhvillimit ekonomik.

Sa i përket Trustit, unë konsideroj që të paktën qytetarët e kanë të qartë që formacioni politik i cili është aktualisht në pushtet është absolutisht konsistent në qëndrime e tij për sa i përket Trustit, sepse si në opozitë ashtu edhe në pushtet ka qenë kategorikisht kundër tërheqjes së

Trustit. Dhe, kjo konsistencë thjesht reflekton një pozicionim të caktuar politik mbi të gjitha që synon ta ruaj strukturën institucionale të shtetit.

Po më duket që lufta është pak më e thellë. Lufta nuk ka të bëjë me mbrojtjen ose jo të Trustit, lufta nuk ka të bëjë kundër ose pro Trustit, por lufta është që t'i jepet fund një modeli defensivë të shtetit.

Një modeli i cili përpiqet të japë zgjidhje afatshkurtra, duke prodhuar probleme afatgjata. Ka shumë argumente në teorinë dhe filozofinë politike që shteti në momentin kur konsolidohet në aspektin legjitim dhe procedural përmes votës, medoemos krijon një distancë në raport me qytetarët për shkak se duhet të funksionojë në mënyrë normale si shtet.

Përndryshe, nëse shteti në mënyrë konstante reagon në raport me presionet publike, ti prodhon një shtet defensivë të tillë çfarë e kemi edhe sot. Është interesant që ndërtimi psikologjik dhe kognitiv i njeriut është i tillë që njeriun e predispozon të reagojë për momentin, të ofrojë zgjidhje, të krijojë zgjidhje afatshkurtra për problemet që dalin në sipërfaqe ama civilizimi, progresi dhe vet shteti është rezultat pikërisht i nevojës së tejkallimit të këtij niveli dhe të këtij rezoni momental. Përndryshe, ti përfundon duke krijuar një shtet përmes logjikës sot për nesër.

Sot e kemi këtë mundësi ta zgjidhim këtë problem. Po, e zgjedhim është kështu dhe nesër le të dali ku të dali. Zgjidhjet afatshkurtra të problemeve prodhojnë zgjidhje afatgjata të problemeve. E ideja është se si t'i jepet fund kësaj logjike dhe këtij modeli.

Tash, për nga vetë natyra, deshëm ne ose nuk deshëm, shteti e ka brenda të ndërtuar një dosje të caktuar të paternalizmit, por në mënyrë që t'i tejkalojë këto nivele të rezonimit momental shteti synon të gjejë zgjidhje të tilla institucionale dhe të mos bjerë pre e presioneve të atypëratyshme të qytetarëve për të ofruar zgjidhje.

Unë po shoh këtu shumë kërkesa, ftesa nga deputetët që mbështetnin kërkesat e qytetarëve.

Qytetarët mund të ofrojnë zgjidhje për probleme, qytetarët ngrenë shqetësime, artikulojnë probleme, artikulojnë nevoja, shteti është aty për të ofruar zgjidhje dhe nëse ne ofrojmë zgjidhje, qysh e thashë edhe më herët, afatshkurtra duke prodhuar probleme afatgjata dhe pastaj përfundojmë në një shtet, të cilin qysh edhe po shohim, e kemi problem t'i japim fund modelit të funksionimit institucional të këtij shteti, sepse është i ndërtuar fatkeqësisht mbi një logjikë të tillë, sot për nesër.

Unë nuk jam ekonomist, por u përpoqa të kem një vëmendje maksimale në relacion me argumentet që ofruan ekonomistët nga të gjitha grupet parlamentare dhe sinqerisht po e them, argumentet të cilat e mbështesin ruajtjen e funksionalitetit institucional, duke mos e lejuar

krijimin dhe ushqimin e një modeli që gërryen në mënyrë të vazhdueshme strukturat institucionale të shtetit, mendoj që janë argumente shumë më bindëse.

Dhe, në fund të fundit, ajo që më së shumti mua po më shqetëson është, isha duke menduar nëse kjo është në fund të fundit krejt në nivel taktizimi politik i opozitës që ta paraqesë qeverinë sa më të dobët përball qytetarëve, sa më anti-qytetar, për shkak se nuk po lejon tërheqjen e parave të tyre, ani pse ishte një argument shumë interesat që në fakt këto nuk janë krejt paratë e qytetarëve të trustpaguesve, po janë edhe paratë e punëdhënësve. Problemi nuk qenka bash-bash ashtu bardhë e zi, është goxha më i nuancuar.

Shqetësimi, pra, nuk është më aty nëse kemi të bëjmë me taktizim politik, shqetësimi për mua është këtu përnjëmend po mendohet që kjo është zgjidhje e njëmendtë e problemeve financiare të qytetarëve të Kosovës dhe kjo më pastaj po e ushqen logjikën për zgjidhje afatshkurtër, zgjidhja afatshkurtër e problemeve të qytetarëve instalon probleme afatgjata që e dëmtojnë edhe funksionalitetin institucional.

Përndryshe, në fund të fundit, kemi ballafaqim të argumenteve dhe në fund vota vendos, ama qytetarët duhet ta kuptojnë që deputetët, të cilët votojnë kundër tërheqjes së Trustit, në mënyrë absolute nuk janë kundër interesave të tyre, përkundrazi janë pro mbrojtjes së interesave afatgjata të tyre, të shoqërisë dhe shtetit, duke mos lejuar improvizimin me politika afatshkurtra në adresimin e problemeve financiare të qytetarëve. Faleminderit!

KRYETARI: Tash fjalën e ka Mërgim Lushtaku.

MËRGIM LUSHTAKU: Të dashur qytetarë,

Të nderuar kolegë,

Kabinet qeveritar,

Së pari dua të ngre një shqetësim shumë të madh, që edhe disa deputetë para neve e potencuan. Vërshimet janë shumë të mëdha në Skenderaj, Mitrovicë, Vushtrri, Istog, në Pejë e në Dukagjin në përgjithësi dhe në shumë qytete të tjera dhe besoj që në këtë drejtim të gjithë deputetët jemi që të ketë një mbështetje më të madhe. Edhe Qeveria, edhe institucionet, siç është Agjencia e Menaxhimit të Emergjencave, por jo vetëm, edhe FSK-ja, edhe rezervistët, në këtë rast, është mirë që të reflektojnë dhe të angazhohen që t'i mbështesin familjet në nevojë.

Unë tash e pata një thirrje nga një familje, e cila për fat të keq është dashur të pozicionohet në katin e dytë për shkak të vërshimit të madh në Skenderaj, po ashtu edhe në Mitrovicë. Prandaj, me të vërtetë është gjendje e jashtëzakonshme dhe sigurisht që edhe Trusti është temë e ndjeshme, nuk është vetëm e sodit. Prandaj, në këtë drejtim sigurisht që ne duhet sa më shpejt edhe sa më parë t'i thërrasim jo vetëm institucionet, por edhe të gjithë vullnetarët, të cilët mund t'i ndihmojnë qytetarët në këtë kohë krize.

Sa i përket temës, i kam dëgjuar me vëmendje të gjithë deputetët e pozitës dhe të opozitës. Ne e dimë shumë mirë që peticioni i nënshkruar mbi 21 mijë qytetarë të Republikës së Kosovës e ka sjellë në temë diskutimin në Kuvend dhe e ka bërë top temë të Kuvendit dhe të vitit 2023. Nuk besoj që është kërkesë, dhe ju e dini shumë mirë që nuk është vetëm kërkesë e një bindje politike, por është kërkesë e nevojave të qytetarëve për shkak krizës së madhe ekonomike që nuk është vetëm si pasojë e keqqeverisjes së Qeverisë Kurti, por edhe për shkak të krizës globale, në përgjithësi.

Prandaj, ne duhet të diskutojmë dhe t'u bëjmë thirrje për reflektim të gjithë deputetëve, pavarësisht bindjeve politike, pavarësisht orientimit të djathtë apo socialist, të majtë, në këtë drejtim që të reflektojmë në nevojat reale të qytetarëve. Derisa për shkak se ka pasur disa iniciativa ekonomike nga Qeveria dhe nuk kanë rezultuar efektive në ndihmën e qytetarëve, detyrimisht edhe ne si deputetë dhe si përfaqësues të popullit duhet të jemi me një qëndrim që jodomosdoshmërisht është në pajtueshmëri të plotë me kërkesën e qytetarëve, por i japim dritën jeshile që të diskutohet në komisione dhe të ketë një ndryshim sado pak në mbështetje të këtyre familjeve që çdo ditë gjenden në krizë më të madhe dhe po ka edhe humbje të mëdha të vendeve të punës.

Kemi bërë rekomandime të shumta jo vetëm ne si opozitë, kanë bërë edhe shumë qytetarë e ekspertë dhe, fatkeqësisht Qeveria ka qenë e shurdhët në këto kërkesa, si kur ka qenë për largimin e TVSH-së për produktet elementare, sikur ka qenë heqja e akcizës për naftë, largimi i TVSH-së për lëndën e parë për produktet elementare dhe ato të sektorit të bujqësisë, e tjerë, e tjerë.

Ne gjatë diskutimit kemi pasur edhe në Komisionin për Buxhet, Punë dhe Transfere, e thirrur ka qenë edhe BQK-ja dhe Fondi Pensional i Kosovës, ku kemi marrë informata të sakta dhe ku si informatë të rëndësishme që dua të potencoj dhe të ndaj me ju është që qytetarët e Republikës së Kosovës janë 4,5 miliardë në kredit. Vetëm në vitin 2022 mbi 1,5 miliard euro janë në kredi, sa e sa qytetarë janë në borxhe të ndryshme që nuk i kemi në numra apo në statistikë të prezantuara, e sa e sa fatkeqësisht i kemi në fajde të ndryshme që kanë marrë para, fatkeqësisht, e realisht në këtë drejtim nuk kemi statistika, vetëm në rastet e Policisë çfarë kanë mundur t'i prezantojnë.

Në këtë drejtim, edhe kreditë apo interesi i bankave është rritur fatkeqësisht dhe kemi kërkesa dhe shqetësime të qytetarëve që janë shfrytëzuar mjaft mirë nga bankat në këtë drejtim dhe në dëme të qytetarëve pjesa e rritjes së interesit të kredive.

Thanë edhe më herët, edhe shumë kolegë që mbi 120 milionë ka qenë humbja në Fondin Pensional për vitin kalendarik 2022. Ne mund t'i themi zbritje apo ngritje, po realiteti është në çdo vit kalendarik llogaritet humbja apo fitimi, Trusti apo Fondi Pensional i Kosovës dëshmohet se ka pasur humbje në vitin 2022 dhe ne sigurisht që nuk po kërkojmë asgjë tjetër, vetëm që të

kemi një mundësi që të debatojmë edhe në komisione dhe t'u japim dritën jeshile të gjithë atyre që kanë nënshkruar petitionin.

Në diskutime të ndryshme u përmendën që ka pasur edhe rritje të pensioneve 10 euro. Besoj që ju e dini edhe te vezët ka pasur rritje dhe me këto 10 euro nga pensionistët as dy komplet ve nuk mund t'i blesh dhe kjo është maltretim edhe në aspektin e argumentimit se si mundohen të pasqyrojnë ngritjen edhe mbështetjen e pensionistëve në këtë drejtim.

Duke qenë që kemi para vetes një petition nga qytetarët e Republikës së Kosovës, kemi dëshmuar që e mbështesim këtë iniciativë, por thashë edhe më herët, pavarësisht çfarë është kërkesa e qytetarëve, unë mendoj që duhet të kemi një reflektim mbipartiak dhe të japim mundësinë në këtë seancë të dërgojmë në lexim të dytë dhe të ndryshojmë, qoftë edhe me një kompromis të përbashkët mes partive politike.

Prandaj, ftoj që me të vërtetë të mbështesim këtë iniciativë dhe jo vetëm të ketë një mbështetje për këta kontributdhënës, të cilët indirekt e mbështesin edhe çdo familjarë të tyre, çdo student të tyre, çdo pensionist të tyre dhe, besoj që edhe në formën direkte apo indirekte do të ndikojë drejtpërdrejt te shteti apo të hyrat e shtetit në përgjithësi. Faleminderit!

KRYETARI: Tash po ia japim fjalën deputetit Agim Veliu.

AGIM VELIU: Faleminderit, i nderuar kryetar!

E mora fjalën për shkurt, 2-3 fjali.

Qytetarët e Republikës, të cilët kanë pjesëmarrje në Trust, sot presin nga ne nga, të gjithë deputetët pa përjashtim, pozitë-opozitë, kërkesa nuk është vetëm e atyre 21 mijë qytetarëve që e kanë nënshkruar këtë nismë ligjore, por besoj që e me tepër qytetarëve.

Arsyet, argumentet pse duhet t'u kthehen një pjesë e mjeteve qytetarëve u elaboruan nga shumë folës këtu dhe nuk dua t'i përsëris. E mora fjalën që t'i lus të gjithë deputetët ta mbështesin nismën e qytetarëve nënshkrues dhe të votojnë plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për fondet pensionale të Kosovës, i cili u mundëson kontribuuesve që t'u kthehet një përqindje e mjeteve të kursyera.

Unë po e deklaroj votën time, do të votoj për ndryshimin dhe plotësimin e këtij ligji. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën ia japim tash deputetes Jeta Statovci.

JETA STATOVCI: Faleminderit, i nderuar kryetar!

I nderuar Kabinet qeveritar,

Të nderuar të pranishëm,

Nëse e shkojmë ekonominë si tërësi lirisht mund të themi që nevoja për mjete financiare është e përhershme, pra ekonomia kur nuk arrin një pikë ku qytetari nuk ka nevojë për mjete. Mirëpo, çështja e nevojës për mjete financiare është e ripërsëritshme, pra kemi përballje me dimrin, mirëpo dimri vjen përsëri, e nevojat përsëriten vazhdimisht.

Tash si filozofi u cek edhe më herët që ekziston edhe tendenca e sjelljes në impulsivitet. Në ekonomi shpeshherë shtjellohet çështja që para ja e ditës së sotme vlerësohet më shumë se sa ajo në të ardhmen. Mirëpo, duke e ditur këtë filozofi edhe këtë sjellje të njeriut, edhe shteti krijon mekanizma që disa sjellje tenton t'i stimulojë, e disa sjellje tenton t'i dekurajojë, duke e ditur që në një periudhë kohore individit për shkak edhe të moshës, arrin në një pikë ku nuk ka aktivitet ekonomik, kjo ndikon gjithashtu edhe në mirëqenien e tij.

Andaj, për problemet e sotme zgjidhja nuk do të ishte të marrim nga mirëqenia e së nesërme, pra pikërisht atëherë kur jemi më së shumti në nevojë, e pikërisht atëherë kur edhe kostoja e jetesës tonë rritet, e kjo përcillet edhe me ne duke mos qenë në aktivitet ekonomik.

Përveç kësaj, si filozofi, ne nëse e diskutojmë çështjen e problematikave që ka sot personi edhe qytetari, ne shohim që faktikisht kjo nuk është zgjidhje, sepse nëse e shikojmë strukturën edhe të Trustit ne kuptojmë që diku ato mjete janë të konspektuar pikërisht tek individët të cilët kanë pasur aktivitet ekonomik, domethënë kanë punuar një periudhë të gjatë, të cilët me siguri kanë edhe një situatë ekonomike më të favorshme, andaj kanë arritur të grumbullojnë edhe mjete të kursimeve në Trust.

Pra, diku rreth 9,6% e këtyre kursimeve të këtyre kontributdhënësve në këtë përbërje marrin rreth 42%, një total i 9,6% ose 10% të kontributdhënësve janë në gjendje ose kanë kontrollin e 42% të mjeteve. Kurse më shumë se gjysma në tërësi mund t'i marrin 100 euro. Nëse e analizojmë se ku targetohet dhe kush janë përfituesit më të mëdhenj të kësaj politike, atëherë i bie pikërisht që të shkojnë mjetet aty ku nuk është nevoja, po pikërisht tek ata, të cilët kanë pasur aktivitet ekonomik. Këtu, siç u tha edhe më herët, pra studentët, pensionistët edhe kategoritë sociale edhe ata pa kontrata pune tërësisht mbesin të lënë anash.

Për përmbush këtë ne kemi parë që Qeveria ka pasur vazhdimisht një qasje proaktive, ku janë disbursuar rreth 250 milionë duke targetuar, pra është bërë një rishpërndarje, mirëpo rishpërndarje në bazë të nevojës, aty ku është nevoja më e madhe, aty të bëhet edhe disbursimi i mjeteve, e jo një politik e cila mjetet i derdh pikërisht tek ata që kanë dhe që kanë pasur aktivitet ekonomik dhe kanë kursime në llogaritë e tyre.

Problematika e radhës është se kur futen në ekonomi rreth 600 milionë euro, këto nuk mbesin të izoluara, këto rrisin kërkesën, këto e rrisin konsumin në ekonomi, e konsumi e kërkesa pastaj

ndikon edhe në rritjen e çmimeve. Kategoritë, të cilat kanë më së shumti nevojë, mbeten dy herë të penalizuara: një herë për faktin që nuk kanë kursime, e fakti i dytë është që përballen edhe me çmime më të rritura, për arsye që pjesa tjetër e shoqërisë ndikon edhe në çështjen e inflacionit dhe në çështjen e çmimeve.

Gjithashtu edhe në kuadër të Komisionit për Buxhet ne kemi pasur diskutime edhe me përfaqësues dhe nëse ka ndonjë shembull, edhe neve të na i qartësojë argumentet që kishim dhe u tha që vetëm vende diku si Venezuela kanë pasur praktika të tilla, po ata faktikisht i kanë ndaluar këto praktika, sepse ka shkuar edhe jo në targetim të mirëfilltë ekonomik, mirëpo gjithashtu edhe në dëm të ekonomisë, duke shkaktuar inflacion dhe duke mos targetuar ata që më së shumti kanë nevojë.

E dhimbshmja e kësaj është se në një situatë ku Kosova ka ekonominë e saj të brishtë, kjo për arsye të cilat derivojnë për një periudhë të gjatë kohore, tentohen të ndërtohen pra pikërisht kauza politike duke tentuar të prekin qytetarin në xhep dhe duke tentuar që të bëjnë një zgjidhje sot, duke dëmtuar të ardhmen e tij. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën ia japim deputetit Bekim Haxhiu.

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Shumë i nderuar Adnan Jashari, përfaqësues i qytetarëve të grupit pro tërheqjes së 30%.

Të nderuar kolegë,

Më lejoni që sot në cilësinë tani të deputetit të flas pak për këtë kërkesë, ndonëse nuk e kisha në plan që të diskutoja, mirëpo shumë qytetarë në ndërkohë më shkuan dhe kërkuan që të adresoj disa prej shqetësimeve të tyre.

E para, ju ftoj, të nderuar kolegë, që deri në fund ta ruani nivelin e debatit, të mos e deformoni apo degradoni atë si dhe rolin dhe rëndësinë e deputetit si përfaqësues të popullit.

Sot edhe në këtë diskutim timin nuk do të flas për Qeverinë, sepse jam shumë i interesuar për të ndërtuar një konsensus në Kuvend për këtë temë kaq të rëndësishme dhe këtë kërkesë të qytetarëve.

Do të kemi kohë prapë të flasim për turpin e Qeverisë dhe sot nuk do të flas për ato, as nuk befashem se Qeveria e quan kërkesën e qytetarëve ‘populliste’, sepse vlerësimin për këtë temë kaq të dijshme e bënë nga zyrat luksoze të saj.

Të nderuar kolegë deputetë,

Nuk do të duhej që ju të shndërroheshit në marionetat e Qeverisë, sepse këtu jeni për ta mbikëqyrur punën e saj. Vetëm një deputet i shefit apo i shefes mundet që iniciativën e qytetarëve ta quajë ‘populliste’. Tani, vërtet kërkesa është e popullit, nisma legislative është e qytetarëve, buron nga populli dhe çka ka të keqe këtu. Ne këtu jemi të votuar prej popullit dhe duhet të mbështesim kërkesat e drejta të tyre. Mund ta quajmë edhe kauzë, por është kërkesë e drejtë e qytetarëve. Këtë e dëshmojnë 21 398 nënshkrime të mbledhura anekënd Kosovës në një periudhë rekorde.

Më lejoni t’jua lexoj disa reagime, ose kërkesa, të qytetarëve, që më kërkuan t’ua lexoj këtu.

“I nderuar deputet,

Jam prind duke shkolluar dy studentë. Nga ato mjete duhet t’i paguaj studimet e tyre, ose më duhet të hyj në kredi, pastaj t’ua paguaj bankave haraçin.

I nderuar deputet Haxhiu,

Nëse ke mundësi prapë ta marrësh fjalën, të lutem tregoje realitetin që do t’jua shpjegoj më poshtë.

Unë kam punuar 21 vjet pas lufte dhe kam paguar Trust, por në ndërkohë me një rrogë kam rritur dhe shkolluar tre fëmijë dhe kam shikuar prindërit, të cilët deri në 65 vjet nuk kanë marrë asnjë pension. Tash, kur unë kam përfunduar shumicën e këtyre punëve me familjen, kam bërë edhe një moshë me të cilën edhe nuk mund të punoj, por me fëmijët e rritur pa punë, me dy pensionet e prindërve nga 182 euro, nuk kam mundur të bëj një operim për vete, derisa më është lejuar 10% e tërheqjes së mjeteve nga Trusti.

Pra, i nderuar deputet, tregoj kolegeve rëndësinë e tërheqjes së mjeteve nga Trusti”.

Shkruan D. S., një qytetar i Republikës së Kosovës.

Të nderuar kolegë deputetë,

Një qytetar tjetër më shkruan për policin me inicialet B.R., që shërbeu në veri dhe familjarët e miqtë kanë kërkuar ndihmë për trajtim jashtë vendi.

Të nderuar kolegë,

Kriza, nevoja ka shtyrë qytetarët për të kërkuar tërheqjen për disa nga kursimet e tyre, por më lejoni, për shkak të shumë pasaktësive që u thanë këtu nga disa, t’jua jap disa informata për Trustin.

Shpenzimet e Trustit në vitin 2021 ishin hiç më pak se 8 492 000 euro dhe prej tyre, të nderuar kolegë deputetë, 6 840 000 euro u paguan taksë menaxhuese, ndërsa menaxhimi zero.

1 191 000 euro ishin shpenzimet operacionale dhe prej tyre për pagat bruto për Trustin, për stafin, janë paguar 653 595 mijë euro, apo 28 500 për punëtor mesatarisht në vit. Kurse, vetëm Bordi i Trustit paguhet 10 716 euro në muaj. Pra, me këtë mund ta shihni menaxhimin e mjeteve nga Trusti, nga Bordi, prandaj nevoja që vërtet të mbështeten qytetarët është e domosdoshme.

Pagesa vjetore e kontributeve, ata që dalin në pension në fund të vitit 2021 ishte 49 500 000 euro, andaj nuk qëndron e thëna se Trusti mund ta humbë likuiditetin, apo se mund të kolapsojë.

Të nderuar kolegë,

Mos lejoni që të humbisni seriozitetin tuaj vetëm sa për të dalë në krah të Qeverisë, sepse me një fond të kursimeve pensionale me 2.4 milionë euro nuk kolapsohet me 49 milionë euro në vit. Ju lutem! Trusti nuk do të kolapsojë as me tërheqjen e këtyre mjeteve, nuk do të kolapsojë as në të ardhmen. Është e vërtetë që qytetarët dhe familje të shumta në Kosovë mund të falimentojnë dhe të varfërohen për çdo ditë.

Unë prita, të nderuar kolegë, që të paktën një anëtar i Lëvizjes Vetëvendosje sot të prezantonte programin e Lëvizjes Vetëvendosje për skemat pensionale. Ata shtatë hapat e famshëm konkretë, që i quanit dikur, dhe pasi që i harruar, më lejoni t'ju rikujtoj shkurtazi:

1. Keni premtuar caktimin e kontributit shtesë, tregun e punës, nga 5 + 5% në 8 + 8%,
2. Themelimin e Fondit Pensional,

Po jua numëroj vetëm temat, të cilat i keni kërkuar.

3. Hapjen e tregut pensional obligativ,
4. Investimet obligative e 1%-je të fondit në Kosovë, gjë që nuk po ndodh,
5. Caktimi i një kthimi minimal në investime 3%,
6. Pastrimi i listës së pensionistëve, dhe
7. Llogaritja e përshkallëzuar e pensionit bazë.

Që të respektoni premtimet tuaja, duhet ta votoni këtë iniciativë të qytetarëve, që bashkë pastaj të punojmë në reformën pensionale, sepse këtë që unë po e prezantoj, edhe ju e keni premtuar dikur në fushatë, e keni të postuar në ueb-faqen tuaj dhe është kërkesë e qytetarëve që të votohet Trusti e të punojmë bashkë në reformën pensionale.

Prandaj, po kërkoj një konsensus të të gjithëve, sepse ky konsensus do të ketë nevojë edhe më tutje. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka Blerta Deliu-Kodra.

BLERTA DELIU-KODRA: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Qytetarë të Republikës së Kosovës,

E di që janë bërë shumë diskutime dhe mbase janë thënë shumë gjëra dhe po them se nuk duhet të jesh ekonomist për të parë se gjendja e qytetarëve të Kosovës sot nuk është e mirë.

Secili sot kemi familjarë, kemi takime e kemi njerëz, që takojmë në baza ditore, e njëra prej shqetësimeve më të shprehura ditëve të fundit është pikërisht çështja e Trustit. U tha këtu që është shteti ai që duhet të mos dorëzohet e të ofrojë zgjidhje, e unë po them që pikërisht për shkak të pamundësisë që ky shtet e kjo Qeveri ta kryejë detyrën e vet për t'u dalë në ndihmë qytetarëve të Kosovës, ne sot e kemi një gjendje të rëndë, me të cilën sot po përballen qytetarët me çmime të larta, me paga të ulëta dhe ajo çka po i ndodh sot Kosovës është fakti se Qeveria ka arritur që ta shndërrojë këtë vend në një vend të pasigurt, në një vend të pajetueshëm për qytetarët e saj, jeta e të cilëve çdo ditë e më shumë po bëhet më e rëndë.

Dhe, kolegë deputetë, mos e kuptoni fare si polemikë e as politikë e një kërkesë që vjen prej 21 000 qytetarëve, të cilët kanë emër, mbiemër e kanë adresë, e të cilët mbase mund të mbajnë familjet e tyre. Prandaj, mos e kërkonin si një kërkesë politike nevojën e njëzetënjëmijë vetëve që t'i adresohen këtij Parlamenti, sepse unë jam e bindur që ata njëzetënjëmijë qytetarë janë votues të të gjitha partive politike, por besoj se edhe të partisë që sot udhëheq vendin.

Pra, çmimet janë trefishuar në krejt artikujt dhe ne shohim, secili çdo ditë, që shporta familjare është 30% më e shtrenjtë dhe kjo natyrisht që e bën gjendjen shumë më të rëndë, mbijetesën e familjeve të varfra dhe natyrisht edhe shtresa e mesme është ajo që atakohet dhe kjo po e dobëson edhe kualitetin e jetës së qytetarëve të Kosovës.

Pra, çka shohim sot është, shohim varfëri, shohim më shumë krizë ekonomike, çmime të larta, papunësi. E shqetësim i madh, që duhet të adresohet e që lidhet edhe me këtë çështje është ikja masive e qytetarëve të Kosovës. Në krejt këtë gjendje qytetarët e Kosovës kanë mbetur pa shpresë. Pra, në mungesë të politikave zhvillimore, që do të duhej t'i bënte Qeveria, fatkeqësisht ikja e qytetarëve të Kosovës është shndërruar në një dukuri të tmerrshme.

Merreni me mend, veç në vitin 2021 Kosovën e kanë lëshuar 42 728 qytetarë, që i bie se çdo muaj vendin tonë e lëshojnë 3500 qytetarë të Kosovës. Çdo ditë prej Kosovës largohen 116 qytetarë.

Dhe, më thoni se pse do të duhej në rrethana të një ekonomie, ku njerëzit jetojnë me një mirëqenie të mirë dhe ku jetesa e kualiteti i jetës në Kosovë do të duhej të ishte i mirë, pse do të duhej të kishte një trend të frikshëm të qytetarëve që nuk e shohin perspektivën në vendin e tyre?

Pra, në vitin 2022 statistikat ende nuk i kemi, kjo shifër do të jetë edhe më e lartë. Pra, shihni listën e qytetarëve që sot janë në pritje në ambasada për të marrë një vizë e për ta lëshuar vendin e tyre. 56 000 qytetarë kanë aplikuar për vizë vetëm në dhjetor të vitit 2021 në Ambasadën Gjermane. Dhjetor e janar 2021 e 2022 në Ambasadën Gjermane kanë aplikuar gjithsej 105 mijë qytetarë.

E çka i thuhet krejt kësaj gjendjeje, kolegë deputetë, përveçse eksod e largim masiv nga Kosova. Dhe, qytetarët largohen nga atdheu i tyre, atëherë kur shpresa për të ndërtuar jetën në Kosovë është shuar.

E, në anën tjetër, ne e kemi kryeministrin, i cili në rolin e tij si analist na konstaton se po, ky është një problem shumë i madh. Dhe, kjo është e tëra që mund të bëjë e të ofrojë kryeministri anë. Pra, zhgënjimi i qytetarëve është shumë i madh, e për shkak të pritjeve të mëdha që kryeministri ka krijuar ndër vite, janë pritje që janë ndërtuar gjatë fushatave, ku ai ka premtuar çdo gjë e sot zhgënjimi është më i madh se asnjëherë.

Përveç kësaj, kryeministri s'po ndalet me kaq. Ai po na thotë që tregut të Kosovës i mungojnë kuzhinierë të trajnuar, i mungojnë muratorët, i mungojnë frizerët, në ndërkohë që dy vjet kjo Qeveri s'e ka marrë asnjë hap të vetëm që kërkesat e tregut t'ia përshatë sistemit arsimor në Republikën e Kosovës. Pra, krejt çka bën Qeveria është fraza, premtime, manipulime. Slogani "Punësim dhe drejtësi", sot duket kështu. Pra, ky slogan duket "eksod dhe shtypje".

Të gjithë e dimë, kolegë deputetë, se tërheqja e mjeteve nga Trusti mbase mund të mos jetë edhe një zgjidhje ideale, mund të mos jetë edhe një zgjidhje më e mira për të sanuar gjendjen e rëndë, ekonominë e rëndë, familjet e varfra, pensionistët, ato familje që kanë studentë, ato familje të cilat mezi arrijnë të mbyllin muajin e tyre, por kur Qeveria nuk ka asnjë zgjidhje tjetër kreative, çfarë i mbetet këtij Parlamenti e kësaj mazhorance, përveçse të mbështesë njëzetënjëmijë qytetarë të Republikës së Kosovës, të cilët u janë adresuar përfaqësuesve të tyre në këtë Parlament.

Fundja, këto janë mjete të qytetarëve dhe më e pakta që mund të bëjnë është që të mos i pengojnë ata, që ata të marrin mjetet e tyre. Pra, ky Parlament nuk ka nevojë që ta shohë si pengesë mundësinë që secili të ketë qasje në mjetet e tyre. Nuk po them që është zgjidhje ideale, megjithatë unë dua të vlerësoj kontributin e kolegut Haxhiu që ka qenë sistematik për të qenë zë i atyre, për të cilët kjo Qeveri po hesht në vazhdimësi. Kjo Qeveri e ka mbyllur derën. Kryeministri nuk është as sot dhe nuk është fare në Kosovë për t'u dhënë përgjigje skandaleve të panumërta që sot ne i kemi, të njëpasnjëshme. Dhe, kur hallet e qytetarëve janë në rritje, ne sot po themi se po bëjmë politikë njëri me tjetrin, kurse e vërteta është që nuk kanë jetuar asnjëherë më keq, që ikja e kuadrove, mjekëve, profesionistëve, asnjëherë nuk ka qenë më madhe, që pritjet në ambasada nuk kanë qenë asnjëherë më të mëdha për të marrë një vizë dhe që, natyrisht,

kemi një eksod të tmerrshëm për shkak të pasigurisë, paqëndrueshmërisë, mosefikasitetit që kjo Qeveri e ka për t'u dalë në ndihmë kërkesave të qytetarëve.

Pra, nëse nuk mund të bëjmë mirë, të paktën sot të mos bëjmë keq dhe t'i ndihmojmë ata njerëz, që sot i kanë sytë tek ne. Mos e merrni fare si politike. Po flas veç si një deputete që dua t'i adresoj disa kërkesa që i kanë me të drejtë njerëzit që mezi e kalojnë muajin sot.

KRYETARI: Fjalën ia japim deputetes Floretë Zejnullahu.

FLORETË ZEJNULLAHU: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Të dashur qytetarë,

Ky pushtet po thëllon krizën dhe varfërinë e familjeve kosovare. Tash e dy vjet qytetarët po vazhdojnë të përballen me krizë dhe vështirësi të njëpasnjëshme, andaj kanë nevojë urgjente për ndihmë.

Të nderuar kolegë deputetë,

Qytetarët po goditen nga efektet e pamëshirshme të krizës ekonomike dhe veçmas nga rritja e çmimeve. Prandaj, përveç rritjes së pagave, tërheqja e kursimeve nga Trusti është zgjidhja aktuale për ta ndaluar varfërimin e mëtejshëm të qytetarëve.

Familjet po varfërohen muaj pas muaji dhe si asnjëherë më parë gjendja e tyre është e rënduar. Buxheti i familjeve kosovare po zvogëlohet e shporta me prodhime bazë të jetesës është zvogëluar. Qytetarët gjithashtu, po shpenzojnë me qindra e mijëra euro nga xhepi i tyre për të blerë barna, të cilat shteti nuk po mund t'ua sigurojë.

Kjo është krizë që nisi me pandeminë, vazhdoi me energjinë elektrike, me reduktime dhe shtrëngime dhe tani e sa muaj me ngritje marramendëse çmimesh dhe rekorde të zeza inflacioni.

Tërheqja e Trustit sot është nevojë, nuk është luks, ashtu siç po deklarojnë disa. Në këtë krizë të madhe ekonomike të gjitha familjet po mundohen të gjejnë rrugën e ekzistencës dhe mbijetesës për t'i mbuluar shpenzimet dhe për të kryer obligimet ndaj shtetit. Rreth 700 mijë qytetarë të Kosovës, të cilët janë kontributdhënës kanë të drejtë të vendosin vetë nëse duan t'i tërheqin kursimet e tyre apo jo. Ne sot duhet të votojmë pro.

Trusti sot mund të jetë zgjidhje afatshkurtër për problemet e qytetarëve, që ju nuk i keni adresuar, e ju si Qeveri e keni për obligim që të bëni politikën afatgjatë për qytetarin, për fondin shëndetësor dhe për mirëqenien e tyre në përgjithësi.

Prandaj, ftoj të gjithë kolegët deputetë që ta mbështesin dhe të votojnë pro Projektligjit për Trustin, sepse ne jemi të zgjedhur me votë nga qytetarët dhe duhet të votojmë për kërkesën e qytetarëve që ua mundëson tërheqjen e mjeteve nga Trusti, pasi që është kërkesë e tyre, sepse besoj që shumicës prej juve këtu sot keni pranuar me qindra mesazhe prej qytetarëve, kërkesë e të cilëve është që të votojmë pro Trustit. Faleminderit!

KRYETARI: I fundit e ka fjalën propozuesi, përfaqësuesi i propozuesit, më saktë.

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, kryetar!

Tani më lejoni që në cilësinë e përfaqësuesit zyrtar të qytetarëve nënshkruar të kësaj iniciative, që me autorizimin e tyre më kanë nderuar fillimisht që ta prezantoj kërkesën e tyre dhe në fund të jap edhe vlerësimet dhe sugjerimet e qytetarëve, që kanë proceduar në Kuvend këtë nismë legjislative.

Fillimisht, në emër të tyre, në emër të qytetarëve nënshkruar, 21 398 prej tyre, ju falënderoj për diskutimet, për të gjitha ato fjalime që ishin përmbajtjesore dhe që ishin në frymën e kërkesës së qytetarëve për lejimin e tërheqjes deri në 30% të mjeteve nga Trusti.

Sot është e rëndësishme që në emër të qytetarëve ne të gjithë bashkë ta votojmë këtë kërkesë të qytetarëve, ta votojmë në lexim të parë këtë nismë legjislative për Trustin, pastaj në mes dy leximeve të gjithë bashkë ta pasurojmë këtë iniciativë ligjore me ide që sot u prezantuan këtu dhe të jemi unikë bashkë, të gjithë në këtë iniciativë, që pastaj në lexim të dytë të jetë edhe një lloj feste për qytetarët.

Të nderuar kolegë,

Në emër të qytetarëve nënshkruar pro tërheqjes së 30% të Trustit, po ju ftoj që të ndërtojmë një konsensus për kërkesën e tyre. Votimi në lexim të parë e hap rrugën për plotësimin dhe për pasurimin e kësaj iniciative të qytetarëve me propozimet e të gjithë deputetëve, që sot vërtet disa prej tyre dhanë një kontribut të rëndësishëm në këtë iniciativë ligjore.

Konsensusi dhe uniteti do t'i duhen këtij Kuvendi edhe në të ardhmen. Do t'i nevojitet konsensusi këtij Kuvendi për shumë tema dhe ky është një momentum, që iniciativa legjislative e qytetarëve të fillojë ndërtimin e konsensusit përpara se të vijnë marrëveshje të rëndësishme ndërkombëtare, ose marrëveshje të natyrave të tjera, ose konsensusi, ideja për reformën pensionale.

Por, nëse sot, të nderuar kolegë, ju votoni kundër kërkesës së qytetarëve, unë si deputet i autorizuar nga qytetarët për ta prezantuar kërkesën e tyre, do të ma pamundësoni që të mbështes pastaj çdo iniciativë tuajën. Nëse ju për qytetarët nuk jeni në gjendje të votoni pro, atëherë cila është ideja që dikush i opozitës të votojë për projektligje të Qeverisë ose për marrëveshjet

ndërkombëtare, sepse edhe ato janë për qytetarët dhe kjo iniciativë është e qytetarëve, atëherë cila është më e rëndësishme, kërkesa e qytetarëve apo propozimet e Qeverisë?

Prandaj, po kërkoj votën tuaj për Projektligjin për Trustin, për këtë iniciativë të qytetarëve që të fillojmë të ndërtojmë konsensusin dhe unitetin e nevojshëm, se këtu të gjithë jemi të votuar nga qytetarët dhe ashtu siç jemi deklaruar edhe në të kaluarën që populli duhet të pyetet për do çështje. Populli e ka dhënë verdiktin e tij për Projektligjin për Trustin, na e ka sjellë në Kuvend këtë nismë legislative dhe tani është në dorën e Kuvendit të deklarohet për këtë.

Duke qenë se jemi përfaqësues të qytetarëve, atëherë vërtet duhet ta luajmë këtë rol, të jemi mbështetës të qytetarëve, përfaqësues të popullit, e jo të jemi të dirigjuar nga shefja apo shefi, sepse kështu mund të jemi vetëm në shërbim të qytetarëve nëse mbështesim kërkesat e tyre dhe të mos biem nën ndikimin as të shefes e as të shefit, sepse nuk do t'ju votojnë në zgjedhje as shefi e as shefja, do t'ju votojnë sërish qytetarët. Prandaj, votoni pro kërkesës së tyre.

KRYETARI: Të nderuar deputetë, po votojmë. Uluni nëpër vendet e juaja.

Tash na tregojnë sa jemi. Ulu Mimosë! Gati? 91 edhe një herë ma konfirmuan, kështu që e hedhim në votim këtë projektligj.

Projektligji për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për fondet pensionale të Kosovës.

Edhe një herë për herën e tretë t'i numërojmë. Për dhjetë ia paskemi huq. 101 deputetë jemi.

Kështu, 22 janë në këtë pjesën e LDK-së, 61 në këtë pjesën e mazhorancës, 18 janë Partia Demokratike dhe dy ne, pra 101. Kështu që, me të vërtetë një befasi kjo.

Përgatituni për votim. 101 deputetë të pranishëm.

Kush është për këtë projektligj?

Kush është kundër?

Kush abstenon?

Jo, janë këshilltarë të grupit parlamentar të mazhorancës. Vetëm 97 deputetë paskan votuar. Qetësi, ju lutem!

Vetëm 97 deputetë kanë votuar. Prej tyre 42 vota për, 55 vota kundër, asnjë abstenim. Konstatoj që projektligji në fjalë nuk kalon.

E shohim tash se sa deputetë mbetëm, pasi opozita e lëshoi sallën.

A mund të na tregoni se sa deputetë jemi tash dhe a mund ta vazhdojmë seancën?

A mund të uleni z. Kervan, Alban, Erxhan?

60 deputetë jemi tash. 61 deputetë jemi, mund ta vazhdojmë seancën.

5. Shqyrtimi i raportit me rekomandime për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit nr. 06/L-046 për Inspektoratin e Arsimit në Republikën e Kosovës

Të nderuar deputetë,

Komisioni për Arsim e ka bërë mbikëqyrjen e zbatimit të këtij ligji dhe Kuvendit ia ka rekomanduar miratimin e raportit që është bërë bashkë me rekomandime.

Këtë raport me rekomandime e prezanton raportuesja e cila është caktuar nga ky komision, deputetja Albena Reshitaj.

Urdhëroni znj. Reshitaj, apo nuk po punon mikrofonit? Po tash po.

ALBENA RESHITAJ: Faleminderit, kryetar!

Për shkak të angazhimit dhe punës sonë disamujore së bashku me Komisionin për Arsim e ndjeva obligim që ta prezantojë këtë punë që e kemi bërë të përbashkët. Pra, me qëllim të mbikëqyrjes së zbatimit të Ligjit nr. 06/L-046 për Inspektoratin e Arsimit në Republikën e Kosovës, Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Inovacion, Kulturë, Rinisë dhe Sport ka themeluar grupin punues në këtë përbërje:

Albena Reshitaj, kryesuese; Arjeta Rexhepi, Eliza Hoxha, Ardian Gola dhe Arijeta Fejza, anëtarë.

Ky aktivitet ishte paraparë në kuadër të planit të punës së Komisionit për Arsim. Puna e grupit punues është mbështetur me ekspertë nga organizata Demokracia Plus, të cilën e falënderojmë për bashkëpunimin.

Qëllimi kryesor i mbikëqyrjes së zbatimit të Ligjit nr. 06/L-046 për Inspektoratin e Arsimit në Republikën e Kosovës ishte vlerësimi i përgjithshëm i nivelit të zbatimit të ligjit, identifikimi sfidave dhe vështirësive që hasin institucionet përgjegjëse në zbatimin e këtij ligji, si dhe të rrisin nivelin e përgjegjësisë dhe llogaridhënies për zbatimin e ligjit në praktikë.

Objektivat e mbikëqyrjes së zbatimit të ligjit janë si në vijim: vlerësimi i përgjithshëm i zbatimit të ligjit për Inspektoratin e Arsimit, identifikimi i sfidave dhe vështirësive që hasin institucionet arsimore në zbatimin e këtij ligji, vlerësimi i efekteve të zbatimit dhe pasojave të moszbatimit efektiv të Ligjit për Inspektoratin e Arsimit, informimi i Kuvendit dhe komunitetit arsimor për nivelin e zbatimit të ligjit dhe nevojat eventuale për plotësimin e tij me akte nënligjore, nxjerrja e rekomandimeve për masat e nevojshme që duhet ndërmarrë nga institucionet për ta zbatuar në praktikë ligjin dhe bërë atë më funksional dhe praktik gjatë zbatimit.

Në funksion të realizimit të qëllimit dhe objektivave për mbikëqyrjen e ligjit, grupi punues ka ndërmarrë hapat në vijim: hartimi i planit të veprimit për mbikëqyrjen e zbatimit të ligjit, identifikimi i akteve nënligjore të nxjerra si detyrim i ligjit, analiza e përputhshmërisë së ligjeve në fushën e arsimit dhe akteve nënligjore me ligjin, hartimi i pyetësorëve mbi zbatimin e ligjit nga Ministria e Arsimit, nga Inspektorati i Arsimit, nga drejtoritë komunave arsimore dhe nga shkollat, vizita dhe takime me zyrtarë nga MASH, nga Inspektorati, nga drejtoritë komunale të inspektoratit dhe institucionet shkollore.

I tërë procesi në mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit nr. 06/L-046 për Inspektoratin e Arsimit në Republikën e Kosovës është realizuar mbi bazën e planit të veprimit të mbikëqyrjes, i hartuar nga grupi punues, e në të cilin kanë qenë të planifikuara dhe janë realizuar. Takimet e brendshme të grupit punues me qëllim të koordinimit dhe planifikimit të aktiviteteve, hartimi i planit të veprimit për mbikëqyrje, përgatitja e pyetësorëve për institucionet ligjzbatuese, takime zyrtare me përfaqësues të MASHI-t, Inspektoratin e Arsimit dhe me Sindikatën e Inspektoratit të Arsimit, takime zyrtare me drejtorë të drejtorive komunale të arsimit dhe vizitat nëpër institucionet shkollore.

Përfundime dhe rekomandime:

Grupi punues gjatë procesit të mbikëqyrjes së zbatimit të Ligjit nr. 06/L-046 për Inspektoratin e Arsimit në Republikën e Kosovës, ka evidentuar të gjeturat si në vijim:

Inspektorati i Arsimit ka nxjerrë akte nënligjore me qëllim që ligji të plotësohet dhe të ketë ngritje të efektivitetit të zbatimit të tij. Megjithatë, akoma nuk është plotësuar pakoja e akteve nënligjore të nevojshme për zbatimin efektiv të ligjit. Ligji përshkohet me disa probleme strukturore, organizative dhe përmbajtjesore që në masë të madhe e pengojnë punën e Inspektoratit të Arsimit në disa procese.

Problemet në masë të madhe janë identifikuar nga vetë Inspektorati i Arsimit dhe se kanë të bëjnë me punën në zbatim praktik të këtij ligji. Ka kolizion të legjislacionit për sa i përket rekrutimit të mësimitdhënësve, ku për të njëjtën çështje parashihen procedura të ndryshme në

Ligjin nr. 03/L-068 për arsim në komunat e Republikës së Kosovës, Ligjin nr. 04/L-032 për arsimin parauniversitar, Ligji nr. 03/L-212 të punës dhe Ligjin nr. 06/L-114 për zyrtarët publikë.

Në përgjithësi, udhëzimet administrative të hartuara në bazë të Ligjit për Inspektoratin e Arsimit që përveç aspekteve të tjera që rregullojnë, përcaktojnë edhe detyrat dhe përgjegjësitë e Inspektoratit të Arsimit. Sidoqoftë.

KRYETARI: Ia shtoni kohën e fjalës deputetes.

ALBENA RESHITAJ: Sidomos, ekzistojnë disa dispozita që duhet të rishikohen dhe të reflektojnë ndryshimet e sjella nga ligji, veçanërisht për sa i përket kompetencave, rolit të Inspektoratit në proceset e vlerësimit dhe licencimit si dhe ndryshimeve në nivelin e raportimit.

Nga zbatimi i Ligjit për Inspektoratin e Arsimit, fokusi i punës së Inspektoratit të Arsimit është në përmbushjen e përgjegjësiave ligjore për vlerësimin e performansës së mësimdhënësve dhe vlerësimin e jashtëm të performansës së shkollave. Një numër i vogël i mësimdhënësve, rreth 775 kanë kaluar në procedurat e vlerësimit të performansës dhe kemi numër të vogël të shkollave që kanë kaluar në procedurat e vlerësimit të jashtëm të performansave të shkollave. Të dy këto procese raportohen të ndjeshme dhe të komplikuar për të arritur mbulueshmërinë e gjithë mësimdhënësve dhe shkollave brenda pesë viteve pasi që nga marsi i vitit 2020 nuk është kryer asnjë vlerësim.

Inspektorati i Arsimit akoma nuk ka arritur të profilizohet sipas strukturës në njësi të Inspektoratit Administrativ dhe në njësi të Inspektoratit Pedagogjik. Në anën tjetër, neni 24 për sanksionet kundërvajtëse me gjobë janë nene për të cilat Inspektorati i Arsimit ka paraqitur sfidë në zbatim, në kundërshtim me Ligjin për kundërvajtje.

Inspektorati i Arsimit akoma nuk është plotësuar me numrin e inspektorëve të lejuar dhe të nevojshëm dhe në këtë mënyrë, shtu këtu edhe të gjeturat nga ky monitorim i Ligjit të Inspektoratit, vazhdon të ndikoj seriozisht në përmbushjen e përgjegjësiave të Inspektoratit të Arsimit sipas ligjit.

Personeli i Inspektoratit ballafaqohet edhe me mungesë të hapësirave të nevojshme për punë kualitative siç kërkohet me përgjegjësitë e Inspektoratit të Arsimit, punë jashtë orarit të punës dhe vështirësi teknike që lidhen edhe me mungesën e veturave për inspektim në institucionet arsimore, si dhe rrezikshmëritë të inspektorëve në punë në disa raste.

Grupi punues pas procesit të mbikëqyrjes së zbatimit të këtij ligji, nxori rekomandimet si në vijim:

Ministria e Arsimit të fillojë procedurat për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 06/L-046 për Inspektoratin e Arsimit në Republikën e Kosovës, bazuar në të gjeturat e këtij raporti

Ministria e Arsimit gjatë procesit të ndryshimit dhe plotësimit të ligjit, të ketë parasysht shmangien e kolizionit të këtij ligji me Ligjin për arsimin në komunat e Republikës së Kosovës, Ligjin për arsimin parauniversitar, Ligjin e Punës dhe Ligjin për zyrtarët publikë

MASHI gjatë procesit të ndryshimit e plotësimit të këtij ligji, të bëjë harmonizimin e këtij ligji me Ligjin për kundërvajtje dhe Ligjin për inspektimet

MASHI të nxjerrë akt nënligjor të paraparë me Ligjin nr. 06/L-046 për Inspektoratin e Arsimit që ka të bëjë me intervalet e inspektive.

MASHI të plotësojë numrin e inspektorëve të lejuar dhe të nevojshëm në përmbushjen e detyrave dhe përgjegjësi të Inspektoratit të Arsimit

MASHI të rregullojë procedurat e angazhimit të bashkëpunëtorëve profesionalë, ekspertëve të jashtëm nëse ka nevojë, për profilet që nuk mbulojnë brenda Inspektoratit të Arsimit, si dhe të kryej procedurat e profilizimit të inspektorëve në inspektorë administrativë dhe pedagogjikë, siç përcaktohet me ligj.

MASHT-i të sigurojë hapësira të nevojshme për punë kualitative të sektorëve të Inspektoratit të Arsimit, të rregullojë kompensimin e punës jashtë orarit sipas legjislacionit në fuqi, të plotësojë kushtet e nevojshme logjistike dhe teknike për punë kualitative të inspektorëve, si dhe të marrë të gjitha masat ndaj rasteve të rrezikshmërisë së inspektorëve në punë.

MASHT-i të ndërtojë mekanizma mbikëqyrës të punës dhe llogaridhënies së Inspektoratit të Arsimit. Inspektorati i Arsimit të krijojë linkun vet në kudër të ueb-faqes së MASHT-it, të plotësojë atë me dokumente, informata dhe raporte relevante që të kenë qasje dhe informim komuniteti arsimor dhe të interesuarit e tjerë.

Prandaj, të nderuar kolegë,

Ftoj deputetët e Kuvendit të Kosovës ta miratojnë raportin me rekomandime për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit nr.06/L-046 për Inspektoratin e Arsimit në Republikën e Kosovës. Faleminderit!

KRYETARI: Kush e paraqet qëndrimin e grupit parlamentar? Deputetja Arijeta Fejza e ka fjalën.

ARIJETA FEJZA: Faleminderit, i nderuar kryetar Konjufca!

E nderuar ministre,

Kolegë deputetë,

Të dashur qytetarë,

Mbikëqyrja e zbatimit të ligjeve brenda fushës dhe përgjegjësi të komisioneve në Kuvendin e Republikës së Kosovës bazohet në nenin 73 të Rregullores së Kuvendit.

Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Inovacion, Kulturë, Rini dhe Sport ka mbikëqyrë zbatimin e Ligjit e nr.06/L-046 për Inspektoratin e Arsimit në Republikën e Kosovës. Inspektorati i Arsimit në Republikën e Kosovës është mekanizëm kryesor i Ministrisë së Arsimit për sigurimin e cilësisë.

Ligji nr. 06/L-046 për Inspektoratin e Arsimit në Republikën e Kosovës përcakton rolin e Inspektoratit të Arsimit, format e realizimit të punës, llojet e inspektimit dhe masat ligjore të cilat mund të ndërmerren. Inspektimi pedagogjik i paraparë me Ligjin për Inspektoratin Arsimit përbën një reformë të thellë në punën e Inspektoratit të Arsimit.

Synim i përgjithshëm i mbikëqyrje së Ligjit nr. 06/L-046 për Inspektoratin e Arsimit është që të rritte kualiteti i sigurimit të cilësisë në arsim përmes harmonizimit të legjislacionit dhe të rritet niveli i përgjegjësisë dhe i llogaridhënies për zbatimin e këtij ligji në praktikë.

Në këtë kontekst ky raport ofron një pasqyrë të gjendjes në praktikë të zbatimit të ligjit dhe rekomandime për masa të cilat duhet të ndërmerren për të siguruar përshtatshmërinë e dispozitave ligjore dhe akteve nënligjore në fushën e inspektimit të arsimit dhe në rritjen e kualitet e numrit të mbikëqyrjes, vlerësimeve, raportimit të inspektimeve dhe masave për sigurimin e cilësisë në arsim.

Gjatë periudhës prill-dhjetor të vitit 2022, komisioni ka organizuar takime me përfaqësues të institucioneve arsimore që lidhen me zbatimin e këtij ligji, si dhe ka mbledhur të dhëna referuese në bazë të këtyre pyetjeve: çka është gjendja e zbatimit të ligjit, neve dhe paragrafëve të neneve përkatëse? Cilat janë pengesat eventuale të zbatimit të këtij ligji nëse ka? Dhe, cilat janë propozimet konkrete për ndryshim dhe plotësim të neneve përkatëse?

Analiza e ligjeve, raporteve dhe rekomandimeve të ndërlidhura me ligjin që është në proces të mbikëqyrjes nga grupi punues, informatat e marra në takimet e organizuara dhe informatat kthyes nga pyetësorët e shpërndarë, përfaqësuesit e institucioneve arsimore, na e ka bërë të mundur që në këtë raport të përmbajmë të dhënat për zbatimin në praktikë të këtij Ligji për Inspektoratin e Arsimit, sfidat dhe problemet në zbatimin e disa neneve dhe paragrafëve, si dhe të nxjerrim rekomandimet e nevojshme.

Dua të theksoj gjithashtu një gjetje e cila ka dalë si pasojë e takimeve të cilat përmenda më lartë. Inspektorati i Arsimit ka realizuar përmes inspektimeve tematike bazuar në nënparagrafët 3.1

dhe 3.2 të nenit 8, zbatimin praktik dhe është përballur me sfida të ndryshme, mirëpo ndër kryesorët është pandemia COVID-19, e cila ka ndikuar drejtpërdrejt në dinamikën e paraparë në mosrealizimin e planit të punës në këtë periudhë, dhe për pasojë e ka shndërruar në tërësi punën e Inspektoratit të Arsimit, duke i pasur parasysh vazhdimisht rekomandimet të cilat kanë dalë nga Ministria e Shëndetësisë, MASHT-i dhe IKSHPKK-ja.

Procesi i inspektimit të cilësisë dhe vlerësimit të performansës së mësimdhënësve ka filluar në muajin tetor të vitit 2018, ndërsa është ndërprerë në mars të vitit 2020. Kjo për shkak të ballafaqimit me pandeminë.

Gjatë kësaj periudhe janë vlerësuar 755 mësimdhënëse, ndërkohë që me hyrjen në fuqi të udhëzimit administrativ 100/2020 për vlerësimin e performansës së drejtorëve dhe zëvendësdrejtorëve të institucioneve parauniversitare publike, Inspektorati ka filluar me vlerësimin e performansës së drejtorëve dhe zëvendësdrejtorëve dhe deri më tani janë vlerësuar 79 drejtorë dhe zëvendësdrejtorë shkollash, ndërkohë që në proces janë edhe 13.

Një sfidë tjetër, sa i përket zbatimi të paragrafit 4 të nenit 12, ku është potencuar vlerësimi i performansës të mos bëhet përtëritje të licencës. Konkluzionet dhe rekomandimet të cilat i përmendi më herët kryesuesja e grupit janë konkluzione të cilat bazohen në përvojën dhe në punën në terren të cilën e kemi hasur ne si grup punues. Si rrjedhojë e këtyre konstatimeve, ne si grup parlamentar i mbështesim këto rekomandime dhe i ftoj deputetët dhe të gjitha grupet parlamentare që ta bëjnë të njëjtën. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka kërkuar deputetja Arijeta Rexhepi.

ARIJETA REXHEPI: Faleminderit, kryetar!

E nderuara ministre,

Të nderuar deputetë,

Të dashur qytetarë,

Synimi i përgjithshëm i mbikëqyrjes së zbatimit të Ligjit nr.06/L-046 për Inspektoratin e Arsimit në Republikën e Kosovës, është të rrisë sigurimin e cilësisë në arsim përmes harmonizimit të legjislacionit dhe të rrisë nivelin e përgjegjësisë dhe llogaridhënies për zbatimin e ligjit në praktikë.

Sipas Ligjit për Inspektoratin e Arsimit në Republikën e Kosovës, Inspektorati i Arsimit është organ ekzekutiv qendror për sigurimin e cilësisë në varësi të drejtpërdrejtë të ministres së Arsimit. Për këtë qëllim Inspektorati i Arsimit kryen inspektime të ndryshme në të gjitha institucionet edukative-arsimore dhe aftësuese në Republikën e Kosovës.

Bazuar në ligjin e lartcekur, Inspektorati i Arsimit duhet të kryej këto inspektime: inspektimin e përgjithshëm, inspektim tematik, inspektim emergjent, riinspektim, inspektimi i cilësisë së punës dhe vlerësimi i performansës së mësimdhënësve për procesin e licencimit, si dhe inspektimi i cilësisë së punës dhe vlerësimi i performansës së drejtorit dhe zëvendësdrejtorit.

Këto janë disa nga detyrat e punës së inspektorëve të arsimit, të përcaktuara me ligj, ndërsa gjatë mbikëqyrjes së zbatimit të këtij ligji, identifikimi i sfidave dhe vështirësive që hasin institucionet arsimore në zbatimin e këtij ligji, janë: numri i pamjaftueshëm i inspektorëve të arsimit, angazhimi i inspektorëve edhe në detyra të tjera, pamundësia e fillimit të procesit dhe vlerësimit të performansës së mësimdhënësve që dëshirojnë të avancohen në karrierë, duke munguar kështu informacionet se cilat programe të trajnimit janë të vlefshme për proces të avancimit, mungesa e një katalogu me të dhëna të plota për programet e trajnimit të aprovuara nga MASHT-i, vlerësimi trepalësh, koha e realizimit të vlerësimit, mungesa e pragut për vazhdim të vlerësimit nga vlerësimi i brendshëm dhe atë të jashtëm.

MASHT-i ka nxjerrë edhe akte nënligjore që i përkasin organizimit dhe funksionimit të brendshëm të Inspektoratit të Arsimit, duke u bazuar në obligimet që dalin nga ky ligj. Ndërsa, aktet nënligjore të cilat akoma nuk janë nxjerrë nga MASHT-i, por sipas Inspektoratit të Arsimit janë në procedurë të nxjerrjes edhe dy udhëzime administrative.

Disa nga problemet dhe sfidat e theksuara me të cilat ballafaqohen është për shkak të mosharmonizimit të legjislacionit në fuqi që ka sjellë shumë pengesa në zbatim të ligjit, duke përfshirë edhe pamundësinë e rekrutimit të stafit dhe plotësimin e nevojave për më shumë inspektorë të arsimit.

Tanimë MASHT-i ka filluar rekrutimin e inspektorëve të arsimit, është filluar kjo masë në këtë drejtim, por për një zbatueshmëri sa më të mirë të ligjit që ndikon edhe në cilësinë arsim, numri i inspektorëve duhet të rritet edhe më shumë në regjione të caktuara.

Mbarëvajtja e punës së institucioneve arsimore varet nga puna e të gjithë aktorëve në këtë fushë; mësimdhënësve, drejtorëve të shkollave DKA-së dhe MASHT-it.

Inspektorati i Arsimit kujdeset për këtë mbarëvajtje, e cila ndikon në cilësinë e arsimit bazuar në detyrat në inspektorit pedagogjik, të cilat janë jashtëzakonisht të rëndësishme. Ata vlerësojnë përparimin dhe cilësinë e zbatimit të kurrikulës në të gjitha fushat lëndore, vlerësojnë aspektin pedagogjik të mësimdhënësve të vlerësimit, vlerësojnë cilësinë dhe realizimin e planit individual për fëmijët me aftësi të kufizuara, vlerësojnë materialet dhe mjetet e konkretizimit për mësimdhënie dhe të zënë, kontrollojnë dhe vlerësojnë funksionimin e Këshillit të Prindërve, këshillave të nxënësve, këshillave të mësimdhënësve dhe organeve të tjera profesionale.

Pastaj, rekomandojnë masa për përmirësim, duke përfshirë trajnime për mësimdhënës, ndryshime në qasjet pedagogjike, organizimin e ndryshëm të orëve, orët plotësuese në lëndë të caktuar. Realizojnë aspekte të tjera të inspektimit pedagogjik siç parashihet me këtë ligj. Pra, rëndësia e zbatimit të ligjit është shtyllë e rëndësishme për arsim sa më cilësorë.

Rekomandimet e dhëna nga grupi punues në Komisionin e Arsimit paraqesin nevojën për përmirësim të ligjit, si dhe domosdoshmërinë e zbatimit në praktikë në shërbim të ngritjes së cilësisë në arsim. Faleminderit!

KRYETARI: Tash ia japim fjalën ministres së Arsimit, Arbërie Nagavci.

MINISTRJA ARBËRIE NAGAVCI: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar deputetë,

Më lejoni që fillimisht të falënderoj Komisionin për Arsim edhe grupin punues për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për Inspektoratin e Arsimit të vitit 2018, një ligj shumë i rëndësishëm me shumicën e gjetjeve dhe rekomandimeve me të cilat pajtohem edhe unë.

Për njohurinë tuaj, Inspektorati i Arsimit i ka nxjerrë aktet nënligjore me qëllim të zbatimit të këtij ligji, ndonëse edhe si ministre e kam pasur në vëmendje të veçantë që nga marrja e mandatit për shkak se jam e vetëdijshme për vështirësitë e shumta në implementim të këtij ligji.

Për informatën tuaj, ne kemi konstatuar po ashtu që legjislacioni që e rregullon fushën e inspektoratit ka probleme të theksuara strukturore, ka caktim të kompetencave dhe përgjegjësi të cilat nuk janë të qartësuar dhe në mënyrë shprehimore, si dhe në raport me shqiptimin e gjobave për moszbatimin e ligjit nga fusha e arsimit, të cilat janë jo të barasvlershme me gjoja që përcaktohen me ligje të tjera bazike.

Kolizioni i legjislacionit të arsimit nuk vërehet te ky Ligj i inspektoratit, por te shumica e ligjeve të tjera, dhe në linjë të kësaj në theks të veçantë te problemeve apo sfidave në implementim të këtij ligji, është edhe koncentrimi i kompetencave dhe përgjegjësi tek Inspektorati i Arsimit përtej kapaciteteve të tyre, kësaj agjencie ekzekutive, dhe mosharmonisë në kolizionin e ligjeve të inspektoratit me Ligjin për kundërvajtje.

Siç është reflektuar edhe në raport, Inspektorati i Arsimit është ngarkuar me procesin e vlerësimit të performansës në të gjitha licencat që kanë qenë të parapara për mësimdhënës dhe vlerësim të performansës për drejtorë dhe zëvendësdrejtorë dhe kjo e ka vendosur në një pozicion mjaft të vështirë inspektoratin në ligje me përmbushjen e obligimeve që derivojnë nga ligji, duke pasur parasysh resurset e tyre tejet të limituara.

Meqenëse kemi konstatuar se ekziston një mbingarkesë e tillë, por po ashtu edhe për shkak të kolizionit të ligjeve, ne i kemi marrë veprimet të cilat do të ndihmojnë drejtpërdrejt në rritje të efikasitetit dhe efektshmërisë në punën e inspektoratit.

Për njohurinë tuaj, tashmë kam themeluar grupin punues për hartim plotësim e ndryshimi të Ligjit të inspektoratit, i cili është edhe në agjendën legjislative për këtë vit, ku do të adresojmë në veçanti kolizionin e ligjeve, përkatësisht harmonizimin e Ligjit të inspektoratit me Ligjin për kundërvajtje, dhe në definimin e përgjegjësive të inspektoratit në vlerësimin e performansës së mësimdhënësve dhe vlerësimin e jashtëm të drejtorëve dhe zëvendësdrejtorëve të institucioneve edukativo-arsimore.

Këto ndryshime janë në linjë edhe me ndryshime të cilat jemi duke i bërë në legjislacionin sekondar në lidhje me sistemin e licencimit të mësimdhënësve që derivon nga legjislacioni tjetër i arsimit.

Është në proces po ashtu konkursi për rekrutimin e inspektorëve. Janë pranuar aplikimet, është kryer vlerësimi administrativ i aplikimeve dhe janë shqyrtuar ankesat në lidhje me rekrutimin e 20 inspektorëve të arsimit. Aktualisht jemi në fazën e testimit dhe të intervistimit të kandidatëve.

Në këtë linjë i kemi kushtuar kujdes edhe kërkesave në raport me plotësimin e kompetencave sipas fushës për inspektorët.

Për njohurinë tuaj, ky shënon edhe rekrutimin e parë të suksesshëm grupor për shërbyesit civilë në Republikën e Kosovës, dhe po ashtu është rekrutimi i parë i stafit në Inspektoratin e Arsimit që nga hyrja në fuqi të Ligjit të inspektoratit. Shpresoj që gjithçka të shkojë mirë deri në përfundim të këtij konkursi dhe për këtë vit, po ashtu ne kemi paraparë rekrutimin edhe të 20 inspektorëve të tjerë të rinj me profile të ndryshme bazuar në fushat kurrikulare, ku janë evidentuar tashmë këto mungesa.

Sa i përket kolizionit ligjor mes Ligjit të arsimit parauniversitar dhe Ligjit për zyrtarët publikë, po ashtu e kemi adresuar këtë çështje dhe konsideroj që është adresuar në Ligji e ri për zyrtarët publikë.

Për të zbatuar këto ndryshime, tashmë kam themeluar edhe grupin punues për hartimin e Rregullores për rekrutimin e stafit arsimor për arsimin parauniversitar. Sa i përket ngarkesës së krijuar gjatë pandemisë dhe vështirëve që janë theksuar aty në raport me vlerësimin e performansës për mësimdhënësit dhe vlerësimin e jashtëm, siç u përmend edhe në raport, domethënë, janë një varg faktorësh të cilët kanë ndikuar në këtë proces.

Besoj që këto sfida, shumica e të cilave janë identifikuar edhe nga komisioni dhe janë rekomanduar në raport, i kemi tejkalua një numër të konsiderueshëm të tyre, ndërkaq me selektimin e inspektorëve 20 në këtë fazë dhe 20 të tjerë, dhe përfundimi të rishikimit të ligjit që e kemi në agjendë legjislative për këtë vit, e po ashtu edhe me rishikim e procesit të licencimit të mësimitdhënësve, do të kemi një situatë të re dhe të favorshme, jo vetëm për implementimin e suksesshëm të Ligjit për Inspektoratin e Arsimit, po për mbarëvajtjen e punës së tyre në funksion të rritjes së cilësisë në arsim. Ju faleminderit!

KRYETARI: I thërrasim deputetët që të kthehen në sallë ata që edhe mund të ndodhen në bufe ndoshta. Të shohim se sa deputetë jemi, e pastaj vendosim se si të procedojmë. Ulini të gjithë, ju lutem! 57 deputetë janë për momentin.

Konsideroj që nuk ka kuorum, prandaj shihemi në një tërësi prej seancave të ardhshme, kurdo që ta vendosim atë! Mirupafshim!

*E përgatiti:
Njësia për Transkriptim dhe Lekturë*